

1 E mërkurë, 17 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni çështjen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 Vërej për procesverbal që të katër të akuzuarit janë në
12 sallën e gjyqit.

13 Do të vijojmë sot me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes
14 së Thaçit 1DW-003. Përpara se të fillojmë me dëshminë e
15 dëshmitarit, ka disa aspekte paraprake që dëshiroj të trajtoj.

16 Së pari, në fakt, kam disa urdhra me gojë.

17 Së pari, në dokumentin F03216, Trupi Gjykues pranoi si
18 prova gjyqësore transkriptet e incizimeve nga objekti i
19 paraburgimit të datës 3 shtator 2023. Këto transkripte morën
20 numrin e provës materiale P03660. Në dokumentin F03233, ZPS-ja
21 kërkoi që versionet e rishikuara të këtyre transkriptove të
22 zëvendësonin transkriptet që ishin dorëzuar më përpara dhe të
23 pranoheshin si prova gjyqësore. Versionet e rishikuara të
24 transkriptove të 3 shtatorit 2023 u nxorën më 4 qershor 2025
25 në paketën e materialeve 1706.

1 A ka ndonjë kundërshtim nga palët për zëvendësimin e
2 transkriptove?

3 Nga Mbrojtja ka ndonjë kundërshtim?

4 Z. MİSETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

7 Po Mbrojtësi i Viktimave?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pasi morëm
10 parashtimet e palëve dhe të pjesëmarrësve, Trupi Gjykses
11 urdhëron që transkriptet e provës materiale F03660 të
12 zëvendësohen me versionet e rishikuar që kanë dalë në paketën
13 e materialeve 1706.

14 Me kaq mbyll urdhrin e parë me gojë.

15 Së dyti, në vendimin F03456, ZPS-ja kërkoi që parashtimi
16 i protokolluar F03241 të riklasifikohet si publik dhe njoftoi
17 se nuk kishte kundërshtime që materiali F03456 të
18 riklasifikohet si publik. Rrjedhimisht, në bazë të rregullës
19 82(5) i Rregullores, Trupi Gjykses urdhëron që materialet
20 F03241, 03456, bashkë me përkthimet përkatëse të
21 riklasifikohen si publike.

22 Me kaq mbyll urdhrin e dytë me gojë.

23 Së treti, në bazë të paragrafit 39(d) të vendimit mbi
24 kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për pranimin e dokumenteve
25 përmes mocioneve jo gojore, konkretisht është parashtimi

1 F03467, Mbrojtja e Thaçit na njoftoi me email të premtën,
2 javën e kaluar, se nuk ka kundërshtim që të riklasifikohet si
3 publike provat materiale të propozuara konkretisht me numër
4 019701, 019714, faqet 019711 deri në 019712, që janë pranuar
5 në atë vendim.

6 Ka ndonjë kundërshtim për riklasifikimin e këtyre
7 materiale?

8 ZPS-ja ka ndonjë kundërshtim?

9 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtësi i
11 Viktimave?

12 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë nëse
14 nuk ka kundërshtime -- më falni. Po nga Ekipet e Mbrojtjes?
15 Jo. Në rregull.

16 Në rregull atëherë. Urdhërojmë që materiali 01971,
17 019714, faqet 019711-019712, bashkë me përkthimet përkatëse të
18 riklasifikohen si publike.

19 Kaq urdhra me gojë kisha unë.

20 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit 1DW-003.

21 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
24 Dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
2 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju rikujtoj t'u përgjigjeni
3 pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e
4 kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet
5 ose thoni që nuk e kuptoni që ta sqarojmë. Gjithashtu, ju
6 lutem të na thoni bazën e dijenisë suaj lidhur me faktet dhe
7 rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

8 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
9 vërtetën sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn.

10 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
11 se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

12 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na njoftoni dhe
13 do të bëjmë organizimet përkatëse.

14 Gjithashtu, sa i takon përfaqësueses së SHBA-së,
15 faleminderit që jeni sërish këtu me ne sot. Ju rikujtoj se në
16 çdo moment që keni nevojë të flisni me dëshmitarin apo keni
17 nevojë të flisni me Trupin Gjykses, ngrini dorën ne do t'ju
18 japim lejen përkatëse.

19 Do të vazhdojmë me pyetjet nga gjykatësit. Gjykatësi
20 Gaynor ka pyetje për ju. Gjykatësi Mettraux i mbaroj pyetjet e
21 veta, tani e ka fjalën Gjykatësi Gaynor.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

23 DËSHMITARI: JAMES RUBIN [Vijon]

24 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Rubin. Unë

1 do t'ju bëj disa pyetje të tjera lidhur me pozicionin *de facto*
2 që ka pasur z. Thaçi në Rambuje si dhe veprimet e tij në
3 Rambuje.

4 Po për të bërë këtë do kërkoja që Sekretaria të nxirrte
5 në ekran videon 1287910 dhe ta shohim nga segmenti kohor
6 minuta e 44:00 fiks deri në 46:40.

7 z. Rubin, ky është pjesë e një dokumentari që më duket se
8 është transmetuar në vitin 2000, që thotë, e ka transmetuar
9 BBC dhe thotë "Lufta morale, NATO në luftë", do ta shohim,
10 reporter ka qenë Allan Little. Kështu që do ta shohim dhe do
11 t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë dokumentar.

12 [Luhet videoincizimi]

13 "Fokusi ishte tek delegacioni shqiptar. Ata kishin
14 zgjedhur një person pa përvojë dhe të ri si udhëheqësin e
15 tyre, Hashim Thaçi. I tërë delegacionin e nxiti ta pranonte,
16 por ai refuzoi sepse marrëveshja nuk kishte përfshirë asgjë
17 lidhur me pavarësinë.

18 "Delegacioni emëroi Thaçin si drejtues duke mos e ditur
19 se mund të ktheheshin në të burgosurit e tij.

20 "Ishte një po e shkëlqyer nga të gjitha anët me
21 përjashtim të Thaçit, që ishte shumë i prerë. Dhe tha jo.

22 "Thaçi ishte shumë i prerë ndaj delegacionit duke thënë
23 shikoni, ky dokument, ky formulim i këtij dokumenti është
24 tërësisht i papranueshëm.

25 "Të përdorim gjuhën -- gjuha mund të kuptohet si

1 kërcënuese.

2 "Kushdo që e nënshkruan tani unë do ta trajtojë atë ose
3 do ta konsideroj si armik, si armik të kombit."

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Rubin, a e kam kuptuar
5 unë drejt që këta dy zotërinjtë që pamë ne që po flisnin janë
6 dy anëtarë jo të UÇK-së që kanë qenë në delegacionin në
7 Rambuje?

8 PË. Po kështu e kam kuptuar dhe unë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I njihnit ju këta dy
10 persona?

11 PË. Z. Surroi po.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e dinit ju, kishit dëgjuar
13 gjë ju që z. Thaçi paska bërë kërcënime të qarta ose
14 tërthorazi ndaj tyre?

15 PË. Ta ndajmë pak kërcënimin fizik nga kërcënimi moral. Jo,
16 nuk kam qenë në dijeni të ketë pasur ndonjë kërcënim fizik,
17 por e di që ka qenë kjo, ka pas presion ideologjik pro ose
18 kundër pavarësisë sepse kjo ishte kryesore për lëvizjen, kjo
19 ishte kryesore për lëvizjen gjatë luftës.

20 Kështu që edhe Madeleine Albright e ka kërcënuar Hashim
21 Thaçin, e ka kërcënuar dhe i ka thënë po nuk nënshkrove, po i
22 lë njerëzit të pambrojtur nga serbët. Dhe sigurisht më pas
23 dëgjova që është kërcënuar dhe z. Demaçi, që ishte personi
24 kryesor. Dhe unë dua të shtoj diçka këtu, dje më bëtë shumë
25 pyetje për z. Demaçi dhe unë nuk u përgjigja për diçka të

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 7

1 rëndësishme. Ky ishte një person me status në lëvizjen e tyre,
2 ky është ekuivalenti i Nelson Mandelës madje, që ishte
3 burgosur për shumë e shumë vite dhe kishte një pushtet moral
4 të jashtëzakonshëm ndaj lëvizjes për çlirim, pra, kërcënimet
5 nuk kanë qenë fizike. Se ju përdorët fjalën "kërcënim" dhe unë
6 po përpiqem të jem sa më i qartë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Përkthim] Z. Rubin, po
8 shkoni përtej objektit të pyetjes. Ju lutem, përgjigjuni
9 pyetjes.

10 DËSHMITARI: Në rregull.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ta sqaroj unë. Unë thashë
12 kërcënime të drejtpërdrejta apo të tërthorta. Nuk thashë
13 fizike. Në rregull.

14 Vazhdojmë me videon, të shohim dhe një pjesë tjetër të
15 videos.

16 Vazhdoni aty ku e lamë dhe ndalonin në sekondën 46, ju
17 lutem.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "... ishte ndër ... Intimidimi i Thaçit nuk e ndaloi
20 luftën sa i takon luftës mes tij dhe sponsorët ndërkombëtarë.

21 "Ai ka qenë dikush, që ishte një anëtar i ri i
22 delegacionit, pak a shumë mosha ime, sigurisht që krijuam një
23 lidhje të natyrshme. Madje unë e ngacmoja herë pas here se i
24 thoja ti mund të jesh më i mirë për një film në Hollywood edhe
25 ai i merrte me pozitivitet këto shaka të miat, ngacmonim

1 njëri-tjetrin, bën shaka me njëri-tjetrin.

2 "Thaçi nuk ju përgjigj. Amerikanët kërkuar Madeleine
3 Albright e cila mbërriti..."

4 Vazhdoni.

5 "... dhe duhet të merrte një po nga Thaçi. Ajo qëndroi
6 katër ditë me të.

7 "Kur shkuar atje ishte e qartë që z. Thaçi ishte një lloj
8 lideri dhe e krahasuar me Gerry Adams.

9 "Ajo këmbënguli që ai të bënte një zgjedhje simbolike.

10 "Mbase ai ishte një udhëheqës që kishte një qëllim por
11 mund të ishte pjesë e një zgjedhje politike.

12 "Pjesërisht Thaçi e pëlqeu, e pëlqeu idenë që po e nxiste
13 ..."

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ndalojmë këtu.

15 Z. Rubin, dua t'ju pyes për deklaratat e Sekretares së
16 Shtetit Madeleine Albright, ku mesa duket ose të paktën si e
17 kuptoj unë, ajo i referohet z. Thaçi padyshim si një lider.
18 Nuk i drejtohet Adem Demaçit. As nuk thotë që z. Thaçi është
19 një lloj ministri i jashtëm. Po ajo thotë ai është lideri,
20 udhëheqësi. A mund të komentoni lidhur me këto?

21 PË. Po. Unë mendoj se ajo e ka zgjedhur me shumë kujdes
22 fjalët e saj. Sepse këtë punë bëjnë sekretarët e shtetit
23 sikurse bëj dhe unë. Ajo nuk tha "lideri", por tha "një prej
24 liderëve" dhe ka një dallim të madh këtu. Kur thua "lideri"
25 është në njëjës. Po "lider" në këtë kontekst ajo e krahasoi me

1 Gerry Adams dhe ky është një krahasim shumë i rëndësishëm,
2 lideri i një grupi që urojmë të udhëhiqte kombin e tij drejt
3 rrugës së lirisë. "Një drejtues", "një udhëheqës". Kjo është
4 fjala që ka përdorur dhe Presidenti Clinton me të, Madeleine
5 Albright edhe unë. Ne donim që ai të kthehej në një udhëheqës,
6 udhëheqësi i një kombi që pas do të ishte me shpresë i lirë.

7 Meqë më pyetët për shprehjen dhe ju thatë "lideri", unë
8 po ju korrigjoj, se unë e dëgjova që tha një drejtues, kështu
9 e konsideroj dhe unë si një drejtues të një grupi. Jo
10 drejtuesi, por drejtuesi i një delegacioni që ishte zgjedhur
11 nga delegacioni shqiptar në atë takim, ai ishte një person si
12 kryetar, si Kryegjykatësi. Po një drejtues, një udhëheqës. Ai
13 nuk është Gjykatësi, ishte një prej. Kishte një pozicion
14 udhëheqës, pra, në Rambuje.

15 Pra dhe në qoftë se e ka thënë udhëheqësi i delegacionit
16 kjo është e saktë, por ama duhet bërë një dallim i madh sepse
17 ajo i kërkonte atij të kërkonte aftësi udhëheqëse. Këtë donim
18 prej tij. Të udhëhiqte njerëzit e tij, t'i largonte nga
19 përdorimi i dhunës, t'i çonte drejt rrugës së paqes. Dhe kjo
20 është e vështirë dhe këta njerëz duhet t'i frymëzosh. Dhe unë
21 besoj se këtë ka dashur të përcjellë ajo në mesazhin e vet
22 edhe unë besoj se atë e njihja shumë mirë.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Do ndërroj pak
24 temë tani.

25 Mesa kuptoj nga dëshmia juaj këto dy ditë, ju keni dalë

1 në disa përfundime sa i takon strukturës së UÇK-së dhe linjës
2 së komandës dhe kontrollit brenda UÇK-së bazuar kryesisht në
3 komunikimet tuaja me udhëheqësit e UÇK-së në Rambuje dhe më
4 pas në 72 orët që kaluat në verën e 1999 gjatë kohës që keni
5 qëndruar me komandantët e zonës?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjatë ndërveprimeve tuaja me
8 ta a patë ju që të kishte komunikime mes komandantëve të zonës
9 dhe Shtabit të Përgjithshëm?

10 PË. Dhe në qoftë se do i kem vënë re s'do të isha në gjendje
11 t'i diskutoja.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po në nivel brigade keni
13 parë ndonjë komunikim me shkrim?

14 PË. Edhe nëse do t'i kem parë komunikimet të tilla, sidomos
15 duke pasur dhe praninë e koleges nga SHBA-ja këtu, nuk do të
16 isha në gjendje të komunikoja.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni parë komunikime mes
18 batalioneve?

19 PË. Më duhet të bëj një përjashtim këtu. Mesa pash unë nuk ka
20 pasur batalione, brigada apo njësi në UÇK. Nuk besoj se ka
21 ekzistuar nga pikëpamja ushtarake ky lloj organizimi dhe nga
22 ato që kam parë unë asnjëherë nuk më çoi të mendoja që
23 ekzistonin struktura të tilla.

24 Mund të kem parë gjëra për UÇK-në që mund t'i diskutoj,
25 por mund t'ju them që s'kam parë asgjë që përshkruan

1 batalione, brigada, njësi, siç duhet të jenë si rregull në
2 divizione në ushtri apo regjimente që kemi parë ne në perëndim
3 apo çfarë konsiderojmë ne një strukturë formale. Në dijeninë
4 tonë nuk ka ekzistuar diçka e tillë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sipas jush UÇK-ja operonte
6 apo kishte apo nuk kishte polici ushtarake?

7 PË. Unë e di që kishin uniforma. E di që kishin uniforma,
8 disa kishin, disa nuk kishin. Sikurse e patë edhe dje në video
9 disa kishin uniforma, disa nuk kishin uniforma. Ne nuk e
10 konsideronim atë si polici ushtarake apo komandantë të
11 brigadave apo Shtabit të Përgjithshëm. Këto që përshkruani ju,
12 ne nuk kemi parë.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Keni parë ndonjëherë ushtarë
14 që kishin emblemën PU në krahun e tyre?

15 PË. Dhe mund t'i kem parë, por nuk më kujtohet.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon publikimeve apo
17 komunikatave që drejtonte, nxirrte Shtabi i Përgjithshëm keni
18 pasur ndonjëherë shans të shihni komunikata që nxirrte UÇK-ja
19 në shtyp?

20 PË. Kam lexuar shpesh komunikata por i kam konsideruar më
21 shumë një përpjekje për ta bërë UÇK-në më të rëndësishme nga
22 ç'ishte në realitet. Për mua nuk ishin asgjë përveçse
23 manipulime.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur dolët në përfundimin
25 tuaj dhe thatë UÇK-ja është kaotike, e çorganizuar, pa një

1 strukturë të mirëfilltë, ndonjë në Departamentin e Shtetit,
2 mesa keni ju dijeni, a ka bërë ndonjë analizë sa i takon
3 komunikatave të UÇK-së në nivel brigadash, komandantëve të
4 zonës, me sa keni ju dijeni?

5 PË. Unë kam pasur shumë autoritet nga Sekretarja e Shtetit
6 dhe nëse do e kërkoja këtë informacion nuk do ma mohonte
7 askush. Unë kam parë shumë materiale, i kam rishikuar edhe
8 këto që po përshkruani ju do të ishin informacione prej
9 zbulimit dhe unë do të jem shumë i kujdesshëm të jap hollësi
10 lidhur me këtë.

11 Por po përsërisë edhe një herë nuk kam parë asnjë
12 dokument të paktën mesa më kujtohet mua që të përshkruante
13 ndonjë analizë të strukturës. Unë nuk po them që s'ka
14 ekzistuar fare strukturë, por kishin më shumë grupe, klane,
15 por jo strukturë formale ushtarake. Nëse do kishte ekzistuar
16 ndonjë informacion i tillë sa i takon analizës së aftësive të
17 tyre ushtarake atëherë ky informacion do të ishte informacion
18 inteligjence që unë me siguri do ta kisha ditur.

19 Po përpiqem t'i përgjigjem pyetjes suaj dhe e di që po
20 shtjelloj më shumë seç duhet, po këto janë çështje shumë
21 komplekse dhe unë nuk mund t'ju përgjigjem ju thjesht me "po"
22 ose me "jo".

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kaloj në një temë
24 tjetër. Ju folët për shqetësimet që kishit ju sa i takon
25 hakmarrjes ndaj serbëve edhe dhatë dëshmi dhe sa i takon

1 pretendimeve se UÇK-ja ishte përfshirë në trafikim lëndësh
2 narkotike dhe trafikim organesh. Unë tani dua ta lë këtë për
3 një çast mënjane, por dua të fokusohem tek personat që janë
4 zhdukur dhe sidomos për personat që janë parë për herë të
5 fundit kur kanë qenë në ndalim, kur kanë qenë të ndaluar nga
6 UÇK-ja.

7 Kur keni komunikuar me z. Thaçi në 1999 apo rishtazi e
8 keni diskutuar ndonjëherë ju çështjen, këtë çështje me të?
9 PË. Me siguri që po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A shfaq ndonjë interes z.
11 Thaçi për të zbuluar çfarë u ka ndodhur këtyre personave të
12 zhdukur?

13 PË. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje kaq të rëndësishme, më
14 duhet të them se unë kam biseduar shumë herë me z. Thaçi për
15 kohë të gjata dhe kur diskutoheshin tema të tilla, unë bëja
16 atë që prisnin amerikanët prej përfaqësuesit të tyre, të
17 pyesja, të interesohesha për këto tema, t'i kërkoj edhe atij
18 të interesohet për këtë çështje dhe përshtypja ime është që ai
19 është përpjekur të bëjë diçka.

20 Megjithatë, sikurse ua thashë dje, unë nuk kam qenë
21 hetues, as prokuror, as përfaqësues i të drejtave të njeriut.
22 Kështu që unë nuk mund t'i thojë që "Kemi dëgjuar për X rast.
23 Më thuaj çfarë di për këtë çështje. Ju lutem më jep të gjitha
24 hollësitë që ke dhe çfarë do të zbulosh për këtë dhe të lutem
25 më raporto për një muaj". Këtu po flasim në një situatë lufte.

1 Pra, përgjigja është jo.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Kaq pyetje
3 kisha.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 Prokuroria ka pyetje që burojnë prej pyetjeve të
6 Gjykatësve?

7 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, në fakt
9 duhet të kisha filluar me Mbrojtjen. Pas dy vitesh e gjysëm më
10 janë fiksuar disa mënyra fikse tani.

11 Faleminderit, Misetic.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

13 Pyetje vijuese të mëtejshme nga z. Misetic:

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Mirëmëngjesi, z. Rubin. Shpresoj që kjo është hera e
16 fundit që po ju bëj pyetje.

17 PË. Faleminderit për këtë.

18 PY. Me siguri të bëhet qejfi ta dëgjosh këtë. Sikurse u
19 thashë dje, pyetjet e mia mbështeten në pyetjet që u kanë bërë
20 Gjykatësit, do përpiqem të mos dalë jashtë objektit të
21 pyetjeve të tyre.

22 PË. Faleminderit.

23 PY. Do fokusohem tek pyetjet e Gjykatësi Barthe që është
24 Gjykatësi i parë që bëri pyetje dje.

25 Ishte një pyetje që bëri Gjykatësi Barthe, si keni

1 dëgjuar ju apo keni dëgjuar që z. Thaçi ishte kërcënuar në
2 Rambuje. Ju kujtohet kjo pyetje?

3 PË. Po.

4 PY. Do të vendos në ekran -- më duket se ju thatë se mund
5 t'ua kishte thënë dikush nga delegacioni i SHBA-së po nuk ju
6 kujtohej se kush, kështu?

7 PË. Po.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
9 DHT0481-01482.

10 PY. Z. Rubin, ky është një libër i shkruar nga ambasadori
11 Hill. E kemi të qartë përshtypjen tuaj për ambasadorin Hill.
12 Nuk është nevoja ta diskutojmë atë. Po thjesht dua t'ju pyes
13 nëse pajtoheni lidhur me diçka që ka shkruar ai në këtë libër.
14 Ose mbase mund t'ju shërbejë dhe për të rifreskuar kujtesën.

15 Ndërkohë që presim dokumentin, mund t'ju pyes nëse
16 Ambasadori Hill ka qenë anëtar i delegacionit në Rambuje?

17 PË. Po, një prej drejtuesve kryesorë madje.

18 PY. Kjo është ballina e librit që ka botuar ai.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër në këtë
20 libër. Paragrafi i dytë, thuhet:

21 "Disa ditë para pushimit që do të kishim pas dy javësh në
22 këtë proces, Thaçi, na shqetësoi, sepse u largua nga
23 konferenca më 18 shkurt dhe u kthye dy ditë më pas me kërkesa
24 edhe më të ashpra. As njëherë nuk na tha se ku shkoi, ndonëse
25 ne dyshonim se ai kishte shkuar të takonte Adem Demaçin dhe

1 drejtuesin politik të vetëemëruar të UÇK-së i cili kishte
2 refuzuar të merrte pjesë në Rambuje. Për muaj të tërë Demaçi
3 kishte bërë deklaratata të forta në shtyp në Prishtinë, kështu
4 që serbët asnjëherë nuk ndërhyjnë me të, kaq kontribut kishte
5 ai sepse sipas tyre UÇK-ja ishte thjesht një grup radikal të
6 çmendur.

7 "‘Pse nuk e kuptoni -- pse nuk pajtoheni me këtë?’ e
8 pyeta Thaçin, që nuk po e kuptonte vërtetë sa pasoja të rënda
9 do të kishte kjo për kosovarët.

10 "Ai më tha, ‘Ti s’po e kupton. Nëse unë pajtohem me këtë,
11 unë do kthehem dhe do më vrasin.’"

12 Z. Rubin, kjo që ka thënë ambasadori Hill a ju ndihmon me
13 kujtesën tuaj kur thatë që dikujt i ka treguar z. Thaçi që e
14 kanë kërcënuar. Kujt mund t’i ketë thënë pra?

15 PË. Atëherë mua mendoj që ia ka thënë Chris Hill këtë, po ka
16 të ngjarë që Chris Hill t’ia ketë thënë z. O’Brien, që ka qenë
17 një nga shokët e mi. Dhe O’Brien dhe ata kanë qenë shumë më të
18 afërt me njeri-tjetrin. Kështu që mendoj se e kam mësuar unë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Kërkoj pranimin e
20 materialit në fjalë.

21 Ka kundërshtime nga ZPS-ja?

22 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali

24 DHT01481-DHT01482 pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë

1 numrin e provës 1D371.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 PY. Z. Rubin, Gjykatësi Barthe ju bëri pyetje dhe por dhe

5 Gjykatësi Gaynor sot lidhur me bisedat që keni pasur me z.

6 Thaçi pas luftës sa i takon temës që duhet të përpiqej më

7 shumë apo jo? Ju kujtohet?

8 PË. Po.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Do shohim një intervistë që e keni

11 dhënë tek programi i Charlie Rose në prill të vitit 2000. Ju

12 lutem, vendosni në ekran materialin 128836-05 dhe të shohin

13 konkretisht minutën 07:27. A e kemi videon? Po.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kontrollojmë se është

15 klasifikuar konfidenciale.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publike.

17 [Luhet videoincizimi]

18 "... po ata ju po thoni që kanë bërë pjesën më të madhe

19 të atyre që pritej nga ata në qoftë se shihet historia e

20 lëvizjeve rebele që dorëzojnë armët, pra, nuk mund të presim

21 më shumë se ç'kanë bërë deri tani apo të gjitha aktivitetet në

22 të cilat janë të përfshirë sa i takon akteve reale të dhunës

23 kundër serbëve a do të duhet të shfajësohen këto?

24 "Rubin: Në të kundërtën, ajo që po them është sa e rrallë

25 që një lëvizje rebele të dorëzojë armët kaq shpejt dhe në fakt

1 ata e bënë këtë gjë. Ky ishte misioni im. Misioni im i dytë
2 ishte muajin e kaluar dhe shumë ndryshe, mision tjetër. Dhe ky
3 ishte një mision që Sekretarja Albright dhe Presidenti më
4 kishin dërguar mua dhe Ambasadorin Hill nga Shtëpia e Bardhë
5 në Kosovë dhe mesazhi jonë ishte ndryshe kësaj radhe. Mesazhi
6 jonë për z. Thaçi dhe Rugovën dhe gjithë liderët, udhëheqësit
7 shqiptarë të Kosovës ishte zhgënjim. Se ne ishim të zhgënjyer
8 me dështimin e tyre për të përdorur të gjitha mundësitë e tyre
9 dhe të gjithë aftësinë e tyre për të parandaluar, pra, të
10 gjithë energjinë që kishin që të ndalonin, pra, të ndalonin
11 shqiptarët nga kryerja e akteve, veprimeve shpaguese,
12 hakmarrëse kundër serbëve. Por kur flasim për këtë sesa të
13 zhgënjyer jemi dhe është e qartë se unë po e dënoja këtë, ne
14 duhet të kujtojmë që ka një dallim të madh mes shpagimit,
15 dhunës dhe dhunës së organizuar si fushatë, fushatë e vrasjeve
16 në masë apo dëbimeve në masë nga një shtet që është ajo që
17 Slobodan Milosevic dhe regjimi i tij kishin bërë. Ka patur, ka
18 dhunë, ka hakmarrje, shpagim që është e papranueshëm në sytë
19 tanë dhe unë kam shkuar atje dhe e kam dënuar atë gjë. Dhe e
20 kam parë z. Thaçi dhe z. Rugova dhe të gjithë udhëheqësit në
21 sy dhe ju kam thënë: Ata që kanë punuar kaq shumë me ju për
22 t'ju ndihmuar juve janë të zhgënjyer.

23 "Pra, supozimi është që, me gabim apo me të drejtë dhe
24 mund të na e thoni neve është që ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe
25 njerëzit e saj kishin mbështetur z. Rugova.

1 "Dëgjoni, z. Rugova kishte mbështetje të gjerë në popull.
2 z. Thaçi kishte zhvilluar, krijuar një parti politike dhe
3 ishte në mesin e atyre që kishte marrë armët për të luftuar
4 kundër serbëve. Dhe, po, ka një problem, është më shumë
5 problem me dhunën e organizuar në mesin e UÇK-së, por Dr.
6 Rugova dhe z. Thaçi kishin përgjegjësi të barabartë. Dr.
7 Rugova kishte autoritet moral në Kosovë dhe ajo që po i thoja
8 unë është atij është që të -- dhe z. Thaçi në mënyrë të
9 barabartë është që të përdornin çdo mundësi që kishin për të
10 parandaluar këtë, pra, parandaluan popullin që të mos e bënte
11 një gjë të tillë, nuk është sistem i organizuar i dhunës në
12 mënyrën siç ishte ai i Milosevic. Dhe nëse Dr. Rugova dhe z.
13 Thaçi dhe z. Qosja dhe gjithë udhëheqësit përdornin çdo
14 mundësi dhe çdo energji që kishin për ta parandaluar këtë, ata
15 nuk përdornin çdo mundësi, ata do të dëmtonin dhe marrëdhëniet
16 e tyre me Shtetet e Bashkuara.

17 "Duke folur tani për z. Hill, i cili ka shumë admirim nga
18 populli për punën që ka bërë aty ..."

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Vetëm po prisja që të përfundonte
20 përkthimi.

21 PY. Z. Rubin, a ju kujtohet që keni dhënë këtë deklaratë
22 Charlie Rose?

23 PË. Po.

24 PY. Atë që i keni thënë Charlie Rose në prill 2000 ishte,
25 pra, kjo pasqyron saktësisht bisedat që keni patur me Dr.

1 Rugovën, z. Thaçi, z. Qosja dhe udhëheqës të tjerë shqiptarë?
2 PË. Po.
3 PY. Dhe retrospektivisht jam i kënaqur me saktësinë e fjalëve
4 që kam përdorur në atë kohë.
5 PY. Aty keni përmendur përdorimin e të gjitha mundësive për
6 të parandaluar këto veprime dhe autoritetin moral të Dr.
7 Rugovës. A po i inkurajonit ata që të përdornin ndikimin e
8 tyre moral?
9 PË. Po. Dhe dua ta shpjegoj. Gjatë bisedimeve të tre ditëve
10 të fundit, diskutimeve këtu jam përpjekur të bëj një dallim me
11 saktësisë të një qeverie të organizuar dhe një ushtrie të
12 organizuar dhe një shoqërie të organizuar sepse në dhjetëra
13 udhëtimet që kam bërë në Kosovë në ato vite, kam krijuar një
14 përshtypje të fuqishme që 90 për qind e këtyre njerëzve kishin
15 qenë të shtypur për dhjetëra e dhjetëra vite, nuk kishin
16 qeveri të organizuar. Nuk kishin polici të organizuar. Nuk
17 kishin ushtri të organizuar. Dhe ata që kishin autoritet moral
18 në një shoqëri të shtypur si kjo, ishin ata që mund të kishin
19 më ndikim për të bindur familjet individuale të cilat kishin
20 gjasa më të madha për t'u përfshirë në veprime hakmarrëse të
21 cilët kishin familje apo pjesëtarë të familjes që ishin vrarë.
22 Pra, kishte shumë zemërim.
23 Besoj që mënyra më efikase për të parandaluar dhunën
24 hakmarrëse, shpaguese ishte që këto autoritete morale të bëjnë
25 thirrje familjeve që kishin humbur vëllezërit, motrat, familje

1 të tëra nga vrasjet masive që të mos hakmerreshin, të mos
2 përgjigjeshin me dhunë.

3 Dhe në shoqëri, autoriteti moral është jashtëzakonisht
4 shumë më i rëndësishëm sesa autoriteti i personave që marrin
5 vendime ose veprime apo ndonjë fjali e shkruar në ndonjë
6 letër. Kjo është ajo që i bën njerëzit të ndryshojnë mendjen
7 lidhur me atë që mendojnë të bëjnë apo jo. Kjo është përvoja
8 ime në shumë zona të luftës dhe në veçanti në këtë zonë lufte
9 ku njerëzit befasisht gjendeshin të lirë pas vitesh e vitesh
10 masakra dhe vrasjesh.

11 PY. Faleminderit.

12 PË. Kjo është ajo që mund të ndikonte tek këta njerëz dhe siç
13 e thashë kjo është edhe pika që ne jemi përpjekur të
14 përcjellim apo mesazhin që përcjellim tek këta udhëheqës.

15 PY. Faleminderit. Në fillim të videos thuhet:

16 "Ajo që po them është që sa e rrallë është që një lëvizje
17 rebele të dorëzojnë armët kaq shpejt dhe ata e bënë një gjë të
18 tillë. Ky ishte misioni im i parë. Misioni i dytë ishte muajin
19 e kaluar dhe ai ishte ndryshe nga i pari..."

20 Dhe pastaj ju shpjegoni se misioni ishte me Ambasadorin
21 Hill në rajon një muaj më vonë. Kjo ka qenë në prill të vitit
22 2000. A ju freskon kjo kujtesën lidhur me bisedimet që keni
23 patur me z. Thaçi?

24 PË. E di që ka qenë rreth një muaj pas përfundimit të luftës,
25 qershor 1999 dhe ky ka qenë misioni i dytë, pra, i pari ishte

1 rreth qershorit 1999 dhe ky i dyti në mars të vitit 2000.
2 Administrata, pak pasi u largova nga qeveria, administrata më
3 dha detyra mua që të shkoja në Kosovë ku unë kisha autoritet
4 moral dhe njerëzit më dëgjonin. Turmat mbledheshin, njerëzit
5 më dëgjonin dhe unë doja t'ju thoja atyre që kishin një rrezik
6 për një konflikt të ri në Luginën e Preshevës. I ngrita dhe
7 çështje që mendova ishin të duhura për t'u ngritur, paraqitur
8 nga e kaluara, por kryesisht ajo që doja të thoja aty që të
9 mos lejojmë që të ndodhë e njëjta gjë në Luginën e Preshevës.

10 Dhe unë u gëzova se Lugina e Preshevës nuk shpërtheu në
11 dhunë ndërkohë njerëzit prisnin që do të ndodhte, sepse Hashim
12 Thaçi, udhëheqës i një partie politike i kundërshtoi këta
13 njerëz, ju e thatë, që nuk duhej të krijonin dhunë politike.

14 Pra, kjo pasqyron këtë, rifreskon kujtesën time dhe është
15 e qartë që unë kam qenë aty rreth marsit të vitit 2000. Jam
16 larguar nga qeveria amerikane më duket në maj. Dhe ky ishte
17 udhëtimi im i fundit në rajon si zyrtar i qeverisë derisa jam
18 kthyer pastaj nën administratën Biden.

19 Dhe, përsëri dua t'ju them, kjo shoqëri ishte e
20 shkatërruar dhe unë doja t'i ndihmoja ata që të bënin gjënë e
21 duhur.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim këtë.

24 PY. Do t'ju bëj një pyetje lidhur me një pyetje që ju bëri
25 dje Gjykatësi Barthe dhe ju pyeti për deklaratën tuaj kur keni

1 thënë që në Rambuje ai pothuajse do të kishte qenë tradhtar po
2 të ishte pajtuar. Pra, ka pas disa diskutime, Gjykatësi ju
3 bëri disa pyetje sesi erdhi fjala tradhtar në deklaratën tuaj
4 në pyetjet e Gjykatësit Barthe.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran, ju lutem
6 tani provën materiale 1D279.

7 PY. Ky është libri që frymëzohet nga artikulli në *Financial*
8 *Times* që është i juaji.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe nëse mund të kalojmë në këtë
10 në faqen SPOE00229721. Po, kjo është.

11 PY. Paragrafi poshtë "Si e arritëm kompromisin", këtu lexon,
12 fillojmë me "Albright" në mes:

13 "... Albright u kthye në Paris me makinë për të fjetur
14 disa orë. Atë natë unë shkova, bëra një ecje të gjatë në këmbë
15 me Thaçin. Ishte një ftohtë i ashpër, ai nuk pranoi që të
16 merrte xhaketën time. Ishte i shqetësuar. Më tha që ishte nën
17 presionin e komandantëve të UÇK-së në Kosovë dhe financuesit e
18 saj nga Evropa. Ata do ta konsideronin atë tradhtar."

19 Pyetja, "Ata do ta konsideronin atë tradhtar", siç
20 shkruhet në artikullin e *Financial Times*, a ishte kjo diçka që
21 z. Thaçi tha? Z. Thaçi tha? Pra, me fjalë të tjera, që ishte
22 nën trysinë e komandantëve të UÇK-së në Kosovë dhe
23 financierëve nga Evropa që ata do ta konsideronin tradhtar, a
24 është diçka që e tha apo ju e nxorët si përfundim?

25 PË. Së pari, hera e sajtë që po e them që ky libër është

1 publikuar, por nuk e kam autorizuar botimin e tij.

2 Dhe dua që Gjykata të kuptojë që unë kam shkruar një
3 artikull *Financial Times*, pastaj dikush e ka përkthyer në
4 shqip pastaj është ripërkthyer në anglisht. Janë humbur shumë
5 fjalë dhe kuptime në këtë.

6 Thënë këtë, nuk do të më kujtohet po e imagjinoj që mund
7 ta ketë quajtur veten tradhtar. Por mendoj që po përpigësja të
8 jepja një përmbledhje të problemit, në anglisht është ajo që
9 mund thërrasim bisedë e lirë, pra, që e quajmë bisedë e lirë.
10 Problemi me të cilin përballëj ishte që të vepronte në
11 kundërshtim me vendime dhe veprime dhe dëshirat e eprorëve tij
12 apo mbështetësve të tjerë në Evropë, mbështetësve financiarë
13 dhe në rajonin e UÇK-së. Pra, fjala që kam zgjedhur bazohej në
14 mbështetjen në vlerësimin e asaj që ai po më thoshte mua dhe
15 por dyshoj që kjo të ketë qenë fjalë që ai ka përdorur.
16 Megjithatë, ishte e qartë për mu, që ai ishte nën një presion
17 jashtëzakonisht të madh.

18 PY. Të kalojmë tek një pyetje tjetër tani. A ju kujtohet që
19 jeni pyetur lidhur me fletë-arrestin dhe se si ju e keni marrë
20 vesh për këtë, se si e keni kuptuar besoj që ju thatë që z.
21 Thaçi ju ka thënë juve?

22 PË. Disa prej këtyre gjërave ngelin në kokë kështu, nuk mund
23 të kujtoj se kush më ka thënë saktësisht për fletë-arrestin që
24 ishe lëshuar ndaj z. Thaçi, a më ka thënë dikush që ma ka
25 thënë apo e kam lexuar por më duket që më ka thënë lidhur me

1 vështirësinë e situatës në të cilën gjendej sesi duhet të
2 kalonte përmes maleve kur udhëtonte, të fshihej dhe sesi erdhi
3 ky fletë-arresti, ekzistenca e fletë-arrestit në kokën time,
4 nuk më kujtohet saktë, saktë.

5 PY. Në rregull.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të shfaqim tani në ekran
7 dokumentin KSC-BC-2020-06-SITF00451824 deri në 00451839. Në
8 qoftë se mund të kalojmë në faqen 2.

9 PY. Ky është përkthim i asaj që pretendohet të jetë fletë-
10 arrestimi i lëshuar nga autoritete serbe për z. Thaçi. E
11 shikoni në ekran?

12 PË. Po.

13 PY. Kalojmë në fund të faqes, datë është 2 mars 1999, pra, në
14 mes të Konferencës së Rambujesë në Paris. A përputhet kjo me
15 atë që kishit dëgjuar ju lidhur me një fletë-arrest të lëshuar
16 nga autoritetet serbe kundër z. Thaçi?

17 PË. Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. kryetar paraqes këtë provë
19 materiale për pranim në prova.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim?

22 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] KSC-BC-2000-
24 06-SITF0045184. Është ky numri i faqes 24?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mund ta shoh. Jo, besoj që

1 është 25, në qoftë se nuk gaboj. Në qoftë se mund të shohim
2 numrin e faqes? 25, po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja 25
4 pranohet.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
6 e provës materiale 1D372 dhe vërej që është i klasifikuar
7 konfidencial.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
10 Riklasifikohet si publik.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Z. Rubin, siç e vërejtët më herët ju bënë shumë
13 pyetje lidhur me Adem Demaçin, do t'ju bëj dhe disa të tjera.
14 PË. Në rregull.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek provat tani
16 DHT12050 deri në DHT12052-ET. Ky është raport gazete i datës
17 24 shkurt 1999 në një konferencë për shtyp të dhënë nga Albin
18 Kurti që i cili në atë kohë ishte sekretar i Adem Demaçi.

19 PY. E shikoni këtë?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe titulli është "Asnjë vendim politik pa pëlqimin e
22 Adem Demaçit". Kalojmë në paragrafin e tretë. Aty lexon:

23 "Albin Kurti tha në konferencën për shtyp të sotme se
24 Adem Demaçi ka udhëtuar me urgjencë në Lubjanë sot për të bërë
25 takim me mbledhje të rëndësishme me përfaqësues të nivelit të

1 lartë të diplomacisë dhe politikës ndërkombëtare.”

2 E dini pse Adem Demaçi apo keni ndonjë ide pse Adem
3 Demaçi ka udhëtuar, mund të ketë udhëtuar më 24 shkurt në
4 Lubjanë për të takuar përfaqësues ndërkombëtarë?

5 Z. PACE: [Përkthim] Është pyetje spekuluese sepse
6 dëshmitari tha që nuk e ka takuar kurrë Adem Demaçin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
8 Mund të përgjigjet.

9 DËSHMITARI: Po, e kuptova unë pse ai kishte shkuar të
10 takohet me diplomatë në Slloveni dhe pastaj, më vonë, e
11 kuptova këtë sepse ai në këtë rast pati edhe bisedën
12 telefonike me znj. Albright nga aty kontaktoi në telefon znj.
13 Albright. Pra, ka shkuar atje për të patur bisedime
14 diplomatike. Dhe kur Madeleine Albright e kontaktoi atë, më
15 kujtohet që --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë.

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një herë
19 z. Rubin po përgjigjeni përtej pyetjes që ju është bërë.
20 Pyetja ishte nëse e dini që pse po shkonte atje dhe çfarë po
21 bënte.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 Në qoftë se mund të kalojmë në faqen tjetër në fund të
24 faqes në përgjigje të një pyetjeje z. Kurti përgjigjet:

25 “Nisja e delegacionit shqiptar në Rambuje në Francë ka

1 qenë gjest i vullnetit të mirë', tha Kurti në përgjigje të një
2 pyetjeje se pse delegacioni me 15 anëtarë shkoi në Rambuje
3 ndërkohë që nuk ishin të autorizuar për të nënshkruar dhe
4 shtoi se me këtë gjest UÇK-ja kishte treguar se ishte' e
5 gatshme të sakrifikonte diçka vetëm që të gjente një zgjidhje
6 për Kosovën, një shans dhe përkundër regjimit serb ishte
7 interesuar për një zgjidhje politike.'"

8 Ajo që thuhet këtu a përputhet me atë që përfundimisht ju
9 patë dhe ndodhi si përvojë në Rambuje, pra, që delegacioni
10 shkoi atje por thanë që nuk kishin autoritetin për të
11 nënshkruar?

12 PË. Një pjesë e anëtarëve të delegacionin e thanë këtë gjë.
13 Është e saktë.

14 PY. Cilët anëtarë në veçanti?

15 PË. Hashim Thaçi.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, dorëzoj këtë provë
18 materiale në prova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
20 kundërshtim?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12050 deri
23 në 12052-ET pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
25 provës materiale 1D373. Vërej se versioni në shqip është në

1 *Legal Workflow*. Është pjesë e provës materiale?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund t'i shtohet.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Do t'i shtohet edhe përkthimi shqip. Atëherë, faleminderit,
5 znj. Sekretare.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Z. Rubin, dje dhe këtë e gjejmë në transkriptin e
8 përkohshëm, paraprak, në faqen 137138 dhe pyetja që u bë nga
9 Gjykatësi Mettraux ishte:

10 "Dhe mesa duhet, apo jo, duket që e vetmja figurë që në
11 këtë fazë të paktën, do të thotë, pas konferencës së parë në
12 Rambuje dhe e vetmja figurë në këtë fazë të paktën që
13 kundërshtonte Rambujenë ishte Demaçi, apo jo?

14 "PË. Nuk e di këtë. Di atë që po lexoj, nuk e di nëse ka
15 qenë dhe dikush tjetër."

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
17 ekran tani provën materiale 1D251.

18 PY. Z. Rubin, ky është një version tjetër i provës materiale
19 që të tregoi Gjykatësi Mettraux dje. Është identike. Po ju
20 kujtoj që ju u promovuat në sekretar të shtetit dje?

21 PË. Nuk e harroj atë lehtë.

22 PY. Po. E shihni paragrafin?

23 PË. Po.

24 PY. Në rregull. Jam interesuar për atë, unë në fakt jam i
25 interesuar në paragrafin më sipër këtij. Në rregull. Ku lexon:

1 *"The Independent, pra, gazeta The Independent, në Londër*
2 *raportoi sot se në një ceremoni të shtunën", që ne e dimë që*
3 *ishte më 6 mars sepse artikulli është i datës 9 mars, pra, të*
4 *shtunën më 6 mars që "shënonte përvjetorin e parë të vrasjes*
5 *së themeluesit të UÇK-së Adem Jashari nga forcat e sigurisë*
6 *serbe, shefi i shtabit të UÇK-së, Sylejman Selimi,*
7 *'paralajmëroi ... se rebelët nuk do të pranonin kompromis.*
8 *Masat e gjysmuara për një pavarësi të gjysmuar janë të*
9 *papranueshme përveç nëse ato çojnë në pavarësi të plotë', tha*
10 *ai."*

11 A e shikoni këtë?

12 PË. Po, e shikoj.

13 PY. Tani, a e dinisë kush ishte Sylejman Selimi në atë kohë?

14 PË. Nuk mund të them që e dija se kush ishte në atë kohë.

15 PY. A e dini kush ishte paraardhësi i menjëhershëm i Agim

16 Çekut?

17 PË. Jo.

18 PY. Në artikull thuhet që ai ishte shefi i Shtabit të UÇK-së
19 dhe që po jepte deklarata të paktën që dukeshin në aparencë që
20 kundërshtonin çdo marrëveshje që nuk përfshinte pavarësinë. E
21 shikoni këtë?

22 PË. E shoh.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të doja që të shfaqim në
24 ekran një dokument të Shtetet e Bashkuara 1D010.

25 PY. Ky është raporti i Shërbimit të Hulumtimit të Kongresit.

1 E njihni këtë shërbim?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 17.

4 PY. Kjo është një kronologji e ngjarjeve e përgatitur nga

5 Shërbimi i Hulumtimeve të Kongresit dhe siç e shihni mban

6 datën 2 mars dhe aty lexon:

7 "UÇK-ja caktoi Hashim Thaçin udhëheqës të qeverisë së
8 përkohshme të Kosovës. Lëvizja (duket) se lë mënjanë edhe më
9 tej udhëheqjen e Ibrahim Rugovës ... të nesërmen Adem Demaçi
10 dha dorëheqjen nga pozita e tij si këshilltar politik i UÇK-
11 së. Demaçi ishte kundër marrëveshjes së Rambujesë."

12 Pra, që të kemi parasysh dorëheqja ka ndodhur ose më 2
13 mars ose më 3 mars. Pastaj kemi një paragraf tjetër që thotë:

14 "Ish-Senatori Bob Dole u takua me anëtarë të delegacionit
15 të shqiptarëve, u takua me ta në Maqedoni dhe jo në Kosovë.
16 Dole u bëri thirrje me ngulm delegacionit shqiptar që të
17 nënshkruajnë marrëveshjen e paqes duke e quajtur atë si
18 marrëveshja 'më e mirë e mundshme'. Hashim Thaçi nuk mori
19 pjesë në takim me Dole."

20 Pastaj më 8 mars:

21 "Pas një takimi, mbledhje të gjatë me të dërguarin e
22 Shtetet e Bashkuar, Christopher Hill në Prishtinë, UÇK-ja u
23 pajtua që të pranojë Marrëveshjen e Paqes së Rambujesë."

24 Do t'ju kërkoja që t'i mbani këto data në mendje.

25 Pastaj e dimë që ky Trup Gjykues ka pranuar prova se më 5

1 mars - dhe kjo është P1264, fillon me SPOE001228805 - i
2 dërguari i posaçëm i BE-së në Kosovë, Wolfgang Petrisch dhe
3 zëvendësi i tij Jan Kickert shkuan në Kosovë dhe u takuan me
4 udhëheqës të UÇK-së përfshirë Sylejman Selimin emrin e të
5 cilit sapo ua tregova, Ramë Buja, Jakup Krasniqi, Fatmir Limaj
6 dhe Rexhep Selimi me qëllim që t'i inkurajonin ata që
7 nënshkruanin Marrëveshjen e Rambujesë.

8 A e dini ju pse delegacioni i BE-së është takuar me
9 udhëheqës të lartë të UÇK-së më 5 mars, tre ditë përpara se
10 Adem Demaçi të japë dorëheqjen?

11 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo pyetje, po i bëhet
12 pyetja atij për të spekuluar lidhur me delegacionin e BE-së
13 ndërkohë që nuk bëhet fjalë as për autoritete e Shtetet e
14 Bashkuara. Nuk ka bazë për këtë pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
16 përgjigjet pyetjes.

17 A e dini?

18 DËSHMITARI: Jam i sigurtë që e di.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. A mund të na thoni çfarë dini ju?

21 PË. Gjatë asaj kohe me udhëheqës të delegacionit të BE-së dhe
22 të delegacionin të SHBA-ve ishin shumë, shumë të shqetësuar
23 për t'u siguruar që donin të siguroheshin që delegacioni
24 shqiptar i Kosovës do të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë
25 dhe që do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e

1 domosdoshme për ta që të udhëtonin, pra, ishte e domosdoshme
2 dhe e rëndësishme që të shkojnë atje dhe ta konfirmonin këtë
3 gjë.

4 PY. Juve ju tregua kabllogrami i Shtetet e Bashkuara të 25
5 shkurtit 1999 nga Gjykatësi Mettraux dhe ju kujtohet që në atë
6 kabllogram raportet apo është shënuar që z. Krasniqi dhe z.
7 Ramë Buja thanë që ata do të kujdeseshin, do të merreshin me
8 z. Adem Demaçin. Ju kujtohet ky dokument?

9 PË. Po.

10 PY. Tani, këta të dy janë të pranishëm në mbledhjen me
11 Sylejman Selimin, Fatmir Limajn, Rexhep Selimi, duke diskutuar
12 nëse do të pranojnë marrëveshjen në Rambuje. Pyetja ime është
13 a keni ju ndonjë njohuri pse z. Krasniqi dhe Ramë Buja kanë
14 marrë pjesë në këtë mbledhje, duke qenë se z. Hill sugjeroi në
15 këtë kabllogram të 25 shkurtit, se ka qenë vetëm Adem Demaçi
16 që ishte problematik që duhej të trajtohej, të merresh me të.

17 PË. Me sa kuptoj edhe një herë këtu, unë ashtu si e kuptoj
18 është se çështja ishte që të siguroheshin marrëveshja
19 specifike që do ta nënshkruanin të gjithë anëtarët e
20 delegacionit në Rambuje, ishte pyetja akoma hapur deri në
21 momentin që do ta nënshkruanin atë, nuk dihej akoma dhe
22 përpjekjet për t'u takuar me udhëheqësit e UÇK-së të cilët ata
23 që ishin më skeptik në Rambuje, kjo ishte përpjekja dhe tani
24 ne shpresonim do të merrnim, do të çojnë në Kosovë ofertën
25 tonë për të përdorur fuqinë ushtarake nëse ata nuk

1 nënshkruanin, kjo ofertë do të ndryshonte mendjen e tyre dhe
2 qëndrimin e tyre, do t'i bënte ata më shumë të gatshëm për t'u
3 pranuar dhe për të nënshkruar.

4 Pra, gjithçka që po ndodhte pastaj ishte për këtë qëllim,
5 pra, kjo është arsyeja se pse mund të kenë marrë pjesë në këtë
6 takim. Kjo është arsyeja se ne kemi dashur të takohemi me ta
7 dhe një takim me ta nuk ishte i mjaftueshëm, vetëm një. Duhej
8 të bëheshin sa më shumë takime që të ishte e mundur që të
9 përgatitej dhe të sigurohej që nënshkrimi do të ndodhte.

10 PY. Faleminderit. Kërkoj ndjesë që po e përsëris, por pyetja
11 ime e radhës pak a shumë e njëjtë: Nëse Adem Demaçi e dha
12 dorëheqjen më 2 mars dhe ai ishte i vetmja pengesë për
13 nënshkrimin, pse Senatori Dole udhëtoi në rajon më datën 5
14 mars?

15 PË. Dhe këtu nuk mendoj që ka qenë vetëm një figurë që ishte
16 arsyeja vendimtare pro apo kundër nënshkrimit të Marrëveshjes
17 së Rambujesë. Senatori Dole po vepronte, ai ishte senator i
18 nivelit të lartë republikan, por edhe pajtohej me politikat e
19 delegacionit të Clinton. Ai po ndihmonte që të siguronim
20 nënshkrimin e delegacionit shqiptar aty ku kishte mbështetje
21 të fuqishme në komunitet.

22 Ai ka mbledhur është takuar me të gjithë personat me të
23 cilët duhej të takohesh, është përpjekur sa më shumë që të
24 ishte e mundur të paktën duke u siguruar që ata do të
25 nënshkruanin kur të vinin në Paris, pra, ishte një

1 përpjekje gjithëpërfshirëse diplomatike e senatorëve, e imja,
2 Christopher Hill e të gjithëve.

3 PY. Pyetja ime përpara pushimit ishte sapo po përmendët Chris
4 Hill dhe përpjekjet diplomatike gjithëpërfshirëse të
5 gjithanshme dhe unë ju tregova kronologjinë në këtë ekran më 8
6 mars, Christopher Hill pati një takim të gjatë me UÇK-në pesë
7 apo gjashtë ditë pasi Adem Demaçi dha dorëheqjen. A mund të na
8 thoni pse z. Hill ka patur nevojë të shkojë në Prishtinë më
9 datën 8 ndërkohë që Demaçi nuk kishte pengesa e vetme?

10 PË. Po e përsëris aq thjesht sa të jetë e mundur. Gjithçka që
11 jep një përmbledhje të asaj, diçka që jep një përmbledhje të
12 asaj që thashë, kjo mund të ketë qenë arsyeja.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndoshta, z. Gjykatës, është koha,
15 momenti i duhur që të bëjmë pushim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
17 një pushim dhjetë minutash. Kështu që, Dëshmitar, ju lutem mos
18 flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do të më duhen edhe 15
21 minuta për të përfunduar pyetjet e mia. Dhe pastaj dëshmitari
22 i radhës është i gatshëm të paraqitet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Seanca ndërpritet deri në orën 10.10.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

1 --- Seanca rifillon në orën 10.10

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa
3 të fillojmë do ju kërkoja të gjithëve që të mos kemi njoftim
4 nga telefonat tuaj, ose të mos kesh zhurma zileshe, kështu që
5 do ju kërkoja që të fiknit telefonat ose t'i kalonit ato në
6 silent.

7 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
10 thotë që do ketë dhe 20 minuta të tjera pyetje. Ju lutem
11 dëgjojeni, Dëshmitar.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës. Në
13 fakt mbase kam më pak kohë sesa aq.

14 PY. Z. Rubin, dje Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje që
15 kishte të bënte pak a shumë me faktin në qoftë se juve ju
16 nevojitet që të shikonit urdhra dhe raporte të brendshme për
17 të kuptuar se kush ishte përgjegjës. A ju kujtohet kjo pyetje,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Kjo është dita e tretë e dëshmisë suaj, a ju kujtohet në
21 qoftë se ndokush në çdo kohë, përfshirë dhe gjatë kohës kur
22 keni dhënë dëshmi këtu, ju ka treguar një urdhër të lëshuar
23 prej Hashim Thaçit nga krahu ushtarak i UÇK-së?

24 PË. Jo, nuk kam parë asnjëherë një gjë të tillë.

25 PY. A ju kujtohet ndonjëherë që ndokush, duke përfshirë dhe

1 gjatë dëshmisë tuaj këtu --

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Transkriptuesi më duket sikur nuk
3 është në sallë. Duket sikur kemi filluar pa transkriptuesin.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Të filloj dhe një herë nga
6 fillimi?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Do fillojmë dhe një herë nga a para, z. Rubin. A ju
10 kujtohet që dje Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje ku ju
11 sugjeroi që juve ju duhej që të shikonit urdhrat e brendshëm
12 dhe raportimin e brendshëm për të kuptuar se kush ishte
13 përgjegjës. Ju kujtohet kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Kjo është dita e tretë e dëshmisë tuaj. A ju kujtohet a
16 ka pasur ndonjë person në çdo kohë, përfshirë dhe gjatë kohës
17 së dëshmisë tuaj t'ju ketë treguar ndonjë urdhër të lëshuar
18 prej Hashim Thaçi për ndokënd në krahun ushtarak të UÇK-së?

19 PË. Jo.

20 PY. A ju kujtohet ndonjë person në çdo kohë, përfshirë dhe
21 dëshminë tuaj këtu përpara Trupit Gjykues, t'ju ketë treguar
22 një raport që është dërguar në krahun ushtarak të UÇK-së prej
23 Hashim Thaçit?

24 PË. Jo.

25 PY. A e dini se ku ka qenë Hashim Thaçi, në qoftë se Hashim

1 Thaçi ka qenë në Kosovë gjatë të gjithë kohës në periudhën nga
2 nëntori i '98-s deri në qershor të '99-s, pra në 19 qershor
3 1999, përveç kohës kur ju keni komunikuar në mënyrë të
4 drejtpërdrejtë me të?

5 PË. Nuk kam qenë në dijeni të lëvizjeve të tij, por besoj që
6 kur kam folur me të ai ka qenë në Kosovë.

7 PY. Ju keni folur me të në Rambuje?

8 PË. Po them gjatë kohës që bombardimit. Unë mendoj që gjatë
9 asaj kohë, edhe sigurisht e kam parë në Rambuje, e kam parë në
10 Paris dhe në Kosovë vetëm.

11 PY. Në qoftë se ka qenë në Kosovë për pjesën më të madhe të
12 kohës, si do kishte ndikim kjo mbi përshtypjen tuaj që --

13 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj këtë
14 linjë pyetjesh sepse dëshmitari tha që nuk e dinte se ku ka
15 qenë z. Thaçi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
17 bëjeni ndryshe pyetjen.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Juve iu bënë shumë pyetje lidhur me autoritetin *de facto*
20 që keni pasur, Dëshmitar.

21 PË. Po, më kujtohet.

22 PY. Në rregull. Pyetja ime është kjo: Në qoftë se ai nuk ka
23 qenë në Kosovë për pjesën dërmuese të kohës përveç bombardimit
24 të NATO-s, a do ndryshonte kjo përshtypjen tuaj për
25 autoritetin e z. Thaçi sa i takon raportit të tij me krahun

1 ushtarak të UÇK-së?

2 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka bazë kjo pyetje sepse pyetja
3 është hipotetike sepse dëshmitari e tha dhe më përpara që nuk
4 e dinte kur ka lëvizur z. Thaçi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
6 përgjigjuni.

7 DËSHMITARI: Do kishte ndikim mbi përshtypjen time.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Si do kishte ndikim mbi përshtypjen tuaj?

10 PË. Do konfirmonte më tepër pikëpamjen time që ai nuk ishte
11 udhëheqësi ose lideri i krahut ushtarak të UÇK-së.

12 PY. Një pyetje të fundit. Kjo lidhet me diçka çfarë ka thënë
13 Ambasadori Hill. Do ju tregoj një dokument dhe do ju pyes më
14 pas në qoftë se ju pajtohem me atë çfarë ka thënë ai.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti është DHT09343 deri në
16 DHT09350. Ju lutem paraqiteni në ekran.

17 PY. Për t'ju orientuar, bëhet fjalë për një intervistë, një
18 intervistë të gjatë që Ambasadori Hill ka dhënë në vitin 2002.
19 Një intervistë e dhënë 23 vite më përpara.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen DHT09230
21 [Sipas përkthimit].

22 PY. Sa për t'ju orientuar dua t'ju them që në këtë faqe ai
23 përshkruan periudhën midis Rambujesë edhe Parisit. Pyetja që i
24 bëhet atij nga një person që quhet Blerim Shala është kjo:

25 "Lojtari kryesor këtu ishte Thaçi. Kur keni shkuar në

1 Shtabin e UÇK-së ju keni gjetur pak a shumë persona që kishin
2 një humor pozitiv, apo jo?"

3 Ambasadori Hill thotë:

4 "Po, e kam ndjerë që ka pasur një ndjesi pozitive. Por
5 pyetja ishte se ku ishte Thaçi."

6 Shala thotë:

7 "... gjatë kësaj periudhe ..."

8 Hill thotë:

9 "Nuk e di në qoftë se ju kujtohet, por Senatori Dole,
10 pyeste vazhdimisht që 'ku ishte Thaçi'. Ata i thonin Thaçit që
11 -- i thonin që Thaçi do kthehej në Kosovë, por në atë pikë
12 ishte shumë e qartë për mua që Thaçi nuk ishte asnjë lloj
13 komandanti kryesor."

14 A pajtoheni ju me këtë çfarë ka thënë Ambasadori lidhur
15 me pozicionin e z. Thaçi në atë kohë, pra në vitin 1999?
16 PË. Absolutisht pajtohem me të. Z. Thaçi nuk ka qenë asnjë
17 lloj komandanti kryesor. Edhe unë i të njëjtit mendim ja.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Kryegjykatës, do të
19 doja që dokumenti të pranohet në prova materiale. Dokumenti ka
20 numrin DHT09320 deri në DHT09350. Faqja që dua të pranohet
21 konkretisht është DHT09320.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

23 Z. PACE: [Përkthim] Kemi kundërshtim lidhur me
24 kontekstin. Avokati e dha kontekstin për procesverbal, por nga
25 ana tjetër për ne është e rëndësishme që t'i jepet konkretisht

1 konteksti sepse nuk e dimë se çfarë lidhje ka kjo pyetje.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se doni mund t'i kthehem
3 edhe faqeve më përpara. Domethënë, mund të kërkoj pranimin e
4 faqeve pararendëse për të dhënë më shumë kontekst.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull, dhe jemi dakord me këtë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
8 DHT09318 deri në 09320 pranohet në prova gjyqësore.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i jepet numri i
10 provës 1D374.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
12 Mund të vazhdoni.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]
14 PY. Z. Rubin, nuk kam pyetje të tjera për ju. Ju falënderoj
15 shumë për kohën që na dedikuat dhe për faktin që erdhët në
16 Hagë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam dhe unë
19 disa pyetje, disa çështje për të trajtuar me dëshmitarin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. DIXON: [Përkthim] Me çë kuptoj unë siç ka qenë rasti
22 edhe me dëshmitarët e Prokurorisë, ne kemi të drejtë të bëjmë
23 pyetje që kanë të bëjnë me pyetjet e bëra nga Gjykatësit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Mund të
25 vazhdoni, por duhet thjesht të bëni pyetje që rrjedhin ose

1 burojnë nga pyetjet e Gjykatësve.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

3 Z. DIXON: [Përkthim]

4 PY. Kam disa pyetje për ju të lidhura me pyetjet që janë bërë
5 dje dhe sot. Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje.

6 Për pavarësisht kjo pasqyrohet në faqen 150 të
7 transkriptit në kohë reale.

8 "Do e përmbledh pyetjen dhe besoj që përgjigja mund të
9 mjaftojë me një po ose jo prej jush, dhe në qoftë se ajo çfarë
10 do të them unë duke iu referuar pyetjes, në qoftë se nuk është
11 e plotë, mund ta plotësoni ose mund ta shtjelloni atë më tej.
12 Sipas mendimit tuaj nuk ka pasur Qeveri të Përkohshme të
13 Kosovë dhe Shtab të Përgjithshëm për të folur, dhe të gjithë
14 anëtarët pretendonin të ishin anëtarë të subjekteve ose të
15 strukturave që nuk ekzistonin."

16 Dhe ju thatë që:

17 "Ajo nuk i ngjante asgjëje, nuk dukej sikur kishim të
18 bënim me një ushtri të organizuar me një Shtab të Përgjithshëm
19 dhe për këtë arsye ishte e vështirë që të merreshin armë nga
20 perëndimi."

21 Dhe ju thoni më tej që:

22 "Kjo do ishte një gjë e duhur nga një grup i tillë për ta
23 përshkruar veten sikur ishin më të organizuar sesa ç'ishin
24 faktikisht."

25 A ju kujtohet që i jeni përgjigjur kështu pyetjes së bërë

1 nga Gjykatësi Mettraux dje, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. A është e saktë, z. Rubin, se dëshmia juaj është që
4 personat e UÇK-së i referoheshin një Shtabi të Përgjithshëm
5 ose i referoheshin brigadave dhe zonave, por në fakt, çështja
6 me të cilin ju haseshit dhe po trajtonit ishte në qoftë se
7 kishte struktura të organizuara siç duhej ose siç paraqiteshin
8 këto struktura, ndërkohë që ju thatë që thjesht zmadhohej ose
9 ekzagjerohej realiteti prej tyre. A keni thënë kështu,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Tani do kaloj tek një pyetje që ju bë sot në mëngjes nga
13 Gjykatësi Gaynor. Pyetja është pasqyruar në faqen 9 të
14 transkriptit në kohë reale të ditës së sotme. Nga dëshmia që
15 keni dhënë gjatë dy ditëve të fundit Gjykatësi Gaynor thotë që
16 ju keni arritur në përfundime të caktuara sa i takon
17 strukturës dhe sa i takon sistemit të kontrollit dhe komandës
18 UÇK-në kryesisht për shkak të bisedave që keni pasur me
19 udhëheqësit e UÇK-së në Rambuje dhe si rezultat i tre ditëve
20 ose 72 orëve që ju keni shpenzuar në Kosovë në verë të vitit
21 1999. A është e vërtetë kjo?"

22 Ju thoni:

23 "Po ..."

24 Më pas ju bëhet pyetja tjetër lidhur me dokumente që ju
25 mund të keni parë. Unë nuk do ju bëj pyetje lidhur me

1 dokumente se e di që kjo është një temë sensitive, megjithatë,
2 më tej në dëshminë tuaj ju thoni, në transkript në faqen 11,
3 që:

4 "Unë isha dikush që kisha kompetenca të jashtëzakonshme
5 të dhëna nga Sekretarja Albright dhe nga Presidenti. Në qoftë
6 se unë kërkoja të merrja një informacion të caktuar nuk më
7 mohohej asnjëherë informacioni. Gjatë punës time unë kam
8 rishikuar dhe kam lexuar sa më shumë informacion sa kam pasur
9 mundësi."

10 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Tani dua që t'ju referoj paragrafin 11 të deklaratës tuaj
13 dhe në ditën e parë të dëshmisë tuaj ju keni thënë që në '98-n
14 në '99-n, ku keni parë të gjitha informacionet që ju kanë
15 ardhur përmes kabllogrameve, informacion inteligjent dhe
16 informacion nga media. A keni thënë kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A kam të drejtë unë të them që dëshmia juaj është që nga
19 të gjitha përvojat tuaja në atë kohë, nga të gjitha takimet
20 tuaja, dhe si rezultat i të gjithë rishikimit të materialeve
21 që keni parë e keni lexuar, keni shqyrtuar, pa u futur në
22 shumë hollësi në disa prej dokumente për shkak të arsyeve që
23 ne e dimë, a është e vërtetë të thuhet që ju nuk keni parë
24 asgjë në këto materiale që tregonte që UÇK-ja të ishte një
25 forcë e mirëorganizuar ushtarake me një strukturë komande

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 45

1 vertikale, por në fakt e kundërta ishte e vërtetë, që ishte
2 një strukturë e paorganizuar dhe që anëtarët e saj thjesht e
3 ekzagjeronin mënyrën e funksionimit dhe organizimit të saj?
4 PË. Është një përmbledhje e shkëlqyer e asaj çfarë kam thënë.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Dëshmitar, faleminderit që ishit me ne. Ky është fundi i
8 dëshmisë suaj. Ju falënderojmë dhe një herë që ishit në sallë
9 dhe nuk kemi më detyrime të tjera para Gjykatës.

10 DËSHMITARI: Faleminderit dhe juve dhe dëshiroj të them ka
11 qenë privilegj për mua të jem këtu, pavarësisht që zgjati pak
12 si shumë, është një kënaqësi e madhe për mua dhe është një
13 përdorim shumë i rëndësishëm i kohës time dhe është shumë me
14 rëndësi për mua që isha këtu dhe ju thatë mendimet e mia dhe
15 dhashë dëshminë time në këtë çështje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
17 edhe përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara. Faleminderit për
18 ndihmën dhe për faktin që ishit me ne sot këtu.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do bëjmë
21 një pushim prej dhjetë minutash pastaj do thërrasim
22 dëshmitarin e radhës. A mjafton kaq kohë?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po. Besoj se dëshmitari është
24 këtu. Për aq kohë sa dëshmitari është në sallën pritjes nuk
25 besoj të kemi problem që të rifillojmë për dhjetë minuta.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 --- Seanca ndërpritet në orën 10.28

3 --- Seanca rifillon në orën 10.39

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
5 korrigjoj diçka pse ju thashë qëparë. Nuk duhet të keni
6 telefona të ndezur, në fakt, nuk duhet të keni fare telefona
7 në sallën e gjyqit se mos dhanë ndonjë mesazh të gabuar. Nuk
8 lejohen telefonat.

9 Tani do të vijë dëshmitari tjetër. Përpiqemi të bëjmë
10 pyetje deri në orën 11.00 se të akuzuarit nuk kanë dalë as nga
11 salla e gjyqit që kur kemi filluar. Do bëjmë pushimin e orës
12 11.00 si zakonisht, edhe do vazhdojmë sipas planit të
13 zakonshëm.

14 Sillni dëshmitarin në sallë.

15 Për procesverbal tani presim të vijë në sallë Dëshmitari
16 i Mbrojtjes së Thaçit DW-001.

17 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
19 Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
22 tani do të merrni tekstin e betimit solemn të cilin duhet ta
23 lexoni në bazë të Rregullores së Procedurës. Ju lutem, lexoni
24 me zë të lartë tekstin që keni përpara.

25 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime

1 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
2 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, dhe
3 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

4 DËSHMITARI: PAUL WILLIAMS

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 uleni.

7 DËSHMITARI: Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 sot fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet se do të zgjasë një
10 ditë e gjysmë.

11 Sikurse mund ta dini, fillimisht do t'jua bëjë pyetjet
12 Mbrojtja e Thaçit dhe më pas ekipet e tjera të Mbrojtjes. Pas
13 Mbrojtjes, ZPS-ja ka të drejtë t'ju bëjë pyetje por edhe
14 Gjykatësit e Trupit Gjykses mund të kenë pyetje për ju.

15 Mbrojtja e Thaçit ka parashikuar dy orë për pyetjet.
16 Ekipet e tjera të Mbrojtjes së bashku kanë kërkuar dy orë e
17 gjysmë. ZPS-ja, pra, Prokuroria ka parashikuar po ashtu dy orë
18 e gjysmë. Inkurajoj të gjitha palët të jetë sa më të
19 kujdesshme në shfrytëzimin e kohës gjatë pyetjeve të veta.
20 Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje shtesë nëse përmbushen
21 kushtet për këtë.

22 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
23 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që pyetja të
24 përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni se ta sqarojmë.
25 Gjithashtu mos harroni të na thoni bazën, faktet, rrethanat

1 për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

2 Në qoftë se Prokuroria [Sipas përkthimit] e Thaçit ju
3 kërkon të flisni për korrigjimet që keni bërë në deklaratën
4 tuaj, ju lutem, konfirmoni për procesverbal se deklarata me
5 shkrim, bashkë me korrigjimet përkatëse pasqyron saktësisht
6 dëshminë tuaj.

7 Gjithashtu, flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë
8 sekonda përpara se të përgjigjeni në mënyrë që t'ju ndjekin
9 dhe përkthyesit.

10 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
11 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
12 jashtë Gjykatës. Nëse dikush ju bën pyetje jashtë Gjykatës për
13 dëshminë tuaj, ju lutem, na vini në dijeni.

14 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse jua kërkoj unë,
15 gjithashtu ndërprisni fjalën nëse më shihni që po ngre dorën,
16 sepse kjo do të thotë që unë duhet të jap një udhëzim të
17 caktuar. Në çdo moment që keni nevojë për pushim, apo doni të
18 thoni diçka, ju lutem na vini në dijeni dhe do të bëjmë
19 organizimin përkatës.

20 Do të fillojmë tani me pyetjet nga z. Misetic, që
21 përfaqëson ekipin e Mbrojtjes së Thaçit.

22 Z. Misetic, fjala është për ju.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 Pyetje nga z. Misetic:

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 49

1 PY. Mirëmëngjesi, Dr. Williams.

2 PË. Mirëmëngjes.

3 PY. Jemi takuar më përpara, por për procesverbal, jam Luka
4 Misetic, dhe jam avokati për z. Thaçi. Ju lutem, për
5 procesverbal na thoni emrin.

6 PË. Paul Williams.

7 PY. Datëlindja.

8 PË. 3 qershor 1968 [Sipas përkthimit].

9 PY. Kombësia?

10 PË. Amerikan

11 PËRKTHYESJA: 65, më falni.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. A i keni dhënë një deklaratë Mbrojtjes së Thaçit të cilën
14 e keni nënshkruar në korrik 2025, 17 korrik, më konkretisht?

15 PË. Po.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të nxjerrë në
17 ekran materialin DHT10224, DHT10230.

18 PY. E njihni këtë dokument, Dr. Williams?

19 PË. Po.

20 PY. A është ky një procesverbal i deklaratës që i keni dhënë
21 ekipit të Mbrojtjes së Thaçit?

22 PË. Po.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit,
24 DHT10230.

25 PY. A është ky nënshkrimi juaj?

1 PË. Po.

2 PY. A keni pasur shans ta lexoni dokumentin përpara se ta
3 nënshkruanit?

4 PË. Po.

5 PY. A patët po ashtu mundësi ta shikoje sërish këtë dokument
6 javën e shkuar?

7 PË. Po.

8 PY. A keni pasur mundësi të takoheni me mua dhe kolegët e mia
9 javën e kaluar përmes videokonferencës?

10 PË. Po.

11 PY. Në këto takime a të është dhënë mundësia t'i bëje
12 korrigjime dhe sqarime këtij dokumenti?

13 PË. Po.

14 PY. A ke bërë ndonjë korrigjim apo sqarim për këtë dokument?

15 PË. Jo.

16 PY. Informacioni që na keni dhënë në këtë deklaratë, a është
17 i saktë dhe i vërtetë me aq sa besoni dhe mendoni ju?

18 PË. Po.

19 PY. Informacioni në deklaratën tuaj dhënë për Mbrojtjen e
20 Thaçit a pasqyron saktësisht atë që do të thoni po t'ju bënin
21 të njëjtat pyetje sot në sallën e gjyqit njësoj siç ju janë
22 bërë këto pyetje kur keni bërë deklaratën?

23 PË. Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
25 pranimin e deklaratës së Dëshmitarit DHT 10224 deri në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 51

1 DHT10230 edhe dy provat materiale shoqëruese që në fakt janë
2 pranuar përkohësisht nga Trupi Gjykses në vendimin F3447.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
4 kundërshtime?

5 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
7 materiali DHT10224, DHT10230 bashkë me provat materiale
8 shoqëruese që përmendi Mbrojtja, pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata DHT10224 deri
10 në DHT10230 do të marrë numrin e provës 1D3075. Prova e parë
11 materiale shoqëruese që është brenda gamës së dokumenteve 1D -
12 - DHT, më falni, 10231, DHT10260 me faqe DHT10231-234 do të
13 marrë numrin e provës 1D376. Ndërsa prova e dytë materiale
14 shoqëruese, faqe DHT10235 deri në DHT1 -- që përfundon me 237
15 në fund, do të marrë numrin e provës 1D377.

16 Të gjithë kanë klasifikimin konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëni
18 riklasifikimin si publik.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, duhet të jenë publikë.
20 Faleminderit.

21 Më 12 shtator 2025 Mbrojtja e Thaçit dorëzoi me email një
22 përmbledhje për këtë dëshmitar që është pranuar përfundimisht
23 sipas rregullës 154 për palët edhe të gjithë pjesëmarrësit.
24 Nuk pati kundërshtime për përmbledhjen e propozuar, kështu që
25 me lejen tua, unë dëshiroj të lexoj përmbledhjen.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lejohet.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

3 Paul Williams ka qenë këshilltar falas për delegacionin
4 kosovar në Rambuje në shkurt dhe mars të 1999-s. Ai ka
5 ndihmuar delegacionin për hartimin e propozimit të tyre dhe me
6 negociatat në marrëveshjen e Rambujesë. Po ashtu ka marrë
7 pjesë në takime me delegacionin kosovar dhe me figura
8 ndërkombëtare dhe me diasporën e Kosovës dhe ka dhënë
9 informata për shtypin në emër të delegacionit.

10 Ai do të japë dëshmi për vendimmarrjen -- procesin e
11 vendimmarrjes së delegacionit dhe objektivat e delegacionit,
12 si dhe diskutimet që janë bërë për nevojën për demilitarizim
13 dhe transformim të UÇK-së.

14 Dr. Williams, po ashtu do të japë dëshmi për komunikimet
15 që ka pasur me gjithë anëtarët e delegacionit kosovar, mes të
16 cilëve dhe Hashim Thaçi. Konstatimet dhe përshtypjet që ka
17 formuar ai nga këto komunikime të cilat e ndihmuan për të dalë
18 në përfundimin që Thaçi nuk kishte autoritetin për të
19 nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, dhe se i duhej miratimi i
20 komandantëve të zonave për ta bërë këtë.

21 Po ashtu vuri re strukturën *ad hoc* dhe të decentralizuar
22 të UÇK-së dhe autoritetin që kishin komandantët e zonave edhe
23 bindjen ideologjike apo ndikimin ideologjik të Adem Demaçit.

24 Me kaq përmbyll përmbledhjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Dr. Williams, dua t'ju rikujtoj se meqë flasim të dy
3 anglisht duhet të bëjmë pauzë mes pyetjeve dhe përgjigjeve në
4 mënyrë që stenografët dhe përkthyesit të kenë mundësi të
5 përfundojnë fjalitë e veta. E di që e kuptoni këtë se e shoh
6 që po pohoni me kokë, por thjesht për rikujtesë për të dy ne.

7 Dr. Williams, në deklaratën tuaj, ju shpjegoni se jeni
8 profesor i juridikut dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në
9 Washington DC dhe se jeni bashkë-themelues i Grupit për
10 Politika për të Drejtën Ndërkombëtare që është një organizatë
11 jo-qeveritare e cila ofron ndihmë falas për palët të përfshira
12 në negociata për paqen në situata pas një konflikti edhe për
13 krime lufte.

14 Pyetja ime e parë kjo: Kur është formuar për herë të parë
15 ky grup, Grupi për të Drejtën Ndërkombëtare dhe për Politikat?
16 PË. Në 1994.

17 PY. Po ashtu keni thënë se keni dhënë ndihmë për shumë
18 tribunalë penalë ndërkombëtarë dhe keni ndihmuar dhe krijimin
19 e tribunaleve vendase. A mund të na tregoni diçka më shumë
20 çfarë keni njohur ju në 1999-n për të drejtën humanitare?

21 PË. Në 1999-n unë e kam njohur shumë mirë të drejtën
22 humanitare ndërkombëtare, bazuar në faktin se kisha punuar dy
23 vjet në Departamentin e Shtetit dhe kam qenë në Zyrën
24 Juridike, ku kam qenë jurist për Çështjet Evropiane dhe
25 merresha me çështjet e shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik

1 dhe Jugosllavisë. Pjesë e portofolit tim përfshinte dhe
2 kontributin që kam dhënë unë në hartimin të rezolutës së OKB-
3 së nga pikëpamja e Amerikës ku përmes të cilës u krijua dhe
4 tribunali i Jugosllavisë.

5 Po ashtu unë jam -- kam punuar dhe me komisionet që kanë
6 trajtuar çështjet e Jugosllavisë.

7 E thashë, në fakt, një si përmbledhje por nëse doni më
8 shumë unë mund të shtjellohem më shumë.

9 Po ashtu kam qenë përgjegjës për deklaratat për shtyp për
10 t'i rishikuar sepse ndonjëherë aty kishte aspekte që lidheshin
11 me t drejtën ndërkombëtare humanitare dhe me krimet e luftës.
12 Pasi u largova nga Departamenti i Shtetit dhe krijova këtë
13 Grup për të Drejtën Ndërkombëtare Publike, Richard Goldstone
14 ishte këshilltar për ne, pasi kishte përfunduar punën në
15 Tribunalin e Jugosllavisë dhe kjo, në fakt, ka qenë një nga
16 klientët e parë *pro bono* ka qenë Prokuroria e ish-Tribunalit
17 të Jugosllavisë. Kemi përgatitur memorandume juridike për
18 Prokurorinë e këtij Tribunali lidhur me aspekte që lidheshin
19 me të drejtën ndërkombëtare humanitare.

20 Po ashtu kam qenë një nga autorët e tjerë -- aktakuzën e
21 Slobodan Milosevic edhe në fakt është botuar dhe një libër në
22 emrin tim. Ka qenë -- ka qenë botuar në shtypet kryesore të
23 *New York*, në Universitetin e *New York*, më falni, edhe e kam
24 dhënë si lëndë këtë. Një nga leksionet e mia ka qenë pikërisht
25 kjo.

1 PY. Faleminderit. Ju thoni që keni qenë këshilltar politik
2 *pro bono*, pra, falas për delegacionin e Kosovë në Rambuje në
3 shkurt dhe mars të '99-s se dhe jeni përzgjedhur si këshilltar
4 me propozim të Kryeministrit Bujar Bukoshi. Kur e mësuar ju
5 këtë se ishit caktuar si këshilltar për delegacionin e
6 Kosovës?

7 PË. Zyrtarisht jam zgjedhur dhjetë ditë, rreth dhjetë ditë
8 përpara se të mbledhej, të organizohej -- të organizoheshin
9 negociatat e Rambujesë. Më ishte thënë më herët nga Bukoshi
10 dhe do më kishte thënë "nëse do të ketë bisedime për paqen në
11 Rambuje, atëherë ai do të kërkonte praninë time". Dhe kjo për
12 shkak të punës që kisha bërë për negociatat e verës, të ashtu-
13 quajturat Hill edhe të Holbrook, në tetor.

14 PY. Kur jeni përfshirë për herë të parë në Kosovë? Ju thatë
15 në verë, tetor -- negociatat e verës dhe të tetorit, po
16 konkretisht kur?

17 PË. Që ta sqarojmë, gjatë verës dhe të vjeshtës të '98-s, po
18 punoja me Bujar Bukoshin dhe përmes tij me Rugovën, dhe deri
19 diku dhe me Veton Serroin [Sipas përkthimit], duke koordinuar
20 ngushtë me diasporën shqiptare në Amerikë që kishin
21 marrëdhënie me këta persona. dhe ata kërkuar ndihmën time *pro*
22 *bono*, udhëzime *pro bono*, lidhur me aspektet që do të
23 negocioheshin. Fizikisht nuk kam shkuar në asnjë vend, kam
24 qenë në Washington dhe New York vetëm për të marrë pjesë në
25 negociata sikurse dhe bëra -- ndryshe nga Rambujeja, më falni,

1 ku shkova fizikisht.

2 PY. Kush ju zgjodhi si këshilltar të delegacionit?

3 PË. Më ftoi Bujar Bukoshi në emër të Presidentit Rugova të
4 shkoja në Rambuje, të udhëtoja drejt Rambujesë dhe të merrja
5 pjesë në bisedimet në shkurt. Më 7 shkurt është bërë një
6 vendim, është marrë një vendim zyrtar me konsensus nga
7 delegacioni kosovar në Rambuje përmes të cilit më ftuan në
8 shkoja në *chateau*, te kështjella ku mbaheshin bisedimet, dhe
9 të isha këshilltari i tyre juridik, këshilltari ligjor. Edhe
10 Edita Tahiri e ka nënshkruar dhe Bajram Kosumi këtë deklaratë
11 zyrtare.

12 PY. Kush ishte Edita Tahiri?

13 PË. Edita Tahiri ka qenë ministre e jashtme e President
14 Rugovës. Pra, President Rugova kishte një qeveri paralele të
15 shqiptarëve të Kosovës ku kryeministër ishte Bujar Bukoshi dhe
16 ministre e jashtme ishte Edita Tahiri.

17 PY. Në paragrafin 16 të deklaratës keni thënë se keni pasur
18 marrëdhënie të ngushtë me Kryeministrin Bujar Bukoshi. Pse
19 mendoni se ka qenë një marrëdhënie e ngushtë?

20 PË. Z. Bukoshi shpesh vinte në Shtetet e Bashkuara ku takonte
21 anëtarë të Kongresit. Bënte intervista në media dhe kur ishte
22 në Washington ai u takua edhe me mua dhe rrija gjatë të gjithë
23 kohës me të si avokat i tij. Ai kishte dhe këshilltarë të
24 tjerë që i jepnin këshilla, por unë isha personi me të cilin
25 kontaktonte ai për aspekte juridike. Sigurisht fliste shumë

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 57

1 mirë anglisht, jetonte në Gjermani. Ishte shumë i
2 drejtpërdrejtë, kështu që ishte e thjeshtë të krijoje një
3 marrëdhënie të ngushtë me të. S'kishte pengesa tradicionale që
4 mund të ndodhin shpesh me klientët që janë *pro bono* që vijnë
5 nga vende të ndryshme dhe nga kultura të ndryshme.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, unë në fakt do të
7 trajtoj një temë të re tani, kështu që është momenti më i
8 përshtatshëm për pushim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ne
10 në orën 11.00 zakonisht bëjmë një pushim që t'i japim të
11 gjithëve mundësinë të dalin pak nga salla e gjyqit. Ne duhet
12 ta respektojmë këtë pushim ndonëse ju sapo filluat. Do të
13 bëjmë pushim deri në 11.30 dhe do të vijojmë me dëshminë tuaj
14 pasi të ktheheni. Mos diskutoni me askënd dëshminë tuaj.

15 DËSHMITARI: Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Bëjmë pushim deri në orën 11.30.

18 --- Pauza fillon në orën 10.59

19 --- Seanca rifillon në orën 11.30

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati, z.
21 Dëshmitar.

22 Vazhdoni pyetjet tuaja, z. Misetic.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Mirë se vini, Dr. Williams.

25 PË. Faleminderit.

1 PY. Në paragrafin 18 të deklaratës tuaj keni deklaruar që në
2 mes të qëllimeve të delegacionit kosovar në konferencën në
3 Rambuje ishte qëllimi për të siguruar, për të marrë angazhim
4 konkret për bashkëpunim me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për
5 ish-Jugosllavinë. Si e dini këtë?

6 PË. Kam punuar në mënyrë intensive me anëtarët e delegacionit
7 gjatë bisedimeve në Rambuje, si dhe me anëtarët të diasporës
8 kosovare në përgatitje për këto bisedime. Dhe në qoftë se
9 dëshironi mund t'ju jap edhe hollësi lidhur me këtë rëndësinë
10 e kësaj e marrëdhënie me diasporën e Kosovës.

11 Sa i takon Rambujesë, mua më përpara m'u kërkuar që të
12 përpiloj, të përgatis, pra, gjuhën e cila ishte sa më
13 gjithëpërfshirëse që të ishte e mundur për të siguruar që
14 Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë të ishte në
15 gjendje në një farë mënyre, pra, që të ndërmernte, të kishte
16 të gjitha përgjegjësitë e vete dhe kompetencat për të zbatuar
17 mandatin e tij.

18 Për kontekst të mëtejshëm, dhe më ndërprisni në qoftë se
19 keni pyetje më konkrete, por për kontekst të mëtejshëm, gjatë
20 ditës së parë apo ditës së dytë, dy ditëve të para kur isha në
21 kështjellën aty, më ftuan që t'i jepja një prezantim
22 delegacionit të Kosovë për katër pika, tema. Tema e katër
23 ishte juridiksioni dhe aktivitetet - pra, hetimet, aktakuzat -
24 e Tribunalit për ish-Jugosllavinë. Të gjithë anëtarët e
25 delegacionit ishin të pranishëm aty. Kjo përfshinte dhe

1 mësimet që kishim mësuar, kishim nxjerrë nga koha kur unë
2 punoja si këshilltar ligjor për boshnjakët në negociatat në
3 Dayton, sepse ishte çështje, sepse çështja e juridiksionit të
4 tribunalit ishte pasqyruar në marrëveshjen e Dayton dhe ishte
5 shumë intensive, pra, ne prisnim që kjo të ishte në
6 Marrëveshjen e Rambujesë dhe ata më kërkuan që t'u jap një
7 shpjegim të hollësishëm të asaj që pritej lidhur me këtë
8 çështje dhe tre çështjet e tjera, temat e tjera.

9 PY. Ju faleminderit. Ju thoni që ju kërkua, dikush ju kërkoi,
10 pra, juve ju kërkuan që të përgatisnit gjuhën, të shkruanit
11 atë. Kush ju kërkoi?

12 PË. Fehmi Agani.

13 PY. A e dini pse ishte objektiv i rëndësishëm për
14 delegacionin e Kosovës kjo gjë?

15 PË. Po.

16 PY. Pse ishte e rëndësishme?

17 PË. Juridiksioni dhe aftësia e Tribunalit për ish-
18 Jugosllavinë që të vepronte në mënyrë efektive ishte e
19 rëndësishme për disa arsye. Konteksti konkret, specifik
20 menjëherë përpara bisedimeve ishte Masakra e Reçakut. Masakra
21 e Reçakut dhe prokurorja, gjykatësja Louise Arbor, prokurore,
22 përpiqej të kishte qasje në Kosovë sepse s'kishte vizë. Dhe në
23 Kosovë dhe në Maqedoni përmes Serbisë, por asaj iu mohua viza.
24 Pra, me sa më kujtohet ka qenë Masakra e Reçakut, Ambasadori
25 William Walker që të përdorë frazën, fjalinë "krime kundër

1 njerëzimit", nga perspektiva e Misionit për Hetime në Kosovë
2 do të hetonte atje. Por i thanë nuk ke vizë. Nuk mund të bësh
3 hetime.

4 Tani arsyet e tjera që ndërlidhen me këtë mbi të cilat
5 mbështetet kjo për një mbështetje të plotë të Tribunalit për
6 ish-Jugosllavinë ishte që ruhej një barazi morale. Kjo është
7 diçka e zakonshme në praktikën diplomatike, është një ide e
8 qartë e shkallës në të cilën të gjithë palët janë të
9 përgjegjshme, të gjitha palët kanë gjak në duart e tyre dhe
10 kjo u jep diplomatëve më shumë hapësirë dhe mundësi për të
11 negociuar, për të bërë kompromise.

12 Kosovarët kishin parë dhe, do të theksoja këtu në veçanti
13 Veton Surroi dhe Bujar Bukoshi, kishin parë nga përvoja e
14 Bosnjës se shpesh herë pavarësisht faktit që kryerja e
15 mizorive, veprimeve e krimeve ishte e disproporcionuar, pra,
16 në anën e regjimit serb, po që shpesh herë boshnjakët dhe
17 kroatët edhe serbët ishin në mënyrë të njëjtë fajtorë, dhe
18 mund të jap informacione shtesë në qoftë se ju jeni të
19 interesuar lidhur me këtë për kohën kur isha në Departamentin
20 e Shtetit dhe sesi është reflektuar kjo, por nuk do ta bëjmë
21 këtë gjë tani. Dhe kosovarët po përjetonin të njëjtën
22 narrativë pra. Dhe e ishin të shqetësuar që Rambuje dhe
23 zbatimi i marrëveshjes së saj, pra, në qoftë se Rambuje do të
24 ishte e suksesshme do të kishte një lloj vetëqeverisjeje në
25 një farë niveli vetëqeverisjeje dhe dislokimi i trupave të

1 NATO-s dhe zgjedhjet nën vëzhgimin e OSBE-së, pra, që në qoftë
2 se nuk kishte një Gjykatë, një tribunal për ish-Jugosllavinë
3 me qasje të plotë të tërësishme dhe me kompetenca, pushtet të
4 plotë lidhur me atë që kishte ndodhur dhe që ishte duke
5 ndodhur, kjo do të dëmtonte, po të mos vendosej një tribunal i
6 tillë, kjo do të dëmtonte mbështetjen ndërkombëtare për
7 zbatimin e Marrëveshjes së Rambujesë.

8 Dhe pastaj arsyeja e fundit shkurtimisht, përfaqësimi i
9 viktimave. Pra, që në vitin 1989 kur kishte filluar vuajtja e
10 viktimave me anulimin, me anulimin, heqjen e statusit në 1984,
11 ishte krijuar një sistem që ishte pothuajse regjim apartheidi
12 në Kosovë dhe popullsia ishte e traumatizuar dhe viktimizuar
13 dhe kishte shumë pak qasje në të dhënat dhe shënimet
14 historike, pra, krijimin e të dhënave historike apo
15 katalogimin e atyre që kishin pësuar viktimat. Dhe që nevoja
16 për një tribunal dinamik që vepronte do t'i jepte mundësinë
17 dhe mjetet njohjes dhe bërjes së drejtësisë për viktimat, pra,
18 për popullsinë e Kosovës.

19 PY. Faleminderit. Pra, qëllimi për të siguruar angazhim
20 konkret për bashkëpunim me TPNJ-në, a e dini nëse Hashim Thaçi
21 bashkëndante këtë qëllim, këtë objektivi?

22 PË. Po. Ai e bashkëndante këtë objektiv.

23 PY. Si e dini këtë?

24 PË. Drafti, pra, nja dy arsye. Drafti fillestar, pra, letra
25 që u paraqit me katër pika që përmendën -- kishte disa

1 dokumente që silleshin aty që paraqiteshin. Po ishte një letër
2 në fillim, fillestare e cila paraqiste katër objektivat dhe
3 objektivi i katërt ishte tribunali që ishte dhe për këtë duhej
4 nënshkrimi i kryesuesit të delegacionit. Unë ua shpjegova
5 delegacionit të gjitha këto që përmbante, gjithashtu theksova
6 faktin - ishte e rëndësishme për mua që t'i shpjegoja atij atë
7 sepse si jurist, si jurist nëse përgatitet një dokument për
8 një klient *pro bono* dhe kërkohet nënshkrimi i tij - dhe kjo
9 ndodhi që ishte nënshkrimi, i kërkoj nënshkrimin e kryesuesit
10 të delegacionit në cilësinë e tij si kryesues - në këto raste
11 duhet të jetë -- personi duhet të sigurohet që personi që do
12 të nënshkruajë e kupton plotësisht këtë përpara se ta
13 nënshkruajë.

14 Pra, duhej jo vetëm që t'i shpjegoja gjithë delegacionit,
15 por edhe atij atë që do të thoshte ky dokument.

16 PY. Pastaj ju e sqaruat dhe shpjeguat këtë, si e shprehu ai
17 pranimin e këtij dokumenti?

18 PË. Ai ishte tërësisht, e pranoi në tërësi atë dhe tha, "Po,
19 kjo e pasqyron atë dhe na intereson edhe neve", të gjitha, të
20 katër pikat këtu.

21 PY. A e dini nëse Hashim Thaçi ishte i vetëdijshëm se
22 bashkëpunimi me TPNJ-në do të përfshinte bashkëpunimin me
23 TPNJ-në për çështje dhe hetime potenciale lidhur me UÇK-në?

24 PË. Po.

25 PY. Si e dini këtë?

1 PË. Ka patur arsye të ndryshme në të cilat e mbështes
2 përgjigjen time. E para ishte se delegacioni i Kosovës
3 përfshirë ata që përfaqësonin UÇK-në dhe përfshirë Hashim
4 Thaçin, kishin në anën e tyre mundësinë që të shihnin sesi
5 Tribunali për ish-Jugosllavinë vepronte në kontekstin e
6 Kroacisë dhe Bosnjës ku tribunali kishte ngritur aktakuzë për
7 pjesëtarë të këtyre palëve.

8 Dhe situata faktike ishte e tillë që Tribunali
9 Ndërkombëtar do të kërkonte prova në drejtime të veçanta që do
10 të përfshinte dhe aktorët e armatosur jo shtetëror, pra, jo
11 shtete, entitete të tjera.

12 Dhe, së dyti, draftet paraprake fillestare që diskutuam
13 me delegacionin e Kosovës, përfshirë UÇK-në, përfshinin në
14 mënyrë specifike fjalën "Kosova". Dhe ne e përdorëm me A, do
15 të them këtu, Kosova. Në gjuhën që ne kemi përgatitur dhe
16 diskutuar kanë qenë 18 pika, pastaj u bënë 19. Dy prej këtyre
17 pikave kishin të bënin me tribunalin dhe kjo ishte prokurori
18 do të ketë qasje të papenguar dhe pa vizë në Republikën
19 Federale të ish-Jugosllavisë, Kosovë, Serbi për qëllimet e
20 kryerjes së hetimeve e tjera e tjera. Dhe nuk kishte kuptim që
21 ata të mos përfshihen, pra, aktorët joshtetërorë si pjesë e
22 juridiksionit të tribunalit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do të kërkoja që
24 të shfaqim në ekran dokumentin SPOE40010656 deri në 40010667,
25 ju lutem.

1 PY. Dr. Williams, a e njihni këtë letër?

2 PË. Po.

3 PY. Jeni ju autori?

4 PË. Po.

5 PY. E keni patur mundësinë që ta lexoni, ta rishikoni

6 artikullin javën e kaluar?

7 PË. Po.

8 PY. Cili ishte qëllimi për të cilin keni shkruar këtë

9 artikull?

10 PË. Përgjigja e shkurtër është që të dokumentohen paqja

11 krahasuar me drejtësinë apo paqja me drejtësinë, pra,

12 bisedimet që kishin të bënin me paqen krahasuar me drejtësinë

13 apo kundër drejtësisë dhe paqja me drejtësinë, bisedime që

14 kishin ndodhur në Rambuje. Kjo është.

15 Përgjigja pak më e gjatë, nëse doni kontekst pak më të

16 gjerë, është që kjo ishte për të plotësuar një libër që Mike

17 Scharf dhe unë kishim përgatitur, shkruar, pra, që kishte të

18 bënte me paqen dhe drejtësinë që ishte në lidhje me negociatat

19 dhe Dayton, ishte guri themelor i punës time akademike, pra, e

20 gjithë biseda ishte lidhur me sesi të përfshihej faktori, pra,

21 drejtësia në procesin e ndërtimit dhe krijimit të paqes me

22 qëllim që të sigurohej një paqe e qëndrueshme. Dhe kjo ishte

23 një gurë mbi mur, në qoftë se mund të them kështu, një prej

24 hapave.

25 PY. Në këtë letër, ju përpigëni që të shënoni në mënyrë të

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 65

1 saktë bisedat dhe ngjarjet në Rambuje?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund
4 të na kaloni në faqen SPOE4001660.

5 PY. Dr. Williams, këtu gjejmë pjesën 3.2 të letrës tuaj, me
6 titull "Dispozitat për krimet e luftës të propozuara nga
7 delegacioni i Kosovës". A e njihni këtë pjesë të letrës tuaj,
8 të shkrimit tuaj?

9 PË. Po.

10 PY. Në këtë pyetje në këtë pjesë diskutohen propozimet e
11 delegacionit të shqiptarëve gjatë Konferencës së Rambujesë
12 lidhur me hetimet dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës.
13 Kush i ka përpiluar propozimet e delegacionit të Kosovë në
14 Konferencën e Rambujesë lidhur me hetimet dhe ndjekjen penale
15 të krimeve të luftës?

16 PË. E kam bërë unë bashkë me Marc Weller.

17 PY. Dhe për procesverbal, a mund të na shpjegoni kush ishte
18 Marc Weller?

19 PË. Marc Weller ishte një këshilltar ligjor ndërkombëtar i
20 cili ka punuar në të njëjtën cilësi si unë me delegacionin e
21 Kosovës. Është doktor së bashku në *Cambridge University* dhe
22 është edhe ai.

23 PY. E dini cila është shtetësia, kombësia e Dr. Weller?

24 PË. Dr. Weller është shtetas gjerman i cili jeton në
25 Mbretërinë e Bashkuar, ka bërë doktoraturën atje dhe tani jep

1 mësim në Universitetin e Cambridge.

2 PY. Faleminderit. Të shohim njërën prej propozimeve tani që
3 është diskutuar në këtë shkrim dhe kjo do të jetë në faqen --
4 në paragrafin këtu do ta lexoj tani. Propozimi ishte:

5 "Palët në këtë marrëveshje pajtohen që të transferojnë
6 përgjegjësitë e tyre tek Tribunali Penal Ndërkombëtar për
7 Jugosllavinë në pajtim me rezolutat përkatëse të Këshillit të
8 Sigurimit. Në përputhje me këto rezoluta palët pajtohen të
9 arrestojnë, të mbajnë të ndaluar dhe të transferojnë në
10 paraburgim në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-
11 Jugosllavinë, çdo dhe të gjithë personat që kërkojnë për t'u
12 arrestuar."

13 Pastaj vazhdoni më tej duke thënë që delegacioni i
14 Kosovës dha propozim të mëtejshëm dhe këtu është shkruani si
15 në vijim:

16 "I shqetësuar lidhur me moszbatimin e detyrimeve të
17 përgjithshme për bashkëpunim në Marrëveshjen e Dayton dhe
18 refuzimi i qeverisë serbe deri në këtë që të bashkëpunojë me
19 Tribunalin për Jugosllavinë, delegacioni i Kosovë më propozoi
20 më tej përfshirjen e gjuhës ku thuhet se palët më tej
21 angazhohen më tej të sigurojnë dhe të japin ndihmë gjyqësore
22 të kërkuar nga tribunali, domethënë, marrjen e dëshmive,
23 qasjen në krijimin e dëshmive dhe provave, qasje te personat,
24 ambientet, dokumentet dhe zonën apo territori si dhe dorëzimin
25 e dokumenteve."

1 A janë këto dispozita që i keni përpiluar ju?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe a ishin këto propozime -- a u dorëzuan këto propozime
4 Grupit të Kontaktit si propozime të delegacionit Shqiptar të
5 Kosovës.

6 PË. Po.

7 PY. Këto propozime bëjnë thirrje "palëve të marrëveshjes" që
8 janë palë në marrëveshje që të bashkëpunojnë në plotësi dhe
9 tërësi me TPNJ-në. Sipas njohurive tuaja, a ishte delegacioni
10 i Kosovës në dijeni që kjo do të përfshinte bashkëpunimin e
11 plotë në arrestimin dhe transferimin në TPNJ të pjesëtarëve të
12 UÇK-së dhe mbledhjen e provave kundër pjesëtarëve të UÇK-së?

13 PË. Po.

14 PY. Si e dini këtë?

15 PË. Sepse unë në cilësinë e juristit që punoja për ta, ua kam
16 shpjeguar atyre në mënyrë të qartë dhe shprehimisht gjuhën që
17 ata më kishin kërkuar të përpiloja dhe që të behej pjesë e
18 procesit të bisedimeve duke ua dhënë pastaj, duke e dorëzuar
19 këtë pastaj Grupit të Kontaktit. Gjithashtu, edhe për nevoja
20 të një kontrollimi të dyfishtë dhe verifikimi të dyfishtë
21 Fehmi Agani, i cili ishte juristi i tyre kushtetues kryesor,
22 kryejuristi, pra, për çështje kushtetuese, tha që unë do të
23 punoja së bashku me të për t'u siguruar që ndërkohë që ne po
24 transmetonim, po kalonim informacionet në mënyrë të
25 drejtpërdrejtë pjesëtarëve të delegacionit se ai së bashku dhe

1 unë do të kishim një kuptim ndërsjellët të dispozitave që po
2 përgatiteshin. Dhe ndonjëherë, për shembull, dispozita
3 tribunali ku thuhej, "Në rregull. Pol, ti shkruaje këtë". Dhe
4 pastaj paragrafi për statusin përfundimtar aty ishin tre apo
5 katër persona që merrnin pjesë në përpilimin e kësaj. Dhe sa u
6 takon dispozitave për të drejtat e njeriut ndonjëherë ai ishte
7 kryesori që i përgatiste ato dhe unë bëja editimin e tyre. Por
8 ka patur, është bërë një përputhje e asaj që mendonin e
9 mendimeve që kishin, qasje që kishin mes këshilltarit të
10 jashtëm dhe Fehmi Aganit si profesor i të drejtës kushtetuese
11 të brendshme. Gjithashtu, kishte, pra, përputhje dhe
12 bashkëpunim të përbashkët.

13 PY. Në rregull.

14 PËRKTHYESI: Përkthyesi kërkoi që të flitet më ngadalë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Këto draftpropozime a aprovoheshin brenda delegacionit të
17 Kosovës përpara se t'i dorëzoheshin Grupit të Kontaktit?

18 PË. Po.

19 PY. Kush i aprovonte ato?

20 PË. Kjo bëhej nga bashkëkryesuesit e delegacionit dhe pastaj
21 shënoheshin nga Edita Tahiri, e cila vepronte gjithashtu si
22 sekretariat i delegacionit.

23 PY. Kur ju flisni për tre bashkëkryesuesit e delegacionit a
24 mund t'i identifikoni me emër?

25 PË. Ky ishte Ibrahim Rugova, Presidenti, Rexhep Qureshi,

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 69

1 kërkoj ndjesë në qoftë se e shqiptova gabim mbiemrin dhe

2 Hashim Thaçi.

3 PY. A ju kujtohet nëse Hashim Thaçi e mbështeti propozimin

4 tuaj lidhur me bashkëpunimin me TPNJ-në?

5 PË. Po, më kujtohet. Dhe, po, e mbështeti.

6 PY. Kontakti i Grupit përfundimisht i pranoi këto propozime,

7 Grupi i Kontaktit?

8 PË. Vetëm për një pjesë të kufizuar apo një pjesë të kufizuar

9 të tyre.

10 PY. Ça do të thoni me këtë "në mënyrë të kufizuar"?

11 PË. Në paragrafin 12 përmendet pra, në paragrafin 12 dhe 13

12 përmendet hapja e pjesës së marrëveshjes -- në pjesën ku

13 flitet për Marrëveshjen e Rambujesë lidhur bëhet fjalë për

14 detyrimet e palëve ndaj Tribunalit për Jugosllavinë por kjo

15 përmendet në mënyrë shumë më të lehtë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, paraqes shkrimin

17 e plotë për t'u pranuar si provë SPOE40010656 deri në

18 04010667.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë

20 kundërshtim?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE40010656

23 deri në 40010667 pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky shkrim merr numrin e

25 provës materiale 1D378.

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 70

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili ishte
2 numri?

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 1D378.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Dr. Williams, tani dua të flasim për një libër që ka
7 botuar Dr. Weller. Pra, i shkruar nga Dr. Weller.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe znj. Sekretare, në qoftë se
9 mund të shfaqim në ekran IT-05-87 1D00018, ju lutem. Ky është
10 libër i shkruar nga Dr. Weller me titullin "Kriza në Kosovë
11 1989-1999".

12 Tani do të kërkoj, ja të kalojmë në faqen 246 në
13 versionin PDF. Po. Në qoftë se mund të zmadhojmë pikën 19.

14 PY. Dr. Williams, kjo është ribotim i letrës, i shkrimit nga
15 kryetari i TPNJ-së drejtuar ministrave të punëve të jashtme
16 Vedrine dhe Cook më 22 shkurt 1999, ku Presidenti Gabrielle
17 Kirk McDonald shkruan:

18 "Në ditët e fundit kemi marrë raporte shqetësuese lidhur
19 me ecurinë, përparimin e bisedimeve të paqes për Kosovën në
20 Rambuje, në Francë. Jam këshilluar se teksti që aktualisht po
21 shqyrtohet nga palët nuk përmban dispozita që do t'u kërkojnë
22 dhe detyronin ata që të njihnin kompetencën dhe të pranojnë
23 kompetencën e Tribunalit Ndërkombëtar apo që të marrin masa
24 konkrete për të bashkëpunuar me tribunalin. Në vend të kësaj
25 kuptoj që sipas draftit aktual të marrëveshjes palët do të

1 nënshkruanin bazuar në këtë draft një dispozitë që është vetëm
2 e përgjithshme për bashkëpunimin.”

3 Dhe në qoftë se kalojmë në paragrafin e fundit aty
4 shkruhet:

5 “Është e qartë dhe buron nga kjo qartësisht se nuk do të
6 ketë paqe pa drejtësi. Për rrjedhojë, çdo marrëveshje që
7 dështon të shprehë në mënyrë të qartë se qeveria e Republikës
8 Federale të Jugosllavisë dhe shqiptarët e Kosovës ku nuk
9 përmenden forma specifike konkrete të bashkëpunimit të tyre
10 rrezikon që të sakrifikojë, pra, parimet mbi të cilat
11 tribunali është krijuar t’i sakrifikojë këto për interesa
12 politike afatshkurtra.”

13 Pyetja ime e parë, Dr. Williams, është a keni patur
14 ndonjë rol në përgatitjen e këtij shkrimi për të dërguar TPNJ-
15 së?

16 PË. Po.

17 PY. Cili është roli juaj dhe i tyre?

18 PË. Unë kam patur dy role. Së pari me pëlqimin që më është
19 dhënë nga delegacioni, kam qenë njëri prej atyre që ka thirrur
20 Gjykatësin McDonald për të ndarë analizën dhe informacionin me
21 të. Ne kishim një marrëdhënie paraprake që e bëri këtë gjë të
22 mundur. Dhe, së dyti, kam dhënë gjuhën e draftit në mënyrë që
23 letra e saj të ishte sa më konkrete dhe specifike dhe të
24 kishte ndikim sa më të madh që ishte e mundur.

25 Dhe mund të jap edhe kontekstin për këtë sepse duket

1 ndoshta pak e jashtëzakonshme, që ka të bëjë me Gjykatësin
2 Goldstone dhe Marrëveshjet e Dayton, por do të ndalem këtu.
3 PY. Në qoftë se kemi nevojë do t'i kthehemi kësaj.
4 PË. Në rregull.
5 PY. Paragrafi i fundit që ju lexova, si e kuptoni ju
6 qëndrimin që duhej të konsiderohej nevoja për një marrëveshje
7 përfundimtare në Rambuje që do të detyronte gjithashtu
8 shqiptarët e Kosovës të bashkëpunonin me TPNJ-në hetime dhe në
9 ndjekjen penale të shkeljeve të rënda të Ligjit Humanitar
10 Ndërkombëtar?

11 PË. TPNJ-ja -- po përpigem të eci ngadalë për nevoja të
12 përkthyesve. TPNJ-ja kishte juridiksion të qartë dhe të
13 padyshimtë sa u takon veprimeve në Kosovë, përfshirë veprimet
14 e kryera nga shqiptarët e Kosovës dhe për gjykatësin dhe
15 shqiptarët e Kosovës, ishte e rëndësishme që kjo që ishte
16 shprehimisht e qartë që për ata të theksojnë shprehimisht në
17 këto komunikime, pra, që nuk do të kishte asnjë mëdyshje asnjë
18 paqartësi nga zyra e gjykatësit apo në marrëveshje sa i takon
19 shtrirjes së plotë të juridiksionit të Tribunalit për
20 Jugosllavinë

21 PY. Në rregull.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në pikën 20 në
23 ekran.

24 PY. Kjo është një letër nga kryetari i TPNJ-së drejtuar
25 kryetarit të Këshillit të Sigurimit më 16 mars 1999, pra, pak

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 73

1 më përpara nënshkrimit nga delegacioni i Kosovës i
2 Marrëveshjes së Rambujesë. A mund të na thoni çfarë është kjo?
3 PË. Kjo është një letër nga kryetari i gjykatës, i tribunalit
4 drejtuar presidentit, kryetarit të Këshillit të Sigurimit duke
5 informuar Këshillin e Sigurimit se Republika Federale e
6 Jugosllavisë nuk kishte përmbushur detyrimet e saj për të
7 lejuar Prokurorin dhe hetuesit e tij që të hynin në Kosovë,
8 konkretisht që të hetonin Masakrën e Reçakut.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, paraqes këtë faqe
10 të librit të Weller që është faqja 1D000468. Dhe vërej që janë
11 pranuar tashmë pjesë të tjera të librit të Dr. Weller, në
12 provën materiale P04259 dhe propozoj që kjo faqe t'i shtohet
13 kësaj prove materiale.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
15 kundërshtim për shtimin e kësaj faqeje?

16 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim. Mendoj që ka dhe
17 pjesë të këtij libri në provën 3D00024. Mund të jem gabim. Por
18 nuk kemi kundërshtime gjithsesi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja ID
20 000468 pranohet dhe i shtohet asaj ekzistuese 1D0018. A është
21 kjo?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, është P04259.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Do t'i shtohet kësaj pra, provës materiale që është tanimë e
25 pranuar.

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 74

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
3 publike?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që P04259 është publike.
5 Dhe në qoftë se kështu mund të jetë publike dhe kjo tjetra.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
7 Riklasifikohet si publike. Është libër.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju kërkoj të
9 paraqisni në ekran provën P04046.

10 PY. Dr. Williams, a e njihni këtë dokument, e keni parë më
11 përpara?

12 PË. Po.

13 PY. Çfarë është ky?

14 PË. Është marrëveshja e përkohshme në versionin draft për
15 paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë. Më pas do t'i referohem
16 këtij dokumenti si Marrëveshja e Rambujesë.

17 PY. A është ky dokumenti që në fund fare Hashim Thaçi ka
18 nënshkruar në emër të delegacionit shqiptar të Kosovës?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem paraqisni në ekran
21 dokumentin K0364642. Të kalojmë në fund të faqes në të majtë,
22 kolonën në të majtë.

23 PY. Marrëveshja, në paragrafin 10, u bënë thirrje palëve që
24 të lirojnë "të gjithë personat e ndaluar ose personat e tjerë
25 të cilët ishin të ndaluar pa akuza". A e shikoni këtë pjesë?

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 75

1 PË. Po.

2 PY. Në paragrafin 11, palëve ju bëhet thirrje që "të japin
3 informacione përmes mekanizmave të gjurmimit të Kryqit të Kuq
4 Ndërkombëtar për familjet e të gjithë personave të cilët nuk
5 diheshin se ku ishin". A e shihni këtë?

6 PË. Po.

7 PY. A ishin të pranueshme këto dispozita ose këto pika për
8 delegacionin shqiptar të Kosovës?

9 PË. Po.

10 PY. Le të kalojmë tek paragrafi i radhës, pra, paragrafi 10
11 por tek faqja tjetër, në të thuhet, paragrafi 12 që:

12 "Secila prej palëve nuk duhet të ndjekë penalisht askënd
13 për krime të cilat lidhen me konfliktin në Kosovë në
14 përjashtim të personave që kanë të akuzuar për shkelje të
15 rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Në mënyrë të
16 tillë që të lehtësohet dhe të mundësohet transparenca, palët i
17 japin qasje ekspertëve të huaj që të punojnë së bashku me
18 hetuesit shtetërorë."

19 Si e keni kuptuar ju, Dëshmitar, kush janë ekspertët e
20 huaj dhe cilët janë hetuesit shtetëror?

21 PË. Tribunali i Jugosllavisë.

22 PY. Ju tregova një letër të datës 16 marsit të Presidentit të
23 TPNJ-së që i thotë Këshillit të Sigurimit që Jugosllavia nuk
24 bashkëpunon. Çfarë kuptimi keni ju, si e keni kuptuar ju, cili
25 ka qenë pozicioni i TPNJ-së sa i takon hetimeve potenciale dhe

1 ndjekjeve penale potenciale të shkeljeve të rënda të së
2 drejtës ndërkombëtare humanitare që ishin kryer nga palët, si
3 e keni kuptuar ju që TPNJ-ja çfarë mendonte lidhur me këto
4 krime qoftë për Serbinë apo UÇK-në?

5 PË. Nuk ka pasur pritshmëri nga Tribunali Jugosllav, nga
6 TPNJ-ja, se palët që ndoshta Jugosllavia ose Republika
7 Federale e Jugosllavisë ose UÇK-ja, pra, Republika e Serbisë
8 ose UÇK-ja do të realizonin hetime. Dhe ideja ishte që
9 tribunali do ishte kundër përpjekjeve sepse mund cenoheshin
10 palë ose mund të bëheshin thjesht gjykime sa për sy e faqe.
11 Dhe ideja ishte që ekzistonte rreziku që në qoftë se do
12 bëheshin hetime në nivele kombëtare do bëhej një cenim i
13 aftësisë së tribunalit për të përmbushur mandatin e vet.

14 PY. Ku mbështetëj një qasje e tillë?

15 PË. Angazhimi i zakonshëm me Tribunalin e ish-Jugosllavisë sa
16 i takon perceptimit të tyre lidhur me të drejtat dhe
17 parakushtet ose masat paraprake në fushën e drejtësisë
18 ndërkombëtare që ishte absolutisht e ndryshme në vitet 1990
19 sesa është situata sot në nivelin botëror. Po ashtu ekzistonte
20 asokohe një shqetësim i madh se kishte mbështetje të moderuar
21 deri në të dobët për Tribunalin Ndërkombëtar dhe se kishte
22 përpjekje tinëzare të vazhdueshme nga disa prej subjekteve të
23 cilat ishin të përfshira në kryerjen e këtyre krimeve për të
24 gjetur një mundësi për t'i bërë bisht situatës, për shembull,
25 mund të thuhet që "Prokuror, na vjen keq, po ju nuk keni vizë"

1 ose "Mund të prezantojmë një amnisti të ngjashme me amnistinë
2 në Afrikën e Jugut ose mund të organizohet një komision i
3 ngjashëm me Afrikën e jugut" e kështu me radhë.

4 Në qoftë se dëshironi mund t'ju jap edhe informacione të
5 tjera kontekstuale për t'ju shpjeguar se pse paragrafi 12 dhe
6 paragrafi 13 duken sikur mbivendosen me njëri-tjetrin.

7 PY. Do ju kërkoja që të bëni një pauzë për një moment. Pyetja
8 ime e radhës lidhet me paragrafin 13 dhe ajo çfarë më pyetët
9 pak më përpara ka lidhje me pyetjen që do ju bëj.

10 Megjithatë, në paragrafin 13 palëve "u kërkohet që të
11 respektojnë detyrimin për të hetuar shkelje të rënda të së
12 drejtës ndërkombëtare humanitare". Po ashtu jepen konkretisht
13 se cilat janë detyrimet dhe detyrimet burojnë nga Rezoluta e
14 Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 827 e 1993.

15 Ndërkohë që në paragrafin (b) të paragrafit 13 në këtë
16 këtu parashikohet që të mund të jepet qasje e plotë e
17 papenguar e ekspertëve ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe
18 ekspertët forenzikë dhe hetuesve për të hetuar pretendime për
19 shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

20 Pra, kur flitet këtu për hetuesit, ekspertët
21 ndërkombëtarë ose ekspertët forenzikë, si i kuptoni ju këto,
22 kush janë këta persona?

23 PË. Unë këta persona i kuptoj që janë hetuesit ose ekspertët
24 e TPNJ-së, Tribunalit Penal Ndërkombëtar kundër ish-
25 Jugosllavisë.

1 PY. A ju kujtohet ndonjë dispozitë ose ndonjë pikë e
2 Marrëveshjes së Rambujesë e cila u bën thirrje palëve që të
3 kryejnë hetimet e tyre për sa i takon ndëshkimeve për shkelje
4 të rënda të drejtës ndërkombëtare humanitare?

5 PË. Jo, nuk më kujtohet asnjë dispozitë në Marrëveshjen e
6 Rambujesë dhe nuk mund të gjendet asnjë dispozitë e tillë në
7 atë dokument.

8 PY. A ju kujtohet ndonjë diskutim ose sugjerim në Rambuje
9 qoftë prej përfaqësuesve ndërkombëtarë ose brenda delegacionit
10 shqiptar të Kosovës që UÇK-ja duhej që të bënte hetimet e veta
11 dhe të jepte ndëshkimet e veta për shkelje të rënda të së
12 drejtës ndërkombëtare humanitare të kryer nga forcat e UÇK-së?

13 PË. Mua më kujtohet që nuk kam bërë asnjë bisedë të tillë me
14 asnjë prej anëtarëve të delegacionit amerikan me të cilët unë
15 kisha marrëdhënie të ngushta. Apo nuk kam pasur asnjë bisedë
16 të tillë me anëtarë të Grupit të kontaktit një pjesë të të
17 cilëve po ashtu e njihja shumë mirë. Në asnjë moment në kohë,
18 asnjë prej tyre nuk e ka ngritur këtë temë diskutimi me mua.
19 Edhe pse ka ngritur tema të tjera dhe më kanë dhënë mesazhe të
20 tjera që ata donin që unë t'i transmetoja.

21 PY. Po ndonjë anëtar i delegacionit shqiptar të Kosovës ju ka
22 thënë ndonjë gjë të ngjashme?

23 PË. Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës ishte i përqendruar
24 kryesisht tek juridiksioni dhe tek qasja si dhe fuqizimi i
25 tribunalit kundër Jugosllavisë, pra, me fjalë të tjera, në

1 goftë se mund të shprehem ndryshe, ata ishin të përqendruar
2 vetëm tek ky instrument si mekanizëm i drejtësisë, pra, ata
3 dëshironin që të kishin vetëm thjesht tribunalin kundër
4 Jugosllavisë dhe kjo ishte një pikë e rëndësishme dhe që
5 kishte të bënte me miratimin e Marrëveshjes së Rambujesë, këtë
6 temë e diskutova dhe pak më herët dhe dua ta nënvijëzojë dhe
7 një herë tjetër tani.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
9 paraqesë në ekran provën 1D00078.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Në goftë se është e mundur dua të
11 jap ca shpjegime sepse mbivendoset pika 12 dhe 13.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Patjetër.

14 PË. Arsyeja që pse duket që paragrafi 12 dhe 13 mbivendosen
15 me njëri-tjetrin dhe duket sikur japin detyrime të ndryshme,
16 pra, kemi seksionin që përfundon te paragrafi 13. Por
17 paragrafi 12 ishte minimumi i mundshëm. Dhe ka pasur goxha
18 biseda, diskutime brenda Grupit të Kontaktit lidhur me
19 përmendjen e Tribunalit Jugosllav me kundërshtimin e Rosisë që
20 vinte në mbrojtje të Serbisë kryesisht.

21 Paragrafi 12 ishte minimumi, sikur e thashë edhe më
22 sipër, që amerikanët dhe të tjerët mund të shkonin tek
23 Albright ose tek senatori Mitch McConnell ose te person të
24 tjerë dhe t'i thonin që kemi paragrafin 12. Këtu nuk thuhet,
25 nuk përmendet tribunali, por këtu flitej për llogaridhënie dhe

1 për drejtësi. Domethënë, nuk është e thënë në mënyrë të
2 shkoqur ose të qartë, por thuhet ose nënkuptohet tribunali.

3 Ndërkohë që sa i takon paragrafit 13, paragrafi 13 lidhet
4 më tepër me juridiksionin e tribunalit. Është më pak sesa
5 kishte propozuar delegacioni i Kosovës, por ishte një temë e
6 cila më tepër ka ardhur nga grupi i kontaktit. Kur u shtua
7 paragrafi 13 për tribunalin, pra, kur u shtua shprehimisht nuk
8 u pa e nevojshme që të fshiheshin dy ose të hiqeshin dy
9 fjalitë nga paragrafi 12. Dy fjalitë, për shembull, tek pika e
10 12 thonë, që nuk do të ketë ndjekje penale për krime politike
11 dhe pastaj thuhet që duhet të respektohen detyrimet që kanë të
12 bëjnë me ndërkombëtarët. Ndërkohë që në pjesën e dytë të
13 paragrafit 12 thotë që nuk duhet të ketë amnisti për ata që
14 janë të përfshirë në krime ose duhet të ketë amnisti për
15 persona të cilët janë dënuar për krime politike. Domethënë, me
16 fjalë të tjera, ishte shumë e rëndësishme që të theksohej
17 llogaridhënia ndërkombëtare në Marrëveshjen e Rambujesë,
18 domethënë, në qoftë se do ishim para një situate ku nuk do
19 ekzistonte paragrafi 13, për hartuesit ishte shumë e
20 rëndësishme që e njëjta ide por me më pak qartësi të jepej në
21 paragrafin 12. Kjo është arsyeja që pse ka mbivendosje
22 ndërmjet dy paragrafëve.

23 PY. Dr. Williams, nga dokumenti juaj që sapo e pamë nga
24 artikulli i vitit 2000, në faqen përkatëse SPOE40010666,
25 diskutoni Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 dhe çështjen

1 e ndjekjes penale të shkeljeve të rënda të së drejtës
2 ndërkombëtare humanitare dhe sesi është trajtuar kjo në
3 Rezolutën 1244. A ju kujtohen sa referenca ose sa shpesh janë
4 përmendur, është përmendur drejtësia ndërkombëtare në
5 Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244?

6 PË. Besoj vetëm një herë. Të paktën nga kjo që kam përpara.

7 PY. Shikoni pak në fund të faqes, paragrafi i parafundit
8 thuhet:

9 "Duke mbajtur juridiksionin dhe mandatin e tribunalit
10 ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë."

11 Dhe në qoftë se do shohim më pas paragrafin e 13 të
12 rezolutës, këtu thuhet që Këshilli i Sigurimit:

13 "Kërkon bashkëpunim nga të gjithë palët, përfshirë këtu
14 nga prezenca ndërkombëtare e sigurisë dhe duke përfshirë edhe
15 Tribunalin Ndërkombëtar Penal kundër Jugosllavisë."

16 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A ju kujtohet ndonjë sugjerim nga komuniteti ndërkombëtar
19 ose përmes Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
20 Bashkuara apo nga ndonjë instrument tjetër që UÇK-ja ose
21 Qeveria e Përkohshme e Kosovë duhet të hetojë ose të
22 ndëshkojnë shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare
23 humanitare?

24 PË. Nuk më kujtohet asnjë bisedë e tillë ose përpjekje nga
25 personat e përfshirë në komunitetin e drejtësisë ndërkombëtare

1 duke përfshirë këtu edhe tribunalin, pra, nuk më kujtohet
2 asnjë formulim i tillë.

3 PY. Po për tej komunitetit ndërkombëtar të drejtësisë, për
4 shembull, në komunitetin ndërkombëtar diplomatik, a ju
5 kujtohet diçka e tillë ndonjë bisedë e kësaj natyre?

6 PË. Jo.

7 PY. Si e keni kuptuar ju asokohe, kujt iu ngarkua detyra për
8 të hetuar ose ndjekur penalisht shkeljet e rënda të së drejtës
9 ndërkombëtare humanitare të kryer nga UÇK-ja?

10 PË. Tribunali Ndërkombëtar për Jugosllavinë, ai e kishte
11 detyrën.

12 PY. A ju kujtohet ose a dini të ketë patur ndonjë organ
13 tjetër me juridiksion dytësor ose të mbivendosur sa i takon
14 ndjekjes së këtyre krimeve?

15 PË. Jo.

16 PY. Ju ishit këshilltar për të drejtën ndërkombëtare për
17 delegacionin sikurse edhe Dr. Weller. A e keni këshilluar z.
18 Thaçi, dhe a i keni thënë që UÇK-ja ka detyrë që të hetojë dhe
19 të ndëshkojë anëtarët e vetë për rastet e shkeljeve të rënda
20 të së drejtës ndërkombëtare humanitare?

21 PË. Jo.

22 PY. A jeni në dijeni në qoftë se Dr. Weller ose ndonjë
23 këshilltar tjetër e ka këshilluar z. Thaçi që UÇK-ja kishte
24 për detyrë që të hetonte anëtarët e vet dhe t'i ndiqte ata
25 penalisht për sa i takon shkeljeve të rënda të së drejtës

1 ndërkombëtare humanitare?

2 PË. Jo.

3 PY. Nuk e dini apo nuk ka ndodhur kështu?

4 PË. Jo, nuk ka ndodhur kështu.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do shohim provën 1D69 në të
6 dyja versionet në anglisht dhe në shqip.

7 PY. Përpara sesa të shohim këtë dokument, a mund të na thoni
8 se pse nuk e keni këshilluar ju z. Thaçi për këto detyrime?

9 PË. Asokohe, gjatë negociatave të Rambujesë, ndërkohë që, siç
10 e dini, negociatat e Rambujesë u ndodhën pas Masakrës së
11 Reçakut, po gjithashtu edhe të gjitha masakrave të kryera nga
12 MUP-i jugosllav i qeverisë serbe në Kosovë, personat që
13 merreshin me drejtësinë ndërkombëtare dhe me këtë çështje
14 ishin të përqendruar që të shmangnin që të ndodhte në Kosovë
15 ajo çfarë kishte ndodhur në Bosnjë dhe ajo çfarë ishte
16 përpjekur Serbia të bënte në Kroaci. Nuk kishte një narrativë
17 të vazhdueshme të mbështetur të krimeve të kryera nga
18 shqiptarët e Kosovës, nga UÇK-ja apo nga aktorë të tjerë jo
19 shtetërorë të armatosur në Kosovë. Pra, nuk ekzistonte nevoja
20 ose nuk është se ndihej nevojshme që të thuhej që këto janë
21 dy, tre, katër pika që duhet që të bëni. Kishte lidhur me
22 çështje të tjera, por nuk kishte shqetësime të cilat kishin të
23 bënin me shkeljet të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

24 Dhe sikurse e thashë dhe më herët edhe pse amerikanët dhe
25 disa prej anëtarëve të grupit të kontaktit vinin të

1 kontaktonin me mua në Rambuje, e flisnin me mua dhe më thonin,
2 për shembull, "A mund t'ia transmetosh këtë gjë delegacionit
3 ose mund t'i thoni delegacionit X, Y?". Kjo si pikë si temë
4 nuk është transmetuar asnjëherë, nuk na është thënë asnjëherë
5 që të flisni lidhur me këtë.

6 Dhe ndërkohë ne kemi vijuar me procesin, ndërkohë që sa i
7 takon negociatave të tjera, tre negociatave të tjera me të
8 cilat unë kam punuar për paqen, shpesh herë ne jemi ulur me
9 aktorë të armatosur jo shtetërorë dhe kemi folur lidhur me
10 detyrimin ndërkombëtar që kanë këta aktorë jo shtetërorë të
11 armatosur.

12 PY. Por nuk ka qenë rasti ky me UÇK-në?

13 PË. Jo, në këtë rast nuk e kemi bërë këtë gjë.

14 PY. Dr. Williams, në ekran është përkthimi në anglisht i një
15 dokumenti që mban datën 23 shkurt 1999. A e dini se çfarë
16 është ky dokument, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Na thoni ju lutem çfarë është ky dokument?

19 PË. Kjo marrëveshja për krijimin e një qeverie të përkohshme
20 të Kosovës.

21 PY. A e dini sesi është arritur kjo marrëveshje, si është
22 nënshkruar kjo marrëveshje?

23 PË. Po.

24 PY. A mund të na e tregoni si?

25 PË. Për të qenë i saktë, mbështetur në atë çfarë di, do më

1 duhej, domethënë, unë ka shpenzuar pjesën më të madhe të kohës
2 me delegacionin edhe gjatë natës jo vetëm gjatë ditës. Por kur
3 kam pasur biseda për qeverinë e përkohshme, nuk kam qenë i
4 pranishëm në sallë. Kështu që dua të jem i sigurtë, pra, kam
5 qenë aty 80 për qind i pranishëm, 80 për qind e bisedave,
6 megjithatë nuk dua të krijoj përshtypjen që kam qenë i
7 pranishëm 100 për qind të kohës. Kur ka pasur tema të
8 brendshme kosovarët për të diskutuar, unë nuk kam marrë pjesë
9 në ato takime.

10 Megjithatë, pavarësisht kësaj, ka pasur shumë biseda
11 lidhur me idetë e mia ose jemi informuar ose na kanë thënë
12 gjithashtu se çfarë ka ndodhur brenda këtyre takimeve ku unë
13 nuk kam qenë i pranishëm vetë personalisht as unë dhe as të
14 tjerët si puna ime.

15 Domethënë, nuk besoj që iu përgjigja pyetjes që bëtë, po
16 thjesht dhashë një informacion në sfond të asaj çfarë ka
17 ndodhur. Nuk besoj se iu përgjigja.

18 PY. Do ta përsërisë pyetjen dhe një herë?

19 PË. Ju thatë çka po bënin ata, apo jo?

20 PY. Po.

21 PË. Ajo çfarë kuptoi delegacioni në Rambuje, dhe ky ishte një
22 prej rasteve ku Grupi i Kontaktit të amerikanëve thanë që "Do
23 ishte mirë të këshillohej delegacioni që të vazhdonte të
24 ndërtonte kohezion dhe që të angazhoheshin për zbatimin e
25 Marrëveshjes së Rambujesë", sepse përpara sesa të vinin në

1 Rambuje situata ishte si situatë e ndërlikuar, është kështu si
2 në formë kaleidoskopi, domethënë, një pazëll. Domethënë,
3 ngjyrat ndryshonin. Domethënë, kishte ndryshim të situatës.

4 Ndërkohë që sa i takon Rambujesë, kishte kohezion,
5 domethënë, kishte një lloj njëtrajtshmërie ndërmjet
6 delegacionit. U desh ca kohë që të ndërtohej kjo
7 njëtrajtshmëri. U desh që të kishte një lloj stili ose një
8 lloj mënyre të unifikuar. Dhe ne filluam, ishte UÇK-ja po nga
9 ana tjetër nuk ishte vetëm UÇK-ja, po ishte LDK-ja, po ishte
10 dhe LBD-ja që ishte ndarë ose ishte shkëputur nga LDK-ja,
11 kishim gjithashtu edhe Veton Surroin që ishte, le ta themi
12 kështu, inteligjenca që luante një rol shumë të madh, kështu
13 që me fjalë të tjera kishte shumë aktorë, ekzistonte dëshira
14 që këto pjesë të ndryshme të të njëjtit pazëll të mund të
15 silleshin, të mund të bashkoheshin me njëra-tjetrën, pra,
16 kishte dëshirë gjithmonë e më të madhe, pra, që të kishte një
17 lloj njëtrajtshmërie dhe për ne ishte e rëndësishme që ky lloj
18 kohezioni të vazhdonte dhe pas Rambujesë dhe që delegacioni të
19 ishte një zbatues efektiv i OSBE-së, që quhej gjithashtu edhe
20 mekanizmi zbatues i Rambujesë, domethënë, të paktën kështu
21 shikohej nga NATO.

22 PY. Në datën e dokumentit çfarë perceptimi keni ju, çfarë
23 mendimi keni ju, domethënë, në datën që është botuar ky
24 dokument, mendoni që ka pas njëtrajtshmëri ose kohezion, ka
25 qenë në një linjë anëtarët e delegacionit?

1 PË. Po, ka pasur kohezion.

2 PY. E keni përmendur shumë herë z. Surroi. A mund të na thoni
3 se sa mirë e njihnit z. Surroi në shkurt të 1999-s?

4 PË. E njihja vetëm Surroin goxha mirë në shkurt të 1999. Dhe
5 që prej asaj kohe e në vazhdim unë kam pasur një marrëdhënie
6 shumë të fortë profesionale dhe personale me të, sa për t'jua
7 bërë të qartë raportin tim me të.

8 PY. Në shkurt të 1999-s, a ju ka thënë ndonjëherë z. Surroi
9 që është ndjerë i kërcënuar nga Hashim Thaçi?

10 PË. Asnjëherë. Veton Surroi nuk më ka thënë asnjëherë ose nuk
11 më ka lënë të kuptoj në asnjë mënyrë ose nuk më ka shfaqur
12 asnjë sjellje që do më bënte mua të besoja që ai ishte i
13 kërcënuar nga Hashim Thaçi apo nga askush tjetër nga
14 delegacioni shqiptar i Kosovës.

15 PY. Duke marrë parasysh lidhjen tuaj të ngushtë personale dhe
16 profesionale me të, por më pas a të ka thënë ndonjëherë ty që
17 është ndjerë i kërcënuar nga Hashim Thaçi në Rambuje?

18 PË. Ai nuk më ka thënë asnjëherë, s'e ka përmendur asnjëherë
19 që është ndjerë i kërcënuar nga Hashim Thaçi në Rambuje.

20 PY. Faleminderit. Tani të shohim një tjetër dokument së
21 bashku.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokumenti i pranuar në provë
23 1D00356.

24 PY. Dr. Williams, është një dokument i cili mban datën 13
25 shkurt 1999. Pra, mendohet të jetë shkruar nga David Wilson. A

1 ju kujtohet një David Wilson në bisedat e Rambujesë?

2 PË. Më kujtohet një person në bisedat, negociatat e Rambujesë
3 që ishte i pranishëm në emër të KVM dhe Ambasadorit Walker,
4 megjithatë nuk më kujtohet konkretisht në qoftë se quhej apo
5 jo Devid Wilson.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e dytë që
7 është SPOE0011787, drejt fundit të faqes. Paragrafi që fillon
8 me "Negociatat shqiptare".

9 PY. Do ju lexoj një pjesë të paragrafit pastaj do ju bëj një
10 pyetje.

11 "Shqiptarët u informuan lidhur me shtojcat ushtarake dhe
12 policore. Ata kishin shumë pak pyetje asokohe, por pritej që
13 të vinin me pika më të hollësishme më vonë. Kjo është çështja
14 më e madhe e menjëhershme për shqiptarët, pjesërisht për shkak
15 se u kërkon atyre që të shpërbëhen dhe pjesërisht për faktin
16 që e bëjnë ata më të cenueshëm ndaj serbëve. Kam folur me dy
17 këshilltarë me një amerikan dhe një gjerman gjatë e gjerë pas
18 një informimi ushtarak. Ata më theksuan vështirësitë që do të
19 kishin komandantë të lartë të UÇK-së për çarmatosjen jo vetëm
20 për shkak të vulnerabilitetit të perceptuar por edhe për shkak
21 të qëndrimit të tyre personal lidhur me pozicionin e tyre në
22 UÇK."

23 Atëherë dokumenti mban datën 13 shkurt 1999. A mund të na
24 thoni nëse e dini se kush mund të ishin këshilltari amerikan
25 dhe këshilltari gjerman sipas këtij dokumenti?

1 PË. Po.

2 PY. Kush ishin këta persona?

3 PË. Unë jam këshilltari amerikan dhe z. Weller është
4 këshilltari gjerman.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë tek faqja tjetër.

6 PY. Tek fjalja ku thuhet që:

7 "Ata thanë, siç pritej, që Thaçi kontrollohej nga jashtë.
8 Gjithashtu, që shqiptarët e diasporës kishin ndikim shumë të
9 fortë dhe ishin shumë më këmbëngulës sesa ata që ishin brenda
10 vendit - përsëri, as kjo nuk ishte befasi."

11 Autori i këtij dokumenti thotë që këshilltarët që, sipas
12 jush jeni ju dhe z. Marc Weller, keni thënë që "sikurse
13 pritej, Thaçi kontrollohej fort nga jashtë". A është kujtohet
14 diçka që do të mund t'i keni thënë ju autorit të këtij
15 artikulli?

16 PË. Po.

17 PY. A është kjo në përputhje me atë çfarë keni vënë re ju
18 gjatë bisedave në Rambuje?

19 PË. Po.

20 PY. Cila është baza në të cilën ju keni arritur në
21 përfundimin që z. Thaçi ishte i kontrolluar fort nga jashtë,
22 mbi ç'bazë e thoni këtë gjë?

23 PË. Baza për këtë përfundim janë disa faktorë. Biseda të
24 shumta përmes thirrjeve telefonike që realizonte Hashim Thaçi
25 me persona të ndryshëm nga jashtë, domethënë, nga jashtë

1 kështjellës. Pra, telefoni binte në mënyrë të vazhdueshme,
2 telefoni i tij binte në mënyrë të vazhdueshme që shpesh
3 nënkuptonte që atij i duhej ose të dilte jashtë ose të shkonte
4 në një cep të dhomës. Delegacioni i Kosovës ishte në katin
5 përdhes kështu që mund të dilnin lehtësisht në oborrin e
6 kështjellës. Përfshirja ime në fshatin e Rambujesë, domethënë,
7 jashtë kështjellës ku kanë ndodhur negociatat, ku unë
8 takohesha rregullisht me një shqiptaro-amerikan që kishte një
9 marrëdhënie të ngushtë me UÇK-në dhe individë apo persona të
10 tjerë të cilët më janë identifikuar si pjesëtarë të UÇK-së, ku
11 ne diskutonim dispozita të ndryshme nga këndvështrimi i
12 juristit, domethënë, nga këndvështrimi im për sa i takon
13 tekstit të marrëveshjes.

14 Domethënë, nga njëra anë kishim telefonatat që bënte z.
15 Thaçi, këshilltarët e jashtëm, ose le të themi palët e treta,
16 e kam fjalën këtu, për shembull, një persona shqiptaro-
17 amerikan apo pjesëtarë të tjetër të UÇK-së që kishin ide shumë
18 të qarta dhe kishte -- ti mund ta lexoje pak edhe nga
19 gjestikulacioni ose nga paraqitja. Pra, ndonjëherë ke një
20 koklavitje ose një përzierje të aktorëve dhe ka shumë aktorë
21 ose shumë palë të tjera të cilët mua më kanë bërë që të shkoj
22 në këtë përfundim.

23 Pra, krijohej përshtypja që dikush ishte në kontroll në
24 negociatave ose në kontroll të pjesshëm të negociatave ose në
25 qoftë se ishin në një pozitë as kështu as ashtu, domethënë,

1 diku në mes. Mua nuk më është krijuar përshtypja që ai kishte
2 kontroll të plotë mbi negociatat, por mendoj që ai
3 përfaqësonte interesat nga jashtë dhe mendoj që këto interesa
4 nga jashtë kishin ndikimin e tij mbi autoritetin ose mbi
5 kontrollin ese sjelljen e tij gjatë negociatave.

6 PY. A e keni dëgjuar ju z. Thaçi të bisedonte konkretisht me
7 ndokënd në Kosovë?

8 PË. Nga sa kam kuptuar unë të paktën bazuar në pyetjet që kam
9 bërë po me kërkoj flet Hashimi gjatë gjithë kohës në telefon -
10 unë kam qenë delegacion, unë nuk flija tek kështjella, unë
11 flisja në hotel në Versajë, por pjesën tjetër isha gjatë
12 gjithë kohës me delegacionin dhe mua më thonin - po me Kosovën
13 po flet, disa nga shqiptarët e Kosovës në kështjellë të cilët
14 i takoja rregullisht, por ideja është që më thonin që atij i
15 vijnë thirrje telefonike nga mëmëdheu.

16 Dhe gjithashtu vura re -- tani po ndaloj jo për
17 përkthyesit, po të më kujtohet çik mirë. Më kujtohet se më
18 shumë binte telefoni i tij edhe ai duhet të dilte jashtë dhe
19 të bënte -- nuk ishte ai, domethënë, që e kërkonte thirrjen
20 telefonike, po atij i binte telefoni.

21 PY. A ju kujtohet emri i këtij shqiptaro-amerikanit?

22 PË. Dino Hasani.

23 PY. Në raport thuhet që këshilltari tha se "shqiptarët e
24 diasporës kishin ndikim të jashtëzakonshëm dhe ishin më të
25 prerë se ata që ishin në vend". Është diçka që e keni thënë ju

1 kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Mbi ç'baza e keni thënë këtë?

4 PË. Rreth një vit para Rambujesë isha shumë i përfshirë me
5 komunitetin shqiptar të Kosovës në Shtetet e Bashkuara si
6 nëpërmjet Këshillit Kombëtar për Shqiptarët e Kosovës, që
7 ishte një organizatë e regjistruar kjo, si dhe përmes bisedave
8 personale me anëtarë me ndikim të diasporës. Deri në pikën kur
9 Ambasadori Holbrooke erdhi në New York të informonte
10 komunitetin shqiptaro-amerikan në restorantin Bruno në New
11 York, më kërkuan dhe mua të shkoja dhe të isha pjesë e ekipit
12 shqiptaro-amerikan që do të informohej prej Holbrooke dhe
13 kishin plan që të ishin të ashpër me të për shkak të
14 marrëveshjes së tetorit apo negociatave në vazhdimësi e sipër.

15 Dha shumë informacion, po kam qenë shumë, shumë i
16 përfshirë me komunitetin shqiptaro-ameirkan.

17 PY. Mbi ç'baza dolët në përfundimin që ata ishin shumë më të
18 prerë dhe më këmbëngulës se ata që ishin në vend?

19 PË. Së pari, gjatë takimeve që kishim gjatë drekës, gjatë
20 drekës me Holbrooke, Holbrooke tha, "Ju jeni më keq se
21 shqiptarët e Kosovës". Sepse perceptimi ishte i atillë, i
22 drejtë apo i padrejtë, që ata jetonin në New York, kishin
23 hapësirën dhe kishin privilegjin t'i bënin disa kërkesa, t'i
24 vendosnin disa kushte, nuk po them është e drejtë apo jo kjo
25 që po them.

1 Një dimension tjetër është që kur punoja me Bujar
2 Bukoshin dhe me shqiptaro-amerikanët, po them "shqiptaro-
3 amerikan" sepse këta ishin pika ime e kontaktit. Thuhet edhe
4 diaspora, po un dua të përdorë këtë terminologji do them
5 shqiptaro-amerikan për hir të dëshmisë sime, kështu që
6 sigurisht që ata përfaqësonin diasporën në mbarë botën, kështu
7 e kam kuptuar unë të paktën.

8 Ne bisedonim dhe unë gjendesha shpesh në një situatë
9 shumë delikate për t'ua shpjeguar pozicionet apo për të
10 ndryshuar disa nga qëndrimet që kishin sepse ata donin me
11 patjetër me doemos pavarësinë në ato momente. Ju shpjegoja
12 sesi UÇK-ja do të transformohet në një ushtri më të rregullt,
13 pra, këto linja bisedash në përgjithësi. Kur them ishte
14 delikate, ishte delikate sepse unë isha jurist dhe kisha
15 mundësinë t'u jepja këshilla por duhet të isha i kujdesshëm.
16 Dhe shpesh duhet të gjeja një ekuilibër, të moderoja me
17 shqiptaro-amerikanët sepse ata donin me patjetër që të kishte
18 vijimësi nga marrëveshjet e Hill dhe të Holbrooke dhe në
19 fshatin e Rambujesë duhet të isha po ashtu të shikoja çfarë
20 ndodhte në realitet, Dina që ishte një person i hapur. Si
21 jurist ishte i hapur, i kuptonte mendimet e mia.

22 PY. Dr. Williams dua të flasim përsëri për një temë që
23 diskutuam pak më herët kur thatë ju "Thaçin e kontrollonin
24 ngushtësisht nga jashtë" dhe ju pyeta si dolët në konkluzion,
25 ju pyeta me kë keni biseduar.

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 94

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykues do të
2 doja të përdorja shënimin përgatitor për t'i rifreskuar
3 kujtesën dëshmitarit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me patjetër.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë në
6 ekran materialin DHT0234-DHT0255, ju lutem
7 PY. Ndërkohë që presim shënimin përgatitor dua t'ju pyes, Dr.
8 Williams, ne u takuam javën e kaluar, biseduam përmes
9 videolidhjes javën e kaluar në kuadër të seancave përgatitore
10 dhe përgatitëm një shënim në vijim të këtyre takimeve?

11 PË. Po.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit të
13 dokumentit.

14 PY. Këtu ka një konfirmim në fund që thuhet:

15 "Informacioni në këtë shënim iu lexua sërish dëshmitarit
16 1DW001", që jeni ju, "i cili konfirmoi se pasqyronte
17 saktësisht dhe tërësisht dëshminë e tij", saktë?

18 PË. Po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shkojmë në paragrafin 25.

20 Thuhet këtu:

21 "Sa i takon fjalisë që ata treguan siç pritej, që Thaçi
22 po kontrollohej ngushtësisht apo shumë prej jashtë': kjo është
23 100 për qind në përputhje me pikëpamjet e Dëshmitarit 1DW-001
24 edhe ajo çka thuhet në deklaratën e tij prej dëshmitari.

25 Dëshmitari 001 vuri re se Thaçi ishte në kontakt të

1 vazhdueshëm telefonik edhe u përgjigjej, u raportonte
2 komandantëve lokal si dhe anëtarëve të UÇK-së dhe diasporës në
3 fshatin Rambuje që ishin që ishin jashtë kështjellës.”

4 Pyetja ime është kjo: A ju kujtohet që ju keni vënë re që
5 z. Thaçi u raporte, në mos u nënshtrohej komandantëve të
6 zonës?

7 PË. Po, kështu më kujtohet dhe mua.

8 PY. Po si dolët në këtë konkluzion që ai u raporte, në mos
9 dhe ju nënshtrohej, komandantëve të zonës?

10 PË. Ata e telefononin, ai e hapte telefonin, bisedonin në
11 telefon për një periudhë të caktuar kohore edhe më pas ai
12 komentonte për procesin, jepte *feedback* për procesin, prandaj
13 thashë që ai u raporte atyre, prandaj dola në këtë përfundim.

14 PY. Do ua bëj kështu pyetjen. Ju flisnit shqip?

15 PË. Jo.

16 PY. Po nga e dinit ju me kë po fliste dhe çfarë po thoshte?

17 PË. Shpesh, meqenëse isha në kështjellë, shpesh u kërkoja
18 kolegëve shqiptarë të Kosovës, i thosha, “Po me kërkoj po flet
19 Hashimi tërë kohën, me kë është në telefon?”. Dhe ata më
20 thonin, me ekipin e tij, me shqiptarët, kosovarët edhe ata
21 vetë më kanë thënë që po flet me komandantët lokalë.

22 PY. Ju kujtohet ndonjë person konkret nga delegacioni që ua
23 ka thënë këtë?

24 PË. Blerim Shala, Dugi, më falni për shqiptimin nuk më
25 kujtohet dhe mbiemri, ai madje më ndihmonte për përkthime dhe

1 Edita Tahiri, sepse në fakt punonim bashkë për dokumentet.

2 PY. Faleminderit.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani dua të shohim një dokument
4 tjetër -- ose më saktë shohim njëherë paragrafin 27 të
5 deklaratës suaj.

6 PY. Ju thoni:

7 "... këshilltarët e UÇK-së ishin të shqetësuar për
8 natyrën e ballkanizuar të njësive të UÇK-së ..."

9 Kush ishin këta këshilltarë të shqetësuar për kë e keni
10 fjalën?

11 PË. Dino Hasani dhe kolegët e tij të UÇK-së në fshatin e
12 Rambujesë.

13 PY. Këshilltarët e UÇK-së, për shembull, Dino Hasani, me sa
14 dini ju, ua paraqiti këto shqetësime anëtarëve të delegacionit
15 të UÇK-së?

16 PË. Përshtypja ime ishte që kjo ishte diçka që ai e ka
17 ngritur me anëtarët e delegacionit dhe konkretisht i është
18 kërkuar të punonte me mua, të ndihmoja delegacionin që të
19 ruanim kohezionin si anëtarët e UÇK-së, si dhe UÇK-në brenda
20 delegacionit.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, në rreshtin 4
22 të kësaj faqeje e pyetët dëshmitarin:

23 "Kush ishin këta këshilltarë që ishin të shqetësuar?"

24 Dhe përgjigja ishte Dino Hasani dhe UÇK", po më duket se
25 mungon një fjalë këtu.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] "Kolegët" doja të thoja dhe
2 kolegët e tjerë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Dua të shikojmë një pjesë tjetër. Në paragrafin 33, thoni
6 që më 21 shkurt, delegacioni i Kosovës do ta nënshkruante
7 marrëveshjen e Rambujesë, por z. Thaçi mori një thirrje
8 telefonike dhe më pas u vendos që nuk do ta nënshkruani. Ju
9 thatë që keni qenë në dhomën ku ishte delegacioni gjatë kësaj
10 kohe. Pyetja ime është kjo: Ju e patë vetë me sytë tuaj që z.
11 Thaçi i erdhi një thirrje telefonike?

12 PË. Po.

13 PY. A e dini se prej kujt dhe nga e dini këtë?

14 PË. Jo, nuk e di prej kujt e mori këtë thirrje telefonike.

15 PY. E patë z. Thaçi ju t'u thoshte anëtarëve të tjerë të
16 delegacionit që nuk mund ta nënshkruante marrëveshjen?

17 PË. Po.

18 PY. Në çfarë toni ju drejtua ai, me çfarë toni ju drejtua
19 anëtarëve të tjerë të delegacionit?.

20 PË. Dukej që ishte i shqetësuar. Ju kërkonte ndjesë. I
21 shqetësuar, i stresuar sepse ishte në dijeni të pasojave të
22 mundshme. Deklarata u hoq në fakt nga kompjuteri im apo nuk
23 është e nevojshme

24 PY. Nëse doni mund ta vendosim.

25 PË. Jo, nuk ka problem.

1 PY. Në këtë takim, z. Thaçi ose e patë ju z. Thaçi të
2 kërcënonte të tjerët apo personat e tjerë të silleshin sikur
3 po kërcënoheshin prej dikujt?

4 PË. Jo. Unë kam qenë aty në sallë. I kam vënë re sjelljen.
5 Nuk pash ndonjë sjellje kërcënuese.

6 PY. A kishit ndonjë përkthyes ju?

7 PË. Po.

8 PY. Kush?

9 PË. Me shumë të ngjarë Dugi.

10 PY. Nuk e di kush është.

11 PË. Ka qenë anëtar i delegacionit.

12 PY. Mos e keni fjalën për Dukagjin Goranin?

13 PË. Po. Ne, në fakt, ne i thërrisnim Dugi atij prandaj dhe i
14 referohem kështu, kishte një arsye për këtë.

15 PY. Z. Gorani ju tha ju në një mënyrë që shiko se më duket po
16 ka kërcënime këtu në këtë grup?

17 PË. Në asnjë moment nuk ma tha një gjë të tillë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Për dëshmitarin, ju lutem, ta
19 nxjerrim sërish në ekran deklaratën. 1D375. Ju lutem të
20 shkojmë në paragrafin 32 të deklaratës.

21 PY. Këtu thoni:

22 "Gjatë negociatave në Rambuje Hashim Thaçi u largua nga
23 *chateau* për një ditë dhe shkoi drejt Sllovenisë për t'u takuar
24 me Adem Demaçin. Mesa kuptova unë ky ishte një takim i
25 rëndësishëm për të siguruar mbështetjen e Demaçit për të

1 nënshkruar marrëveshjen."

2 Së pari, nga e dini ju që Hashim Thaçi u largua nga
3 kështjella për të shkuar në Slloveni për të takuar Adem
4 Demaçin?

5 PË. Kur pyeta kolegët shqiptaro-amerikanë në kështjellë i
6 thashë "Ku është Hashimi?" ata mu përgjigjën që "Shkoi në
7 Slloveni për të folur me Demaçin".

8 PY. A të thanë pse po shkonte të fliste me Adem Demaçin?

9 PË. U interesova në fakt, e bëra këtë pyetje, si na shërben
10 ne kjo u thashë, si i shërben kjo procesit dhe përgjigja ishte
11 që ishte e domosdoshme për arsye politike dhe kulturore, ishte
12 e nevojshme që Hashimi të shkonte në Slloveni dhe të vizitonte
13 Demaçin.

14 PY. A zbulove më vonë pastaj se si lidhej kjo vizitë me
15 Rambujenë, nëse kishte ndonjë lidhje?

16 PË. Po.

17 PY. Çfarë zbulove, çfarë mësove?

18 PË. Gjatë kohës që delegacioni kosovar ishte në Rambuje edhe
19 po bënë ecuri, kishte progres për nënshkrimin e marrëveshjes,
20 por ama kishte trysni nga jashtë të cilat i diskutuam më herët
21 sot, nga komandantët lokalë, por gjithashtu kishte presion
22 ideologjik, po them dhe kulturor, po e shtoj, prej Adem
23 Demaçit, i cili po pengonte progresin e këtyre negociatave
24 edhe po them me të ngjarë, do them me të ngjarë, po cenonte
25 lëvizjen për realizimin e kësaj marrëveshjeje, prandaj duhej

1 trajtuar ky aspekt.

2 PY. Me sa keni ju dijeni a ka pasur ndonjë problematikë
3 konkrete, kishte ndonjë shqetësim konkret Adem Demaçi?

4 PË. Po.

5 PY. Cili ishte problemi i Adem Demaçit?

6 PË. Pavarësia.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin 41 të
8 deklaratës suaj.

9 PY. Këtu thoni:

10 "Përshtypja ime ishte që Thaçi nuk kishte autoritet për
11 t'i dhënë pëlqim marrëveshjes pa marrë miratimin e
12 komandantëve regjional të UÇK-së, veçanërisht për faktin se e
13 këtë e kundërshtonte Adem Demaçi."

14 Ku e keni bazuar këtë përshtypje, nga ju është krijuar
15 kjo përshtypje?

16 PË. Më është krijuar kjo përshtypje për shkak të mënyrës sesi
17 reagoi Hashim Thaçi ose reagonte ndaj telefonatave apo nevojës
18 për t'u larguar nga Rambujeja për të shkuar në një takim me
19 Adem Demaçin dhe për shkak të këmbënguljes së vazhdueshme se
20 shpesh më kërkonin mua të dilja nga kështjella të flisja me
21 Dino Hasanin me përfaqësuesit, siç më thanë atëherë, këta
22 ishin përfaqësuesit e komandantëve lokalë, pra, kjo ishte e
23 vazhdueshme, më kërkohet vazhdimisht.

24 Më lejoni të shtoj dhe diçka, ju lutem?

25 PY. Po.

1 PË. Nuk është puna se më thanë "Je juristi ynë, shko mbushu
2 mendjen, shko tregoju atyre çfarë po bëjmë ne këtu. Ose
3 informoi për zhvillimet më të fundit". Nuk ishte ky lloj
4 komunikimi, s'po flasim për këtë lloj marrëdhënieje

5 PY. Po.. po ju thatë -- dua të pyes për diçka, ju thatë:

6 "... angazhimi i tyre për të më dërguar mua shpesh jashtë
7 kështjellës pretë folur me Dino Hasanin dhe me përfaqësuesit,
8 siç më thanë, të komandantëve të zonës."

9 Mund të na sqaroni çfarë doni të thoni "siç më thanë të
10 komandantëve të zonës"?

11 PË. Për shkak të -- unë kisha marrëdhënie të ngushtë me
12 Dinon, miqësore dhe kolegiale. Dhe kur shkova tek hoteli dhe
13 kur më tha Dino "hajde pak te hoteli, takohemi me komandantët
14 lokalë", shkova. Dhe i thashë Dinos, "Sa mirë që u takuam
15 sërish". Edhe aty ishin dhe disa persona të tjerë tek
16 kafeneja, tek kafja ku ishim. Dhe Dino më tha, "Këta janë
17 shokët e mi, shokët e mi të UÇK-së. Jemi të shqetësuar. Dhe
18 duam të bisedojmë me ty". Natyra kulturore dhe konfidenciale
19 nuk ishte e atillë që ata të prezantoheshin, të më thoshin mua
20 "Ky është Fredi, ky është Xhorxh, nga kjo zonë e nga kjo
21 zonë", por në atë kohë unë e konceptova kështu, ky është Dino,
22 këta janë shokët e tij.

23 Ishte e qartë që Dino Hasani ishte shqiptaro-amerikani që
24 kishte lidhjet më të ngushta publike me UÇK-në. Pra, kur
25 Dinoja tha, "Këta janë shokët e mi nga UÇK-ja", për mua ishte

1 e qartë që këta janë persona me pushtet dhe me autoritet
2 brenda UÇK-së. Dhe detyra ime ishte t'i ndihmoja të bënë të
3 qarta pikat që donin të paraqiteshin dhe të merrja udhëzime
4 prej tyre sa i takon zhvillimeve gjatë negociatave nga
5 pikëpamja teknike dhe juridike, të shërbeja, pra, si urë
6 lidhëse mes tyre që ishin jashtë kështjellës dhe atyre që
7 ishin brenda kështjellës nga UÇK-ja.

8 PY. Ju thatë që ai "nuk mund të jepte pëlqimin për
9 marrëveshjen pa marrë miratimin e komandantëve rajonalë të
10 UÇK-së". Për kë e keni fjalën ju këtu?

11 PË. Ky është një përshkrim i përgjithshëm për të treguar që
12 s'kishte kompetenca dhe autoritet. Nuk mund t'i rendisja me
13 emra komandantët e zonave.

14 PY. A është bërë ndonjë diskutim lidhur me nevojën e z. Thaçi
15 për të diskutuar me komandantët rajonalë?

16 PË. Mund t'ju them që ishte shumë e qartë se ai ishte një
17 përfaqësues i UÇK-së dhe ishte zëri i UÇK-së në atë kështjellë
18 dhe fizikisht mund të shihja që kishte dhe zëra të tjerë madje
19 në fshat që ishin pak milje larg. Prandaj dhe e kuptova unë që
20 ai nuk kishte autoritetin për të dhënë pëlqimin për
21 marrëveshjen.

22 PY. Faleminderit. A keni punuar për Kosovën pas luftës?

23 PË. Po.

24 PY. Pas Rambujesë a keni punuar apo a i keni dhënë këshilla
25 Qeverisë së Përkohshme së Kosovës apo anëtarë të kësaj

1 qeverie?

2 PË. Po.

3 PY. Kur? Ose lidhur me çfarë temash?

4 PË. Dino Hasani u identifikua si përfaqësues i Qeverisë së
5 Përkohshme në Shtetet e Bashkuara, kështu që jam takuar disa
6 herë me Dinon për të biseduar lidhur me mënyrën se si mund ta
7 kryente ai këtë rol në komunitetin e vet dhe si dhe do të
8 angazhohej në aktivitete të tjera që lidheshin me Qeverinë e
9 Përkohshme të Kosovës por që do të zhvilloheshin Washington.

10 Gjatë kësaj periudhe kohore jam angazhuar me statusin
11 përfundimtar të negociatave -- nuk po flasim vetëm për
12 Qeverinë e Përkohshme, po përgjithësisht me shqiptarët e
13 Kosovës. Unë kam punuar me të gjitha palët, kuptohet, për
14 kushtetutën, për pavarësinë dhe kështu me radhë.

15 PY. Kush ju caktoi të punonit bisedimet e Vjenës?

16 PË. President Rugova.

17 PY. Kur? Ju kujtohet?

18 PË. Jo.

19 PY. President Rugova ju kërkoi ju apo organizatës suaj të
20 bënit ndonjë punë tjetër për Kosovën?

21 PË. Presidenti Rugova më kërkoi të përgatisja një
22 projektkushtetutë për Kosovën, të cilën unë e bëra.

23 PY. Cila ishte natyra e marrëdhënies suaj me aktorët në
24 arenën politike në Kosovë pas luftës?

25 PË. Pas luftës në Kosovë, jam takuar dhe kam punuar, me

1 përjashtim të ndonjë kryeministri, me të gjithë kryeministrat
2 e tjerë të Kosovës dhe me të gjithë presidentët e Kosovës.
3 Pra, kështu.

4 PY. Në rregull. Faleminderit. Dr. Williams, më thanë që mund
5 të kem pas një problem tek transkripti, dua të sigurohem që të
6 jetë tamam në transkript. Do flasim dhe një herë për takimin
7 në sallën ku z. Thaçi merr një thirrje telefonike dhe thotë që
8 nuk mund ta nënshkruajë marrëveshjen e Rambujesë. Sipas
9 transkriptit thuhet kështu.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në faqen 85 të transkriptit,
11 rreshtat 16 deri në 19.

12 PY. Pyetja ishte kjo:

13 "Në këtë takim z. Thaçi a vutë re që z. Thaçi të
14 kërcënonte ndokënd apo të tjerë të silleshin sikur po
15 kërcënoheshin?"

16 Dhe sipas transkriptit thuhet:

17 "Jo, nuk e pashë, unë kam qenë në sallë. E kam parë
18 sjelljen e tyre dhe kam parë sjellje kërcënuese."

19 PË. Jo, është gabim kjo.

20 PY. Çfarë duhet të thoshte?

21 PË. Jo, thashë kështu, unë e vërejta sjelljen e tyre dhe nuk
22 vërejta asgjë kërcënuese.

23 PY. Faleminderit që iu përgjigjët pyetjeve të mia.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe me kaq unë mbyll pyetjet e mia
25 për ju.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
2 Tani do të bëjmë pushimin e drekës. Pushimi i drekës është një
3 orë e gjysëm, Dëshmitar. Do të shihemi bashkë në orën 2.30. Ju
4 faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Ju lutem mos flisni me
5 askënd jashtë sallës për dëshminë tuaj.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
8 deri në orën 2.30.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
12 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Dr. Williams, do vazhdojmë me pyetjet nga Ekipet e tjera të
16 Mbrojtjes.

17 z. Dixon.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Alagendra.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Kam pyetje.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

25 Z. ELLIS: [Përkthim]

1 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Unë jam Aidan Ellis dhe
2 përfaqësoj Jakup Krasniqin, që është ulur prapa. Kam disa
3 pyetje për juve sot pasdite, kryesisht lidhur me z. Krasniqi.

4 PË. Në rregull.

5 PY. Është e drejtë apo jo që jeni takuar me z. Krasniqi gjatë
6 negociatave në Rambuje?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe z. Krasniqi ka qenë pjesë e delegacionit të Kosovës
9 dhe ka qëndruar në Rambuje gjatë gjithë negociatave?

10 PË. Po.

11 PY. Z. Misetic më herët sot ju pyeti nëse ju apo z. Weller
12 keni këshilluar z. Thaçi se UÇK-ja, e kishit informuar, pra,
13 që UÇK-ja kishte detyrimin që të hetonte dhe të ndëshkonte
14 pjesëtarët e saj për shkelje të rënda të ligjit humanitar
15 ndërkombëtar dhe përgjegjja juaj ishte jo. A është e drejtë të
16 themi që e njëjta gjë vlen edhe për z. Krasniqi. Pra. që ju
17 dhe z. Weller nuk e keni informuar atë në mënyrë konkrete
18 lidhur me këtë?

19 PË. E saktë.

20 PY. Gjithashtu, më herët sot përmendët kohezionin në
21 delegacionin e Kosovës, z. Krasniqi ishte pjesë e këtij
22 kohezioni, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Ju keni arritur në Francë nga data 5 shkurt 1999 më
25 duket?

1 PË. Saktë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran
3 dokumentin DHT05893 deri në DHT05895, faqen e dytë. Më poshtë.
4 PY. Që t'ju orientojmë, kjo është një kabllogram nga Shtetet
5 e Bashkuara.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Pak më poshtë, ju lutem, që të
7 shohim paragrafin në mes të faqes.

8 PY. Dr. Williams, e shikoni këtu që është shënuar që:

9 "Ceremonia hyrëse filloi, u hap në kohë dhe me gjithë
10 pjesëtarët e delegacioneve të pranishëm. Në një shfaqje të
11 qartë bashkimi, udhëheqësi i LDK-së, Rugova u ul afër
12 zëdhënësit të UÇK-së, që ishte z. Krasniqi."

13 A përputhet kjo me atë që ju kujtohet juve, pra, që
14 Rugova u ul afër z. Krasniqi në hapjen e mbledhjes?

15 PË. Nuk kam qenë aty. Unë kam shkuar aty më 8 kur i jam
16 bashkuar tyre gjërave. Por, përgjigja ime është, po, në
17 përgjithësi kjo pasqyron frymën që kam vërejtur në kështjellë

18 PY. Faleminderit.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin dhe do ta
20 dorëzoj këtë, ta paraqes këtë për pranim në prova.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
22 kundërshtim?

23 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Nuk ka lidhje
24 me dëshmitarin kjo gjë edhe pse ai përmendi frymën që ishte
25 aty. Ai nuk ishte i pranishëm në ngjarjen e përmendur.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
3 shprehem, të bëj parashtime lidhur me këtë?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ai nuk
5 ishte aty. Njohuria e tij është thjesht supozim. Kjo është
6 arsyeja që e pranova kundërshtimin.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, por si parashtimi ynë është që
8 kjo është verifikuar, testi është bërë përmes provave të tjera
9 goftë përmes kriterëve të rregullës 138, që janë përkatësisht
10 relevanca autenticiteti dhe vlera provuese.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bazuar në një
12 supozim pra.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk është supozim. Është dokument.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai tha që ai
15 supozon që ai është ulur afër tij, afër njeri-tjetrit.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] E kuptoj këtë, por ne parashtojmë
17 dhe e dorëzojmë këtë dokument për t'u pranuar sepse përmbush
18 kriteret e rregullës 138 dhe dokumentet janë, ka dokumentet të
19 tjera që janë paraqitur në mënyrë të përsëritur për të cilat
20 dëshmitarët nuk kishin dijeni vetë por ishin relevante, kishin
21 vlerë provuese dhe autentike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e shohim
23 dokumentin.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Ishte DHT05893.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di se çfarë

1 është. Po nuk është në ekran. Ja tani është.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Është kabllogrami i Shteteve të
3 Bashkuara një prej atyre të ndryshmeve që janë pranuar në
4 ditët e kaluara.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për ju, z.
6 Ellis. A po kërkonit të mbështeteni në ndonjë gjë tjetër
7 përveçse pjesës që i lexuat dëshmitarit në këtë kabllogram?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë për çfarë na
10 duhet?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di se
12 çfarë vlere të shtuar sjell kjo?

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Pika është që më herët gjatë këtij
14 gjykimi, Prokuroria pranoi një fotografi dhe ne e kundërshtuam
15 atë sepse kishte vlerë shumë të kufizuar provuese, të qartë,
16 të dukshme për qëllimet për të cilat u tregua, që ishte për
17 armiqësinë mes z. Krasniqi dhe z. Rugova. Dhe ajo që po
18 përpiqem të tregoj përmes këtij kabllogrami është që, në fakt,
19 ata janë ulur afër njeri-tjetrit në këtë konferencë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar, në qoftë se mund të
21 përgjigjem shkurtimisht lidhur këtyre parashtimeve të gjëra
22 që sapo dëgjova.

23 Testi i verifikimit që Mbrojtësi i z. Krasniqi sapo
24 paraqiti për pranimin përmes provave jo gojore. Kur ne kemi
25 kërkuar që të paraqiten materiale të tilla përmes dëshmitarit

1 që është në sallë të gjyqit, duhet të jetë një lidhje me
2 dëshmitarin. Dhe, siç e thatë, vendosët ju, Gjykatës, nuk
3 ekziston një lidhje e tillë.

4 Për më tepër nuk ka, është çështja e relevancën e cila
5 nuk është vërtetuar.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vendimi im
7 është ai që thashë më herët.

8 Vazhdoni.

9 Z. ELLIS: [Përkthim]

10 PY. Dr. Williams, në ecurinë e konferencës, delegacioni
11 kosovar u nda në grupe pune të ndryshme, apo jo?

12 PË. Po, është e saktë.

13 PY. Dhe pjesë e rolit tuaj si këshilltar ligjor ishte që të
14 bënit lidhjen, të ndërlihdhnit këto grupe që punonin grupe
15 pune?

16 PË. E saktë.

17 PY. Ju përmendët Fehmi Aganin në dëshminë tuaj më herët sot,
18 është kështu, a është e saktë që Fehmi Agani, Jakup Krasniqi,
19 Blerim Shala dhe Mehmet Haziri ishin pjesë e grupeve të punës
20 në negociatat në Rambuje?

21 PË. Më kujtohet tre të parët, po.

22 PY. Dhe për tre të parët që ju kujtohen Fehmi Agani, Jakup
23 Krasniqi, Blarim Shala kanë punuar së bashku, kanë
24 bashkëpunuar në këtë grup pune, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe është e saktë të themi që Fehmi Agani ishte pjesë e
2 delegacionit të LDK-së, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se mund të kaloj pak përtej
6 Konferencës së Rambujesë.

7 PY. Ju e konfirmuat më herët që keni punuar si këshilltar
8 ligjor për pjesën e delegacionit të Kosovës edhe në negociatat
9 për statusin përfundimtar në Vjenë dhe në hartimin e
10 kushtetutës?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe kjo ka ndodhur në 2006-n, 2007-n, apo jo?

13 PË. Me sa më kujtohet, po.

14 PY. A patët mundësinë që të takonit z. Jakup Krasniqi gjatë
15 këtyre negociatave?

16 PË. Po.

17 PY. Edhe këtu delegacioni i Kosovës ishte ndarë në grupe pune
18 të ndryshme dhe i përbërë nga përfaqësues të partive të
19 ndryshme?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe z. Krasniqi ishte pjesë e grupit politik strategjik
22 bashkë me pjesëtarë të tjerë, anëtarë të tjerë të partive
23 politike të tjera, përfshirë LDK-në, apo jo?

24 PË. Nuk më kujtohet saktësisht kjo.

25 PY. A është e saktë që ashtu siç ishte në Rambuje, siç bëri

1 në Rambuje, z. Krasniqi luajti një rol bashkëpunues,
2 kooperativ me partitë e tjera, palët e tjera në negociata?
3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe një pjesë e rëndësishme e negociatave të statusit
5 përfundimtar dhe kushtetutës kishte të bënte me mbrojtjen
6 kushtetuese të grupeve pakica në Kosovë, përfshirë pakicën
7 serbe dhe rome?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe z. Krasniqi pati rol pozitiv në punën që u bë për të
10 siguruar këtë mbrojtje?

11 PË. Po.

12 PY. Një moment. Faleminderit, Dr. Williams. Nuk kam pyetje
13 tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 z. Ellis.

16 Z. Pace, keni ndonjë pyetje?

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Pace:

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

20 PË. Kënaqësi t'ju takoj përsëri.

21 PY. Jemi takuar më parë, është e vërtetë, por po prezantohem
22 edhe një herë. Unë jam James Pace, Prokuror në ZPS. Dhe do
23 t'ju bëj disa pyetje, siç tha Gjykatësi më herët, për rreth dy
24 orë e gjysëm.

25 Ju nuk keni qenë asnjëherë në Kosovë apo Shqipëri në

1 1998-n apo në 1999-n, a është kështu?

2 PË. Saktë.

3 PY. Më herët dëshmuat që nuk dini shqip, nuk kuptoni shqip.

4 Nuk dinit shqip as në 1999?

5 PË. Saktë.

6 PY. Nuk ju kujtohet të keni parë përpara Rambujesë ndonjë

7 dokument apo komunikatë të lëshuara nga UÇK-ja, a është

8 kështu?

9 PË. Saktë.

10 PY. Përpara Rambujesë ju personalisht nuk kishit dijeni për

11 organizimin, strukturën e organizimit të UÇK-së?

12 PË. Saktë.

13 PY. Në 1998-n apo 1999-n, përveç kohës kur ishit në Rambuje

14 apo në Paris, ju nuk keni marrë pjesë në mbledhje apo takime

15 ku përfshiheshin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

16 PË. Saktë.

17 PY. Përpara shkurtit 1999, nuk kishit takuar asnjëherë apo

18 nuk kishit pasur kontakt me asnjë komandant zone të UÇK-së?

19 PË. Saktë.

20 PY. Në shkurt të 1999-s, ju nuk e dini as emrat e

21 komandantëve të zonave të UÇK-së, a është kështu?

22 PË. Saktë.

23 PY. Përpara Rambujesë ju nuk kishit marrë pjesë në asnjë

24 mbledhje në të secilën tema se kush nga UÇK-ja do të merrte

25 pjesë në Rambuje është diskutuar pra?

1 PË. Saktë.

2 PY. Nuk ju kujtohet që përpara Rambujesë keni dëgjuar apo
3 lexuar ndonjë gjë lidhur me përbërjen e delegacionit të
4 Kosovës në Rambuje, a është kështu?

5 PË. Saktë.

6 PY. Përpara shkurtit 1999, ju nuk kishit takuar apo patur
7 ndonjë kontakt me ndonjë nga katër personat e akuzuar në këtë
8 çështje?

9 PË. Saktë.

10 PY. Nuk ju kujtohet të jeni takuar apo të keni patur ndonjë
11 kontakt me Rexhep Selimin, a është kështu?

12 PË. Saktë.

13 PY. Siç i thatë ZPS-së para dy javësh, kur ju e takuat për
14 herë të parë z. Thaçi në Rambuje ajo që dinit ju për të ishte
15 se ai ishte shkolluar në Zvicër, është kështu?

16 PË. E saktë.

17 PY. Pra, përpara Rambujesë ju nuk dinit nëse z. Thaçi ishte
18 një prej anëtarëve themelues të UÇK-së, saktë?

19 PË. Saktë.

20 PY. Nuk e dinit përpara Rambujesë nëse z. Thaçi ishte anëtar
21 i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

22 PË. Saktë.

23 PY. Nuk e dinit përpara Rambujesë nëse z. Thaçi ishte anëtar
24 i Drejtorisë Politike të UÇK-së?

25 PË. Saktë.

1 PY. Përpara Rambujesë ju nuk e dinit nëse z. Thaçi ishte
2 drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së?

3 PË. Saktë.

4 PY. Në paragrafin 16 të deklaratës suaj, ju thoni se përpara
5 Rambujesë ju kishit një marrëdhënie të afërt me kryeministrin
6 Bujar Bukoshi dhe përmes tij me Presidentin Rugova. Dhe ju
7 dëshmuat për këtë marrëdhënie të ngushtë me z. Bukoshi më
8 herët sot gjatë dëshmisë suaj. Përpara Rambujesë, a kishit
9 dijeni, ishit në dijeni të ndonjë tensioni apo problemi midis
10 z. Bukoshi dhe anëtarëve të UÇK-së?

11 PË. Jo.

12 PY. Përpara se të shkonit në Rambuje, a dinit nëse Hashim
13 Thaçi kishte akuzuar Bujar Bukoshin publikisht për financimin
14 e vrasjes dhe tentativës për vrasje të komandantëve të UÇK-së
15 dhe që kishte plane për të likuiduar Shtabin e Përgjithshëm të
16 UÇK-së?

17 PË. Jo.

18 PY. Ju deklaruat se keni arritur me avion në Francë në 5
19 shkurt 1999 dhe keni qëndruar aty gjatë raundit të parë të
20 bisedimeve të konferencës. Keni shkuar në Rambuje, në
21 kështjellën e Rambujesë për herë të parë ku delegacioni i
22 Kosovës është takuar me datë 8 shkurt 1999?

23 PË. E saktë.

24 PY. Ju besoni që ka shumë gjasa të ju jeni prezantuar me z.
25 Thaçi më 8 shkurt 1999?

1 PË. Po.

2 PY. Ju nuk ju kujtohet të keni qenë i pranishëm kur z. Thaçi
3 është zgjedhur kryesues i delegacionit të Kosovës?

4 PË. E saktë.

5 PY. Raundi i parë i bisedimeve në Rambuje përfundoi më 23
6 shkurt 1999 dhe ju u kthyet në Washington DC, saktë?

7 PË. Saktë.

8 PY. Dhe qëndruat në Washington disa derisa u kthyet në Paris
9 në 14 mars 1999, saktë?

10 PË. Saktë.

11 PY. Raundi i bisedimeve në Paris përfundoi më 19 mars 1999
12 dhe pastaj ju u kthyet në Washington DC?

13 PË. Saktë.

14 PY. Këshilltari nga diaspora të cilin e përmendët por të
15 cilit nuk ia dinit emrin në deklaratën për Mbrojtjen e Thaçit,
16 ishte Dino Hasani, të cilin ju e përmendët edhe sot?

17 PË. Po.

18 PY. Deklarata që i keni dhënë Mbrojtjes së Thaçit në këtë nuk
19 përmendet në mënyrë konkrete Jakup Krasniqi?

20 PË. E saktë.

21 PY. E keni parë Jakup Krasniqin në Rambuje disa herë, shumë
22 herë?

23 PË. E saktë.

24 PY. A keni qenë në një grup së bashku me të?

25 PË. Kemi qenë në takime grupesh të vogla që kishin të bënin

1 me çështje të ndryshme.

2 PY. A ju kujtohen temat e ndryshme në lidhje me të cilat keni
3 qenë bashkë me z. Krasniqi?

4 PË. Këto kishin të bënin me çështje të kushtetueses, mbrojtja
5 e të drejtave të pakicave dhe rishikimi për analiza e anekseve
6 ushtarake.

7 PY. Takimet, mbledhjet në nivel ministerial apo të
8 sekretarëve të jashtëm në të cilat ju keni marrë pjesë në
9 Rambuje kanë qenë të pranishëm aty i gjithë delegacioni i
10 Kosovës, apo jo?

11 PË. E saktë.

12 PY. Dhe a e dini kush ka qenë i pranishëm në mbledhjet e
13 nivelit ministerial apo sekretarial në të cilat ju nuk marrë
14 pjesë?

15 PË. Jo.

16 PY. Deklarata jua nuk përmend -- në deklaratën tuaj nuk
17 përmendet në mënyrë konkrete Kadri Veseli?

18 PË. E saktë.

19 PY. Kur ju pyeta në intervistën e ZPS-së para dy javësh që të
20 përgendroheshit dhe të përpiqeni të kujtoheshit nëse e kishit
21 takuar Kadri Veselin në Rambuje, ju u përgjigjët që:

22 "Në këtë pikë nuk dua të shkoj përtej deklaratës sime për
23 t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje dhe po e mbështes këtë thjesht
24 në atë që më kujtohet në çast tani."

25 A ju kujtohet nëse jeni takuar me z. Veseli në Rambuje

1 brenda apo jashtë kështjellës?

2 PË. Nuk më kujtohet ta kem takuar atë brenda apo jashtë
3 kështjellës.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua t'ju ndërhyj në
5 pyetjet tuaja, por pak më parë pyetët dëshmitarin nëse përpara
6 Rambujesë a kishte dijeni për ndonjë tension midis z. Bukoshit
7 dhe pjesëtarëve të UÇK-së. A mund ta pyesni atë në qoftë se ai
8 ka mësuar për tensione të tilla qoftë pas Rambujesë?

9 Z. PACE: [Përkthim] Nëse mund ta bëj këtë pyetje por pak
10 më vonë, i nderuar Gjykatës.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Natyrisht.

12 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani do të doja të shfaqnim në ekran SPOE40010709-
14 40010710. Mund të zmadhojmë pjesën ku është e shkruar *Wall*
15 *Street Journal* pak më shumë. Në rregull tani.

16 PY. Dëshmitar, në ekran shohim që ky është një artikull nga
17 *Wall Street Journal* i datës 28 prill 1999.

18 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër që mbaron me
19 710. Dhe do të lexoj duke filluar nga paragrafi 4 në krye.
20 Pra, të zmadhojmë këtë pjesë. Pak më shumë.

21 PY. Dhe pastaj do të lexoj duke filluar nga "Bukoshi është
22 garda e vjetër ..." Pra, citim:

23 "Bukoshi është garda e vjetër, Thaçi është garda e re",
24 thotë Paul Williams, ish-zyrtar i Departamentit të Shtetit
25 Amerikan i cili tani punon si përfaqësues ligjor për qeverinë

1 e Bukoshit dhe i cili ka përfaqësuar të dy këta persona në
2 bisedimet që dështuan për pagën në Rambuje, në Francë. Z.
3 Williams thotë që është një 'tension i natyrshëm' mes të dyve,
4 por përshkruan z. Thaçi si një 'përfaqësues politik efikas' i
5 cili 'është i angazhuar dhe me terma të pastër'".

6 Ju kujtohet që keni thënë këtë në ose përpara prillit
7 1999?

8 PË. Po.

9 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë që ky dokument të pranohet
10 si provë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE40010709
15 deri në 40010710 pranohet. Dhe në qoftë se s'është publik,
16 duhet të jetë publik, të bëhet publik.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 kjo do të marrë numrin e provës materiale P4491 dhe
19 riklasifikohet si publik.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Vazhdoni.

22 Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin. Dhe do të kërkoj
23 të shfaqim në ekran tani dokumentin tjetër i shënuar si IT-05-
24 87 1D00018 dhe mund të kalojmë në faqen e parë për momentin.
25 PY. Ky është një publikim nga Marc Weller, u tregua kjo sot

1 në mëngjes. Marc Weller ishte një tjetër këshilltar për
2 delegacionin e Kosovës, këshilltar ligjor, por ju nuk e keni
3 përmendur atë në deklaratën tuaj.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen 1D00-0620,
5 që duhet të jetë faqja PDF 398. Po. Këtu lexoj nga paragrafi i
6 tretë nga fundi, pra, të zmadhojmë pjesën në fund. Po.

7 PY. Dhe do lexoj aty ku fillon "Delegacioni i Kosovës..."

8 "Delegacioni i Kosovës në fund përbëhej pak a shumë nga
9 një e treta përfaqësues të LDK-së (përfshirë Presidentin e
10 zgjedhur Rugova dhe Kryeministrin Bukoshi), një e treta LBD
11 dhe një e treta UÇK. Për më tepër, kishte dy të pavarur, Veton
12 Surroi dhe Blerim Shala, të dy gazetarë të spikatur dhe
13 intelektualë. Në përgjithësi kjo do të thonte që LBD-ja që
14 ishte më radikale dhe përfaqësuesit e UÇK-së dominonin
15 delegacionin me dy me një. Për rrjedhojë, në vend të
16 Presidentit të zgjedhur Ibrahim Rugova, delegacioni udhëhiqej
17 nga Hashim Thaçi, në atë kohë 29 vjeçar, jashtëzakonisht
18 inteligjent dhe udhëheqës jashtëzakonisht inteligjent dhe i
19 vendosur i UÇK-së, emri i luftës i të cilit ishte "Gjarpri" të
20 cilin e kishte fituar në muajt e përparshëm të ballafaqimit
21 ushtarak. Ai kishte reputacionin që ishte jashtëzakonisht
22 efikas në konsolidimin e mëparshëm të pikëpamjeve të ndryshme
23 dhe brenda UÇK-së dhe shikohej nga qeveria e Beogradit me
24 urrejtje të veçantë."

25 Dëshmitar, a e dinit ju që Hashim Thaçi kishte fituar

1 emrin e luftës Gjarpri përpara Rambujesë?

2 PË. Jo.

3 PY. Dhe a e dinit se Hashim Thaçi kishte reputacion për
4 efikasitet të lartë në konsolidimin e pikëpamjeve që më parë
5 ishin të ndryshme brenda UÇK-së?

6 PË. Jo.

7 Z. PACE: [Përkthim] Z. Gjykatës, do të kërkoja të dorëzoj
8 këtë faqe për t'u pranuar si provë dhe që t'i shtohet provës
9 materiale P04259, e cila përmban faqe të tjera nga i njëjti
10 dokument.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Natyrisht. Ai sapo bëri
14 kundërshtimin ndaj kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit dhe tani
15 kërkon të bëjë të njëjtën gjë, që është në fakt edhe më keq.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

17 Z. PACE: [Përkthim] A mund të përgjigjem në qoftë se
18 duhet dhe në mungesë të dëshmitarit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, në
20 mungesë të tij. Vazhdoni përgjigjuni.

21 Z. PACE: [Përkthim] Nuk mendoj që duhet të detyrohem të
22 paraqes argumentet e mia lidhur me besueshmërinë e
23 dëshmitarit, në prani të dëshmitarit lidhur me këtë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
25 mund të largoheni nga salla për pak.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
3 deklarata e tij, ai nuk di asgjë për këtë dhe doni që ta
4 paraqisni këtë dokument?

5 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kemi një
6 dëshmitar i cili gjatë marrjes në pyetje deri tani pranoi se
7 nuk dinte asgjë për Hashim Thaçin përveçse ishte i shkolluar
8 në Zvicër.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju thatë
10 që --

11 Z. PACE: [Përkthim] Përpara se të shkonte në Rambuje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ai sapo
13 tha që nuk e di atë për të cilën ju e pyetët.

14 Z. PACE: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai po
16 pajtohet me ju, është dakord me ju.

17 Z. PACE: [Përkthim] Po. Fakti që ky dëshmitar nuk kishte
18 këtë informacion dhe fakti që u pajtua ne mua është relevant
19 për vlerësimin e tij të autoritetit të Hashim Thaçi gjatë
20 Marrëveshjes së Rambujesë dhe pastaj deklarata e tij është e
21 mbushur me pohime që kanë të bëjnë me autoritetin e Hashim
22 Thaçit. Pra, ky material që tregova është relevant qoftë për
23 besueshmërinë e dëshmitarit dhe akuzat kundër të akuzuarve
24 duke patur parasysh se burimi i këtij është i ngjashëm, ky ka
25 qëndrim të ngjashëm me atë që ka dëshmitari këtu. Ai ishte

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 123

1 këshilltari tjetër ligjor i jashtëm për këtë delegacion. Dhe
2 njohuria e këtij dëshmitari lidhur me anëtarët e delegacionit,
3 në veçanti z. Thaçi, është shumë relevante për provat e
4 Prokurorisë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Vendimi është i njëjtë siç e thashë. Në qoftë se keni ndonjë
7 pyetje për të mund të shikoni kundërshtimin që bëtë pyetjes së
8 z. Ellis.

9 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
12 vazhdoni, znj. Prokurore.

13 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim dokumentin nga ekrani.

14 PY. Dëshmitar, anëtarë të caktuar jo të UÇK-së që ishin pjesë
15 e delegacionit të Kosovës, u impresionuan ose la shumë
16 përshtypje puna e Hashim Thaçit si drejtues i delegacionit,
17 apo jo?

18 PË. A ma bëni dhe një herë pyetjen, ju lutem?

19 PY. Mund t'jua bëj ndryshe atëherë pyetjen. Mesa dini ju, a
20 kishte persona jo anëtarë të UÇK-së ose pjesë e delegacionit
21 që vërtetë u la shumë përshtypje të mirë drejtimi prej Hashim
22 Thaçit i delegacionit kosovar?

23 PË. Nuk e di në qoftë se anëtarë të tjerë të delegacionit i
24 ka lënë përshtypje drejtimi i tij, nuk e di ç'a përshtypjes
25 kanë pasur ata.

1 Z. PACE: [Përkthim] Dua të paraqitet në ekran dokumenti
2 P04216. Është një video. Dhe përbri videos do kërkoja që të
3 paraqitet në ekran përkthimi në anglisht që është 065452-01-
4 TR-ET E Rishikuar. Në transkript ne do fillojmë nga fundi i
5 faqes 13 dhe do vazhdojmë më tej me faqen 14. Ndërkohë në
6 video do kërkoja që të paraqitet videoja në minutën e 30:48
7 deri në minutën 31:47. Ju lutem vazhdojmë pak më poshtë në
8 transkript dhe pastaj mund të fillojmë. Pra, është fundi i
9 faqes se transkriptit në anglisht dhe fillimi i faqes 14.

10 Nuk është e nevojshme që të lexojmë transkriptin në
11 shqip. Por për referencë, transkript në shqip është përsëri në
12 DHT006137.

13 [Luhet videoincizimi]

14 [Zëri] "... krahu i djathtë në konferencë i Dr. Rugovës
15 ka fjalë të mira për Thaçin si shef i delegacionit.

16 "Mbresat e mia janë të veçanta sepse ai ishte i ri për
17 nga mosha, nuk kishte shumë përvojë politike por kishte shumë
18 përvojë në kuptimin organizativ dhe sigurisht shumë i
19 guximshëm dhe i vendosur për të qenë në Ushtrinë Çlirimtare të
20 Kosovën, madje dhe udhëheqës politik i tyre. Pra, ishte një
21 profil, pavarësisht moshës, kishte një profil të lartë në
22 kuptimin e udhëheqjes. Dhe e bëri mirë, pra, e ka udhëheqë
23 mirë delegacionin."

24 Z. PACE: [Përkthim] Të ndalojmë këtu.

25 PY. A e njohët Edita Tahirin në ekran, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. Këtë person e keni takuar gjatë Rambujesë, apo jo,

3 Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. E keni takuar edhe vitet pas luftës duke përfshirë edhe

6 kohët e fundit, apo jo?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. A keni qenë në dijeni të kësaj pikëpamje të znj. Tahiri

9 lidhur me Hashim Thaçi në atë kohë?

10 PË. Jo domosdoshmërisht.

11 PY. Ça do të thotë kjo, na e shtjelloni pak më tepër.

12 PË. Unë nuk kam folur --

13 PY. Jo, pyetja ime ishte tjetër. Unë thjesht dua t'ju pyes në

14 qoftë se keni qenë në dijeni të kësaj përshtypje që ka pasur

15 Edita Tahiri për Hashim Thaçin. A është kështu, apo jo?

16 PË. Është e saktë.

17 PY. Në Rambuje, z. Thaçi ka pasur presion të jashtëzakonshëm

18 nga znj. Albright dhe nga persona të tjerë të lartë për

19 nënshkrimin e marrëveshjes. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Sot paradite, thatë që gjatë Rambujes ju nuk merrnit

22 pjesë kur kishte "punë të brendshme të Kosovës" dhe këtu citoj

23 atë çfarë thatë ju. Mes ju kujtohet juve sa shesh mbaheshin

24 mbledhje ose takime të tilla?

25 PË. Me aq sa më kujtohet mua kishte biseda të vazhdueshme

1 deri vonë në mbrëmje në kështjellë lidhur me çështje të
2 brendshme të delegacionit kosovar.

3 PY. Dhe ju nuk keni qenë pjesë e këtyre bisedave se ju keni
4 fjetur jashtë kështjellës, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Anëtarët joanëtarë të UÇK-së të delegacionit të Kosovës
7 ishin pro nënshkrimit të marrëveshjes, apo jo?

8 PË. E saktë.

9 PY. Sot paradite thatë që kur z. Thaçi i përcollët anëtarët e
10 tjerë të delegacionit mesazhin që ai nuk e nënshkruante dot
11 marrëveshjen, qëndrimi i tij ishte në një farë mënyre ai ishte
12 "i stresuar, ishte ancioz, ju kërkonte falje sepse e dinte se
13 cilat ishin pasojat". Ju thatë që kjo në fakt ishte diçka që
14 ju e kishit parë si rezultat i sjelljes së z. Thaçi dhe këtë
15 po ashtu e keni kuptuar edhe personi, nga Dukagjin Gorani i
16 cili ka shërbyer si përkthyes i juaji në atë kohë.

17 Po ashtu në intervistën e ZPS-së, ju keni thënë që z.
18 Thaçi kur i ka shpjeguar anëtarëve të tjerë të delegacionit të
19 Kosovës kur tha që nuk do të nënshkruante marrëveshjen e
20 Rambujesë, ai kishte një zë "diplomatik, i kishte folur me
21 respekt dhe kishte treguar një qëndrim normal gjatë asaj
22 kohe".

23 A ia keni thënë këtë ZPS-së, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Do shohim një video tani.

1 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë që të
2 paraqesë në ekran dokumentin 128791-02 së bashku me 128791-02-
3 TR. Në transkriptin në anglisht do të doja që të fillonim nga
4 fondi i faqes 9 dhe të vazhdonim më tej në faqen 10. Vazhdojmë
5 pak më poshtë në transkript deri në fund të faqes. Në fakt
6 është faqja tjetër se kjo është faqja 8. Kërkova që të
7 paraqitet faqja 9. Domethënë, drejt fundit të faqes 9. Dhe
8 pastaj do vazhdojmë në faqen 10.

9 Në video dua të transmetohet duke filluar nga minuta
10 44:02. Atëherë do vazhdojmë ta dëgjojmë videon dhe do ta shohim
11 atë dhe do ta transmetojmë deri në minutën e 45:30.

12 "E thashë edhe një herë tjetër që duhet të fillojmë në
13 anglisht nga 44:02 dhe pastaj do vazhdojmë tek faqja tjetër.

14 Videoja do jetë në anglisht, kështu që do dua që ta
15 ndiqni me zë përmes përkthyesve përkthimin.

16 [Luhet videoincizimi]

17 "Fokusi ishte te delegacioni shqiptar. Ata kishin
18 zgjedhur një person të ri dhe pa përvojë të UÇK-së që quhej
19 Hashim Thaçi si udhëheqësin e tyre. I gjithë delegacioni bënte
20 thirrje për pranimin e tij. Por ai kundërshtoi për shkak të
21 marrëveshjes se nuk ishte përfshirë, pra, referendumi ose
22 pavarësia në tekstin.

23 "Delegacioni caktoi Thaçin si udhëheqës duke e ditur që
24 ata do të bëheshin të burgosurit e tij.

25 "Ndërkohë sa i takon Thaçit, Thaçi ishte shumë i kursyer

1 dhe tha jo.

2 "Thaçi ishte shumë i drejtpërdrejtë me delegacionin, ju
3 tha troç, ky dokument, ky prezantim, ky formulim është
4 tërësisht i papranueshëm.

5 "Ai përdori formulim ose gjuhë që mund të kuptohej si
6 kërcënuese dhe tha që kushdo që do ta nënshkruante këtë
7 dokument tani unë do ta trajtoj, do ta konsideroj atë si armik
8 të kombit.

9 "Ky ishte ilustrim grafik i fuqisë së armëve që kishin në
10 duar shqiptarët e Kosovës. Kërcënimi i Thaçit ndaj delegatëve
11 të tjerë dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit nuk e ndaloi
12 atë që të kishte një marrëdhënie të ngushtë e cila u zhvillua
13 ndemjet tij dhe sponsorizuesëve ndërkombëtarë."

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, pyetja ime e parë është në qoftë se njihni
16 ndonjë nga personat të cilët u shfaqën në ekran?

17 PË. Po.

18 PY. A mund të na thoni kush janë?

19 PË. Është Veton Surroi dhe pastaj Dugi.

20 PY. Pra, është Dukagjin Gorani, apo jo?

21 PË. Po, Gorani.

22 PY. Tani kjo ishte një video e BBC-së, një dokumentar i BBC-
23 së që është transmetuar në 2000.

24 Sot paradite ju thatë që z. Surroi asnjëherë nuk ju ka
25 përmendur juve që është ndjerë i kërcënuar nga z. Thaçi. Po

1 ashtu theksuat sot paradite që keni një lidhje të fortë
2 profesionale dhe personale me z. Surroi. A keni qenë në dijeni
3 që z. Surroi ia ka dhënë këtë informacion ose e ka thënë këtë
4 informacion për BBC-në?

5 PË. Nuk e kam parë më përpara këtë dokumentar këtë të BBC-së.

6 PY. Pyetja ime është kjo: A jeni në dijeni që z. Surroi e ka
7 thënë ndonjëherë këtë gjë, domethënë, a ju ka thënë z. Surroi
8 juve që i ka dhënë intervistë BBC-së dhe ka folur për tema të
9 caktuara?

10 PË. Jo.

11 PY. A jeni në dijeni që Dugi ose Dukagjin Gorani ka thënë atë
12 çfarë ju e dëgjuat që ai t'i ketë thënë gazetarit të BBC-së?

13 PË. Jo, jo informacionin e dhënë në këtë fragment që unë
14 dëgjova.

15 PY. Dukagjin Gorani a ju ka treguar juve ndonjë gjë pas
16 Rambujesë që është ndjerë i kërcënuar ose ka parë një mjedis
17 kërcënues në Rambuje?

18 PË. Jo.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
20 pjesa që sapo shfaqëm të mund të pranohet në prova materiale
21 për vërtetësinë e përmbajtjes së tij, pro gjithashtu edhe për
22 qëllime diskretitimi, duam që të shtohet tek prova F04487.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam të njëjtin kundërshtim, i
24 nderuar Gjykatës, duke përdorur të njëjtin formulim që përdor
25 zakonisht z. Pace, dëshmitari nuk ka shtuar asgjë me vlerë.

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne mendojmë që
2 ekzistojnë baza për pranimin e këtij dokumenti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ku e mbështet
4 ti diskretitimin e këtij dëshmitari? Ku është kjo bazë?

5 Z. PACE: [Përkthim] Ne e kemi dëgjuar, ky dëshmitar ka
6 thënë që nuk ka dëgjuar asnjë gjë kërcënuese të thanë në goja
7 e z. Thaçi, ndërkohë që e dëgjuam në këtë video që në fakt
8 situata ka qenë e ndryshme.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai ka thënë
10 që nuk e ka pasur asnjëherë një informacion të tillë dhe si e
11 bën këtë lidhje ti, mund të na e shpjegosh?

12 Z. PACE: [Përkthim] Nuk po them që dëshmitari po gënjen,
13 por këtu tregues ose kemi informacion që thonë që këta janë dy
14 personat të cilët kanë shfaqur këto shqetësime të tyre dhe
15 besojmë që është me vend që të kërkojmë pranimin e këtij se sa
16 i takon besueshmërisë së këtij dëshmitari, po gjithashtu edhe
17 vërtetësisë së përmbajtjes së këtij dokumentari në BBC-së.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Pjesa e dytë sa i takon
19 vërtetësisë së përmbajtjes, dëshmitari nuk ka thënë asgjë, nuk
20 është se ka shtuar asgjë, domethënë, nuk është se ka shtuar
21 absolutisht asnjë informacion dëshmitari lidhur me këtë.

22 Prokuroria e ka pasur dy vite e gjysëm për të qartësuar
23 pozicionin e vet. Dhe dëshmitari nuk ka thënë asgjë që do të
24 vinte në pikëpyetje besueshmërinë e tij si dëshmitar, nuk ka
25 pikë lidhjeje.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
3 jepini një numër paraprak prove. Do të marrim vendim lidhur me
4 të më vonë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 duhet të sqaroj diçka. Sepse Prokurori kam përshtypjen që
7 kërkoi të shtonte këtë dokument në një provë ekzistuese që
8 është P04487. Duhet t'i caktoj një numër të ri apo duhet ta
9 lidhë me këtë provë?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jepini një
11 numër të ri.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në këtë rast segmenti
13 përkatës, domethënë, minuta 44:02 deri në minutën 45:30, faqja
14 9 deri në 10 e transkriptit do të marrin numrin provizor të
15 provës si P4492.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
17 fjala për ju.

18 Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin nga ekrani.

19 PY. Dëshmitar, më herët ju thatë që z. Thaçi është sjellë në
20 mënyrë të respektueshme dhe diplomatike në Rambuje. A e dini
21 në qoftë se z. Thaçi është sjellë në mënyrë diplomatike dhe të
22 respektueshme ndaj z. Bukoshi gjatë të gjithë Konferencës së
23 Rambujesë?

24 PË. Po.

25 PY. Do të thotë kjo që ju e dini që është sjellë kështu apo

1 që çfarë do të thotë, mund të na e thoni?

2 PË. E di që është sjellë kështu. Në qoftë se doni mund t'ju
3 jap informacion shtesë.

4 PY. Nuk kam nevojë për informacion shtesë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Tani dokumenti tjetër nuk duhet të
6 transmetohet për publikun. I kërkoj Sekretarisë që të paraqesë
7 në ekran dokumentin 078271-TR-ET Pjesa 4 RED. Shohim faqen 27.
8 Do të lexoj nga rreshti 15 e më poshtë.

9 PY. Për kontekst, më lejoni t'ju them që kjo është intervistë
10 e Veton Surroit, Dëshmitar. Do lexoj nga rreshti 15 në faqen
11 tuaj.

12 Z. PACE: [Përkthim] Ndërkohë që për përkthyesit nuk kemi
13 versionin në shqip.

14 PY. Atëherë do ju lexoj pjesën pastaj do ju pyetjen:

15 "PY. Dhe një pjesë e retorikës që ë përdorur gjer
16 përpara Rambujesë ka qenë shumë e fortë. A ka manifestuar kjo
17 mënyrën se si Thaçi ka ndërvepruar me z. Rugova dhe Bukoshin?

18 "PË. Në një pikë ai e kërcënoi Bukoshin. Mendoj që i
19 hodhi një kafe, jo një filxhan por një filxhan kafeje ekspres.

20 "PY. Për çfarë arsye e bëri këtë gjë?

21 "PË. Nuk e di, nuk ka qenë ndonjë gjë thelbësore, ndonjë
22 gjë e madhe, por kanë pasur disa mosmarrëveshje, mospajtime,
23 por në një pikë situata u bë e komplikuar dhe filluan që të
24 thoshin gjëra të tjera që 'Ti ke bërë këtë' 'LDK-ja kështu',
25 'Ti ashtu', e gjëra që kësaj natyre'" - vazhdojmë tek faqja

1 tjetër - "Nuk do ishim këtu në qoftë se nuk do ishte ti', 'Kjo
2 është arsyeja pse jemi këtu, pra, jeni ju.'"

3 Pra, ajo çfarë dua t'ju pyes është në qoftë se ju e dini
4 që z. Thaçi ka kërcënuar z. Bukoshi dhe i ka hedhur një
5 filxhan kafeje atij. E di këtë gjë?

6 PË. Jo.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të bëj një koment,
8 Gjykatës?

9 Ne në fakt dy vite na është thënë nga Gjykatësit që të
10 mos shfaqim në ekran dokument të kësaj natyre.

11 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk ishte transmetim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mos
13 flisni lëreni avokatin që të flasë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kundërshtoj sepse po zbatohen
15 dy standarde tërësisht të ndryshme, keni zbatuar tjetër
16 standard për Prokurorinë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'kemi
18 aplikuar, s'kemi zbatuar asnjë standard deri tani. Thjesht po
19 dëgjojmë.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë do ju përmend urdhrin
21 gojor.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo. Ajo
23 që po them unë është që ne nuk kemi bërë asnjë deklaratë
24 lidhur me këtë. Deklaratën po e bëni ju.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshmitarit iu tregua një

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 134

1 deklarata e llojit për të cilën ju nuk e keni lejuar

2 Prokurorinë që t'i tregojë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk kemi
4 marrë vendim fare lidhur me këtë pyetje se nuk na u kërkua kjo
5 gjë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase s'po shprehem unë qartë. E
7 mbaj unë përgjegjësinë. Neve nuk na është lejuar që t'i
8 tregojmë dëshmitarëve këto lloj dëshmish gjatë marrjes në
9 pyetje.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kemi lejuar. Ju kemi
11 thënë që nuk duhet të jetë zgjidhja e parë, duhet të jetë
12 zgjidhja e dytë në qoftë se nuk keni zgjidhje tjetër.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Por mendoj që mund të bëhet kjo
14 gjë pa e thënë tekstin, pa e treguar tekstin në ekran.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po na thoni neve që Pace
16 duhet ta kishte bërë pyetjen pa e treguar tekstin dhe pastaj
17 të mos e kishte treguar tekstin. Këtë po thoni, Misetiç?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ekzaktësisht të njëjtën gjë po
19 them.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni më tej, Pace.

22 Ju lutem bëjini një pyetje për themelin, për bazën se
23 çfarë di dëshmitari përpara sesa të shfaqësh dokumente të
24 tilla në ekran.

25 Z. PACE: [Përkthim] Do e kem parasysh për të ardhmen. Po

1 nuk planifikoj që të përdor dokumente të tilla, të paktën për
2 tani.

3 PY. Dëshmitar, do kalojmë në një tjetër temë pak.

4 Në deklaratën tuaj ju thoni që delegacioni i Kosovës
5 dëshironte që të kishte një dispozitë të qartë në Marrëveshjen
6 e Rambujesë që Kosova të kishte pavarësi ose që të kishte
7 vetëvendosje të jashtme në fund të periudhës së përkohshme
8 prej tre vitesh. Dhe që më pas të behej një referendum dhe
9 fati pastaj të vendosej pas referendumit, domethënë, ose
10 njërën ose tjetrën.

11 Atëherë delegacioni i UÇK-së në Rambuje nuk e nënshkroi
12 Marrëveshjen e Rambujesë sepse në atë kohë nuk u parashikua
13 pjesa e pavarësisë për të ose referendumi që do të bëhej pas
14 periudhës tre vjeçare. A është arsyeja kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Hashim Thaçi dhe pjesëtarët tjerë të UÇK-së e bënë të
17 qartë goxha përpara shkurtit të 1999-s që ata nuk do ta
18 mbështesnin asnjëherë një zgjidhje politike pa u përmendur
19 shprehimisht pavarësia në dokumentin përfundimtar, a është e
20 saktë kjo, dëshmitar?

21 PË. Në Rambuje në shkurt të 1999-s, ky është mesazhi që më
22 është transmetuar mua vetë.

23 PY. Për ta sqaruar përgjigjen tuaj, Dëshmitar. Në shkurt të
24 1999-s kur keni qenë në Rambuje, ju keni mësuar që përpara
25 Rambujes Hashim Thaçi dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së e

1 kishin bërë të qartë që ata nuk do të nënshkruanin apo e
2 keqkuptova?

3 PË. E keqkuptuat tërësisht. Pyetja që më bëtë ju mua ishte në
4 qoftë se unë isha në dijeni të qëndrimit të UÇK-së përpara
5 Rambujes. Dhe unë ju thashë që në Rambuje UÇK-ja ma bën të
6 qartë qëndrimin e tyre për pavarësinë.

7 Po të doni mund të jap informacion shtesë për mënyrën se
8 si e dija unë se çfarë qëndrimi kishte delegacioni i UÇK-së
9 dhe që ata donin me patjetër që të përfshihej pavarësia në
10 Rambuje.

11 PY. E kuptoj. Po nuk është kjo pyetje ime. Po ju bëj një
12 pyetje tjetër, megjithatë le të shikojmë një dokument.

13 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
14 në ekran P01067.

15 PY. Më korrigjoni në qoftë se e kam gabim, por ju keni
16 përvojë me punën me Sekretarin e Shtetit, apo jo?

17 PË. Kam qenë këshilltar ligjor në Departamentin e Shtetit,
18 kam qenë një prej këshilltarëve udhëheqës ose kryesorë për
19 Departamentin e Shtetit për çështjet evropiane dhe kanadeze.

20 PY. Dhe në këtë cilësi tuajën, ju besoj që keni lexuar
21 kabllograme, apo jo?

22 PË. Po. Domethënë, jo shumë, megjithatë ky material që kam
23 këtu, domethënë, kabllogrami. E njoh atë, e kam parë më
24 përpara është konfidencial, tani është i klasifikuar.

25 PY. Të shohim dokumentin, data është 3 nëntor 1998, është

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 137

1 drejtuar nga Ambasada Amerikane në Beograd dhe i dërgohet
2 Sekretarit së Shtetit në Washington DC.

3 PË. Po, është e qartë.

4 PY. Më lart në krye, me ç'kuptoj unë, numri kanë të bëjnë me
5 datën, domethënë, që është 3 nëntor 1998. A e konfirmoni këtë?

6 PË. Po, është nëntor i 1998. Po, është e qartë.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. PACE: [Përkthim] Tani --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
10 lutem. Sepse kemi problem me kompjuterin.

11 Do bëjmë dhjetë minuta pushim tani.

12 Dëshmitar, do ju japim dhjetë minuta pushim pastaj do
13 kthehemi përsëri për të vijuar me dëshminë.

14 DËSHMITARI: Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushim deri në orën 3.40.

18 --- Seanca ndërpritet në orën 15.23

19 --- Seanca rifillon në orën 15.39

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, mund të na
21 ndihmoni, ju lutem, që të vendosim lidhur me pikën që
22 diskutuam. Ju nxorët dëshmi prej këtij dëshmitari sa i takon
23 ekzistencës të kërcënimeve nëse kishte, apo marrëdhënies mes
24 anëtarëve të ndryshëm të delegacionit. Të paktën siç e kuptuam
25 ne. Na ndihmoni, ju lutem, ta kuptojmë më mirë. Çfarë mendoni

1 ju se është relevante për argumentat tuaja që ta kuptojmë dhe
2 ne çfarë do të ishte relevante për këtë dëshmitar.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është relevante për ne. Këtë e
4 ka ngritur Gjykatësi Gaynor me një dëshmitar tjetër dhe ne
5 pyetëm dhe këtë dëshmitar meqë ka njohur të drejtpërdrejta.
6 Mbase këto ishin argumentet dhe qëndrimi juaj. Nuk ishte pjesë
7 e argumenteve tona. Thjesht ne e bëmë këtë për një pyetje të
8 Gjyqtarëve.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis pyeti çfarë u tha
10 aty dhe si ishin të lidhur personat me njëri-tjetrin. A është
11 pjesë kjo e qëndrimit tuaj? Ose mbase z. Ellis mund të
12 përgjigjet për z. Krasniqi. Përpigjeni të kuptoni dinamikën ju
13 mes aktorëve të ndryshëm atje në Rambuje? Është kjo relevante
14 për qëndrimet tuaja?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do flas për z. Thaçi. Dinamika
16 nuk është pjesë e argumenteve tona. Unë thjesht doja që të
17 vijoja më tej dhe të sqaroja një nga pyetjet që bëri Gjykatësi
18 Gaynor.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë do të bëj unë një
20 pyetje, z. Misetiç.

21 Kur i bëtë pyetje këtij dëshmitari lidhur me çështjen
22 nëse z. Thaçi ka kërcënuar anëtarë të ndryshëm të delegacionit
23 të shqiptarëve të Kosovës, a pranoni ju vetë që në këtë mënyrë
24 i dhatë një bazë Prokurorisë t'i bëjë pyetje dëshmitarit
25 lidhur me këtë, sepse ju jeni pala që e nxorët këtë dëshmi në

1 pyetjet tuaja si palë thirrëse?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Nuk është pjesë e qëndrimit
3 tonë dhe argumenteve tona. Unë thjesht po reagoja për një
4 çështje që u nxor nga Trupi Gjykues.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ne pyetëm një dëshmitar
6 tjetër.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kjo është me interes me ne.
8 Marrëdhënia mes anëtarëve të delegacionit në Rambuje nuk është
9 pjesë e qëndrimit të Prokurorisë, e për rrjedhojë nuk është
10 diçka që ne duam ta trajtojmë e t'i kundërpërgjigjemi por
11 thjesht e trajtova me këtë dëshmitar sepse e ngritët ju me një
12 dëshmitar tjetër.

13 Z. PACE: [Përkthim] A mund të them diçka edhe unë?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
15 [Përkthim] Z. Ellis, nëse dëshironi mund të jepni dhe ju
16 një përgjigje.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk e di a dua të shtoj diçka më
18 shumë, por dhe ne reaguam sepse këtë e ka nxjerrë Prokuroria
19 për një dëshmitar tjetër dhe deshëm të reagonim dhe ne. Bëhet
20 fjalë për një material që gjendet te paketa 2144.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju, Pace,
22 mund të flisni tani.

23 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka rëndësi se si doli ky aspekt,
24 mbase për Gjykatësin Gaynor -- prej Gjykatësit Gaynor, apo jo,
25 por vetë Mbrojtja ka nxjerrë dëshmi me këtë dëshmitar lidhur

1 me këtë. Po ne jemi pala kundërpyetëse. Ne po reagojmë ndaj
2 pyetjeve që kanë bërë ata për këtë dëshmitar.

3 Gjithashtu dua të theksoj se ajo që tha z. Misetic nuk
4 është e saktë sa i takon qëndrimit të Prokurorisë. Qëndrimi i
5 Prokurorisë përfshin Hashim Thaçin dhe të tjerët, dhe ka dhe
6 pretendime ku përfshihen, ndër të tjera, që kanë kërcënuar
7 anëtarë të LDK-së dhe anëtarë të tjerë që nuk ishin të UÇK-së.
8 E dhashë thjesht për ilustrim këtu. Këtu kemi pikërisht një
9 situatë ku kanë qenë të gjithë në kështjellë, UÇK-ja dhe jo-
10 UÇK-ja. Pra mënyra sesi ka komunikuar Hashim Thaçi,
11 veçanërisht me anëtarët jo të UÇK-së sigurisht që është tepër
12 relevante për qëllimin tonë, për argumentat tona.

13 Ne kemi të drejtë të nxjerrim dëshmi që gjykojmë që janë
14 relevante për argumentat tona, dëshminë e kishim, e kishim dhe
15 dëshmitarin këtu, kështu që ne kemi të drejtën tonë t'i bëjmë
16 pyetje dëshmitarit dhe gjithashtu pala -- palët sigurisht kanë
17 të drejtë të diskutojnë, të bëjnë parashtrime lidhur me këtë
18 edhe ne kemi të drejtë të kërkojmë dhe të pranojmë materiale
19 për diskreditim për dëshmitarin siç është bërë për Mbrojtjen.

20 Të njëjtën të drejtë do ta gëzojmë dhe ne si pala
21 kundërpyetëse. Duhet të gëzojmë të njëjtat të drejta.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk besoj
23 se ka çështje besueshmëria këtu në fakt. Mbase të shpëtoi goja
24 kur e the sepse ka të bëjë këtu me çështjen tuaj. Nuk bëhet
25 fjalë për besueshmërinë e këtij dëshmitari. Dëshmitari nuk ka

1 lidhje fare me këtë, por do të marrim ne vendim lidhur me
2 këtë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse është pjesë e qëndrimit të
4 tyre atëherë po e theksoj dhe një herë. Kanë pasur më shumë se
5 dy vjet ta bënë të qartë këtë përmes argumenteve të tyre.
6 Mund ta bënë përmes mocioneve jogojore dhe nuk e kanë bërë
7 asnjëherë. Kanë nxjerrë një dokument në ekran, nuk po e
8 përmend më dokumentin për një dëshmitar që mund ta kishin
9 thirrur lidhur me këtë aspekt dhe nuk e thirrën. Dhe nuk është
10 tani momenti që të nxjerrin dëshmi dhe të kërkojnë të pranojë
11 -- pranohen prova për aspekte që nuk janë fare pjesë e
12 argumenteve tona sikurse e thashë. E pyetëm dëshmitarin për
13 shkak se u bë një pyetje nga gjykatësit më herët. Nuk është
14 çështje e ngritur nga Prokuroria, veçanërisht për çfarë ka
15 ndodhur në Rambuje.

16 Nuk mendoj madje se e ka -- Prokuroria nuk e ka diskutuar
17 pothuajse fare çështjen e Rambujesë me dëshmitarët.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Morëm
19 parashtime të mjaftueshme. Do të marrim vendim në momentin e
20 duhur.

21 Mund të vijë dëshmitari në sallë.

22 Z. Pace, do përfundoni sot mendoni apo do të keni pyetje
23 dhe për nesër?

24 Z. PACE: [Përkthim] Kanë ngelur dhe 45 minuta. Në qoftë
25 se nuk përfundoj sot, do të mbaroj shumë shpejt nesër. Besoj

Dëshmitari: Paul Williams (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 142

1 se do mbaroj ose brenda orët 4.30, madje mund të mbaroj dhe më
2 herët.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na falni që
5 duhet të prisnit. Patëm një problem teknik fatkeqësisht.

6 DËSHMITARI: Keni plot biskota te dhoma ku më çuat kështu
7 që unë u kënaqa.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk kemi
9 biskota këtu.

10 DËSHMITARI: Herën tjetër do ju sjell unë ca nga dhoma ku
11 më lini.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
13 fjala është për ju.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, para pushimit po shikonim dokumentin që është
16 në ekran. Pamë që është një kabllogram. Ju e njihni natyrën e
17 këtij materiali, jo materali në vetvete. Dhe thamë që nga 3
18 nëntori 1998, Ambasada e ShBA-së në Beograd ja ka dërguar këtë
19 kabllogram Sekretares së Shtetit.

20 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua të shkojmë në faqen 075306.
21 Shkojmë në fund, të lexoj nga paragrafi 15.

22 PY. Thuhet këtu:

23 "Thaçi dhe kolegët e tij jo çuditërisht kërkojnë pavarësi
24 dhe thonë se nuk do të mbështesin një zgjidhje politike pa u
25 përmendur qartë kjo gjë në dokumentin përfundimtar."

1 Dëshmitar, keni dijeni ju që z. Thaçi dhe kolegët e tij
2 të kenë shprehur pikëpamje të tilla përpara Rambujesë?
3 PË. Jo konkretisht, nuk kam qenë domosdoshmërisht që Thaçi dhe
4 kolegët e tyre e kanë shprehur këtë pikëpamje, megjithatë,
5 këto përputhen 100 për qind me pikëpamjet e shqiptaro-
6 amerikanëve dhe të tjerëve me të cilët kam komunikuar unë kur
7 jepja këshilla juridike *pro bono*, falas.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

9 PY. Dëshmitar, ju nuk e keni takuar asnjëherë Adem Demaçin
10 dhe nuk keni pasur kontakte me të apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Ai nuk ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
13 së, apo jo?

14 PË. Nuk kam dijeni lidhur me këtë.

15 PY. A e dini nëse ka qenë -- nëse është emëruar në pozicionin
16 e tij nga Shtabi i Përgjithshëm?

17 PË. Nuk kam asnjë lloj informacioni në lidhje me këtë.

18 PY. Kur ju pyetën sot paradite për bazën, pra ç'baza i nxorët
19 ju konkluzionet që z. Thaçi kontrollloi ngushtësisht prej
20 jashtë, ju përmendët disa faktorë. Ju thatë, për shembull,
21 thirrje të shumta telefonike. Po ju nuk e keni dëgjuar çfarë
22 thoshte z. Thaçi gjatë këtyre telefonatave, apo jo?

23 PË. Nuk e kuptoja shqipen, nuk e kuptoja shqipen, gjuhën që
24 flitej gjatë thirrjeve telefonike.

25 PY. Sikurse thatë paradite kur merrte telefonike, ose shkonte

1 në ndonjë qoshe në dhomës ose dilte jashtë, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A do të thotë kjo që ju nuk e dëgjoni çfarë i thonin z.

4 Thaçit folësit apo çfarë thoshte z. Thaçi, apo jo?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Gjatë dy viteve të fundit a keni takuar apo keni pasur

7 kontakte me ndonjë nga anëtarët e ekipit të Mbrojtjes së z.

8 Thaçi me përjashtim të rasteve kur keni dhënë intervistën dhe

9 keni pasur seancat përgatitore?

10 PË. Jo në lidhje me këtë çështje.

11 PY. Po për aspekte të tjera?

12 PË. Po.

13 PY. Me kë keni kontaktuar?

14 PË. Kate Gibson.

15 PY. Këtë për shkak se -- për shkak të pozicionit të saj?

16 PË. Po.

17 PY. Gjatë takimeve me Mbrojtjen ju thatë që në Rambuje

18 asnjëherë nuk e keni këshilluar z. Thaçi apo delegacionin

19 kosovar dhe nuk iu thatë që e kishit për detyrë të hetonit të

20 ndiqnit penalisht krimet vetë, dhe ju thatë që krimet nga UÇK-

21 ja nuk kanë qenë pjesë e bisedave asokohe. Edhe për këtë folët

22 sot paradite.

23 PË. Po.

24 PY. Do t'ju tregoj një dokument e më pas do t'ju bëj disa

25 pyetje.

1 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran
2 materialin SPOE0010969-40010978.
3 PY. Këtu është një libër që keni -- që është shkruar dhe prej
4 jush apo jo. Më saktë është ballina.
5 PË. Po.
6 PY. Keni qenë një prej autorëve.
7 PË. [Nuk ka përkthim].
8 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen SPOE40010971. E
9 zmadhojmë pak.
10 PY. Të shohim mesin e faqes, thotë "E drejta e autorit 2002".
11 Në këtë kohë është botuar?
12 PË. Po.
13 PY. A ju kujtohet a e keni shkruar në 2002-shin apo më herët
14 këtë libër?
15 PË. Ka të ngjarë që më herët. Duhet kohë.
16 PY. Për shembull, mund ta keni shkruar në 2001-n?
17 PË. Po.
18 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua që në të njëjtin dokumentin
19 të shohim faqen SPOE40010975. Zmadhojmë faqen në të djathtë
20 dhe paragrafin e parafundit. Pak më poshtë. Këtu.
21 PY. Do të lexoj fjalinë e fundit të paragrafit të parafundit
22 ku thotë "Si rezultat ...", fjalia fillon "Si rezultat ...".
23 "Si rezultat, në mes të viteve '90 disa elementë të
24 popullatës të shqiptarëve të Kosovës formuan Ushtrinë
25 Çlirimtare të Kosovës e cila vrau policë serbë dhe forcave

1 ushtarake edhe bashkëpunëtorët kosovar -- personat që
2 perceptoheshin si bashkëpunëtorë që ishin shqiptarë të
3 Kosovës."

4 Dëshmitar, kur e keni mësuar ju që UÇK-ja ka vrarë
5 kolaboracionistë? Ata persona që konceptoheshin si
6 kolaboracionistë?

7 PË. Nuk e di. Nuk e di.

8 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Mund ta heqim materialin
9 nga ekranin dhe të vendosim materialin SPOE40010668-0010708.

10 PY. Dëshmitar, ju thatë "Nuk e di", por i takon që të ketë
11 qenë të paktën në 2001-shin në qoftë se bazohemi në përgjigjen
12 që thatë pak më herët.

13 PË. Nuk dua të jap gabimisht disa fakte sa i takon kohës, po
14 ka qenë përpara se të botohej libri. Ka të ngjarë kur po
15 kryeja hulumtime në vitin 2000, 2001.

16 PË. Faleminderit. Në ekran tani shohim një artikull, po ashtu
17 e keni shkruar ju, ose të paktën kështu thuhet këtu, ku thuhet
18 "Sovraniteti i fituar: Udhë drejt zgjidhjes së konfliktit për
19 statusin përfundimtar të Kosovës". Ju kujtohet ky artikull?

20 PË. Po.

21 PY. E keni shkruar ju?

22 PË. Po.

23 PY. Duket sikur është botuar në janar 2003. E keni shkruar në
24 janar 2003 apo më përpara?

25 PË. Besoj afër janarit. Ka të ngjarë nga fundi i 2002-shit.

1 Mbase nëntor-dhjetor.

2 Z. PACE: [Përkthim] Në këtë artikull dua të shohim faqen

3 SPOE400106703 [Sipas përkthimit]. Të zmadhojmë paragrafin e

4 parë. Do të lexoj te pjesa që thotë "Si rezultat ...".

5 PY. "Si rezultat, në mes të viteve '90 disa elementë të

6 popullatës së shqiptarëve të Kosovës formuan Ushtrinë

7 Çlirimtare të Kosovës, e cila vriste anëtarë të policisë serbe

8 dhe forcave ushtarake si dhe personat -- si the shqiptarët e

9 Kosovës që perceptoheshin si koaboracionistë."

10 Ky është i njëjti formulim sikur më herët, apo jo,

11 Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim materialin nga ekrani.

14 PY. Sikurse thamë shkurtimisht më herët, ju folët dhe thatë

15 që krimet e UÇK-së nuk kanë qenë pjesë e diskutimeve. E keni

16 thënë këtë dhe në shënimet përgatitore. Për shembull, ju nuk

17 keni qenë në dijeni të dënimit të fortë që ka bërë Ambasadori

18 Gelbard vrasjeve të papranueshme prej UÇK-së në shkurt të '98-

19 s?

20 PË. Për cilën deklaratë për shtyp apo intervistë e keni ju

21 fjalën në mënyrë që ta kuptoj dhe të jem i saktë në përgjigjen

22 time?

23 PY. Fillojmë me pyetjen: A keni pasur dijeni fillimisht të

24 këtë bërë ndonjë deklaratë Ambasadori Gelbard për këtë?

25 PË. Kam ditur që Ambasadori Gelbard ka përdorur fjalën

1 "organizatë terroriste" kur i është referuar UÇK-së. Kjo më
2 kujtohet, për t'ju përgjigjur pyetjes.

3 PY. Kur e keni mësuar ju që Ambasadori Gelbart i drejtohej
4 UÇK-së si "organizatë terroriste"?

5 PË. Këtë nuk mund t'ua them.

6 PY. A e keni mësuar para Rambujesë këtë gjë?

7 PË. Ai e ka përdorur shprehjen "organizatë terroriste"
8 përpara Rambujesë.

9 PY. Kur shkuat në Rambuje, a e dinit ju, se thuajse një vit
10 më herët, në mars të '98-s, Sekretarja e Shtetit, Albright, i
11 ishte drejtuar lëvizjes çlirimtare në Kosovë që kishte -- si
12 një organizatë që kishte gjykuar dhe ekzekutuar serbët dhe
13 shqiptarë nuk i pëlqenin?

14 PË. Jo, nuk jam në dijeni të komenteve të saj.

15 PY. A keni pas dijeni ju që ka pasur një artikull në *New York*
16 *Times* në 1998-n dhe raportonte se sipas ekspertëve rebelët në
17 Kosovë kishin rrëmbyer më shumë se 200 serbë, shumica e të
18 cilëve besohej se ishin vrarë?

19 PË. Nuk më kujtohet për momentin ta kem lexuar një artikull
20 të tillë.

21 PY. E shohim në ekran sepse mbase ju ndihmon me kujtesën.

22 Z. PACE: [Përkthim] Është dokumenti V00007.

23 Këtu kemi një artikull të *New York Times*, gazeta
24 ndërkombëtare e datës 25 nëntor 1998, dhe artikulli mban
25 titullin "Hap i vogël për të ndihmuar armëpushimin në Kosovën.

1 Në qoftë se mund ta zmadhojmë paragrafin e parë.

2 PY. Dhe të lexojmë:

3 "Pas ndërhyrjes së diplomatëve amerikanë, oficeri i
4 policisë serbe të cilin rebelët e kishin kidnapuar para një
5 jave, Goran Zbiljic, u lirua.

6 "Lirimi i tij është i rëndësishëm sepse ekspertët
7 vlerësojnë se rebelët kanë kidnapuar 200 serbë, pjesa më e
8 madhe e të cilëve mendohet të jenë vrarë."

9 A ju freskon kjo kujtesën, pra, lidhur me faktin se e
10 keni lexuar këtë në 1998?

11 PË. Nuk më kujtohet në mënyrë konkrete ky artikull i veçantë
12 lidhur me këte pikë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim artikullin.

14 PY. Dëshmitar, a është saktë, ju kujtohet, pra, që më 26
15 shkurt 1999, ju ishit kthyer në Washington DC?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe gjatë kësaj kohe, kohës tuaj, pra, ishte koha në mes
18 Rambujesë dhe Parisit?

19 PË. Në atë kohë apo në një pikë pak më vonë a keni lexuar
20 pjesë të raportit të Departamentit të Shtetit të Shtetet e
21 Bashkuara që është nxjerrë më 26 shkurt 1999, ku trajtohej
22 Kosova në kontekstin e praktikave të drejtave të njeriut për
23 vitin 1998?

24 PË. Nuk e kam lexuar.

25 PY. Ju nuk ishit në dijeni që ky raport i referohej

1 elementeve të UÇK-së që ishin të përgjegjshëm për vrasjen,
2 zhdukjen, kidnapimet ndalimet, përfshirë të serbëve dhe
3 shqiptarëve, civilëve serbë dhe shqiptarë të dyshuar për
4 besnikëri ndaj qeverisë Kosovës, apo jo?

5 PË. Nuk e kam lexuar këtë raport.

6 PY. Asnjëherë?

7 PË. Me raportin, e keni fjalën për raportin e Departamentit
8 të Shtetit për të drejtat e njeriut?

9 PY. Ju deklaruat në pranverë --

10 PË. Që të jemi të qartë, e keni fjalën për raportin vjetor të
11 Departamentit të Shtetit, që Departamenti i Shtetit bën për
12 çdo vit në botë? A e keni për këtë raport fjalën?

13 PY. Do ta nxjerrim në ekran që të shmangim çdo keqkuptim.

14 PË. Po.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran SPOE00397688
16 deri në 397704, ju lutem. Në qoftë se mund të zmadhojmë, pra,
17 pak më poshtë.

18 PY. Shohim "Serbia, raport i lëshuar lidhur me demokracinë në
19 shkurt".

20 PË. Po. ky është një prej raporteve që ata bënin për çdo vend
21 rreth globit dhe besoj ta kem lexuar këtë gjë.

22 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim.

23 PY. Ju deklaruat se në pranverë dhe verë të 1999-s keni
24 vazhduar të ndiqni konfliktin në Kosovë përfshirë përmes
25 mediave dhe duke ndjekur konfliktin përmes mediave dhe

1 mënyrave të tjera nuk keni mësuar për ndonjë krim që
2 pretendohet të ishte kryer nga anëtarë të UÇK-së, a është e
3 saktë?

4 PË. E ku është kjo në deklaratën time?

5 PY. Do ta shohim, do t'ju tregoj këtë.

6 PË. Do të ishte shumë mirë se do të më ndihmonte që të jem sa
7 më i saktë në përgjigje të mia.

8 Z. PACE: [Përkthim] Nxjerrim në ekran, ju lutem,
9 dokumentin 128837-TR-ET Pjesa 1.

10 PY. Nuk e di a e keni parë këtë dokument, por ky është
11 transkripti i intervistës që kemi bërë para dy javësh përmes
12 *Teams*.

13 PË. Nuk e kam parë.

14 PY. Data është 2 shtator 2025. Ju kujtohet që kemi pasur këtë
15 takim?

16 PË. Po.

17 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen 26 të dokumentit.

18 PY. Tani do të lexoj duke filluar nga rreshti 12:

19 "PY. Në deklaratën, ju thoni se para pranverës dhe verës
20 1999, ju ka ndodhë që të ndiqnit konfliktin e Kosovës dhe keni
21 biseduar shpesh me mediat në Kosovë lidhur me ndërhyrjen e
22 NATO-s në Kosovë. Si e keni ndjekur konfliktin në atë kohë?

23 "PË. Duke ndjekur mediat, bisedat me komunitetin
24 shqiptaro-amerikan të pranishëm në Shtetet e Bashkuara dhe
25 gjithashtu biseda me amerikanë që ishin pjesë e politikbërjes

1 për këtë pikë të caktuar.

2 "PY. duke ndjekur konfliktin në atë kohë përmes mediave
3 dhe mënyrave tjera që ju i përshkruat, a morët vesh, mësuat
4 për krimet që pretendohet të ishin kryer nga pjesëtarë të UÇK-
5 së?

6 "PË. Jo."

7 A jua freskon kujtesën kjo?

8 PË. Po, ma freskon kujtesën.

9 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

10 PY. A do të thotë, për shembull, që ju nuk keni dëgjuar që
11 trupat gjermane kanë gjetur 15 të burgosur, përfshirë këtu një
12 person të moshuar i cili u gjet i lidhur me pranga në një
13 karrige, i rrahur rëndë në atë ndërtesë dhe i vdekur, i cili
14 ishte marrë nga UÇK-ja në qershor të 1999?

15 PË. Këtë shembull konkret jo, ky nuk më kujtohet.

16 PY. A keni pasur qasje në *The New York Times* në atë kohë,
17 qershor 1999?

18 PË. Po.

19 PY. Keni pasur qasje në CNN në atë kohë apo rreth asaj kohe?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe a ju kujtohet që ballina e *The New York Times*
22 raportonte incidentin të cilit iu referova?

23 PË. Jo.

24 PY. A ju kujtohet CNN.com që raportonte për këtë incident që
25 përmenda, raportimi i CNN.com për këtë?

1 PË. Jo.

2 PY. Më herët përmendëm, ose ju e përmendët në dëshminë tuaj
3 sot në mëngjes, se kishit marrëdhënie të ngushtë me Veton
4 Surroin. A jeni në dijeni të ndonjë kërcënimi që janë bërë
5 ndaj Surroit në KosovaPress në tetor 1999 pasi ai publikoi një
6 artikull në Koha Ditore ku i referohej, ndër të tjera,
7 frikësimit të organizuar dhe sistematik të të gjithë serbëve
8 thjesht sepse ishin serbë dhe janë për rrjedhojë kolektivisht
9 përgjegjës për atë që ka ndodhur në Kosovë?

10 PË. Jo, konkretisht. Mund të jap më shumë kontekst në qoftë
11 se dëshironi?

12 PY. Ju lutem, vazhdoni.

13 PË. Vetoni -- tani po mendoj për kohën tani. Vetoni ka qenë
14 gjithmonë i përqendruar dhe, me të drejtë, në mbajtjen,
15 ruajtjen e një Kosove shumë etnike. Dhe në shumë biseda që kam
16 patur me Vetonin, ishte e rëndësishme për të që të mbahej kjo
17 baraspeshë mes mbrojtjes së të drejtave dhe privilegjeve të
18 pakicës serbe, por jo që të shkohej aq larg sa që të bëhej një
19 ndarje apo një ndarje e tërësishme politike.

20 PY. E kuptojmë.

21 Z. PACE: [Përkthim] A mund të kalojmë tani në dokumentin
22 P01519 ta shfaqim të ekran. Dhe këtu kalojmë në faqen 105848

23 PY. Dëshmitar, shohim në krye këtu ku lexohet: "Forcat e
24 intolerancës kërcënojnë të konsumojnë Kosovën, shkruar nga
25 Peter Finn, *Washington Post* Shërbimi i Jashtëm i *Washington*

1 *Post, Washington Post* 13 tetor 1999". Do të lexoj nga mesi ku
2 shkruhet "Nga të qënurit viktimë..."

3 PY. Dhe do ta lexoj nga kjo:

4 "Nga të qënurit viktima të persekutimit të fundit të
5 shekullit më të egër në Evropë dhe më të keq' shkroi Surroi në
6 gazetë, në komentarin e gazetës, 'jemi bërë ne vetë
7 persekutorë dhe kemi lejuar një spektër të fashizmit që
8 rishfaqet ... i di justifikimet për këtë - që ne i kemi
9 përjetuar një luftë barbare në të cilën serbët kanë kryer
10 krimet më të tmerrshme, se intensiteti i dhunës ka gjeneruar,
11 ka krijuar dëshirën për hakmarrje. Megjithatë, këto nuk janë
12 justifikime.'

13 "Duke iu përgjigjur thirrjes së Surroit për pluralizëm --
14 përgjigja e Surroit për pluralizëm -- përgjigja ndaj thirrjes
15 së Surroit për pluralizëm tregoi ashpërsinë e ortodoksisë që
16 ishte akoma pro qëndrimeve të ashpra që ishin akoma të nxehta
17 këtu dhe solli kritikë -- nuk solli kritikë, pra, nga Hashim
18 Thaçi, Surroi dhe kryeditori i tij, Baton Haxhiu përshkruar
19 këtu si 'vampirë pro serbë', u përshkruan 'si vanpirë por
20 serbë'.

21 "Autori", vazhdojmë më tej, "njerëzit si ata duhen vetë
22 të kuptojnë se një ditë edhe ata mund të jenë shënjestër e
23 ndonjë hakmarrjeje personale, e cila është krejt e kuptueshme.
24 Për rrjedhojë, të dy Vetoni dhe kryeditori i tij duhet që të
25 lihen në ujë.

1 "Sulmi i publikuar i cili ishte lexuar, që u interpretua
2 si kërcënime ndaj kërcënime me vdekje nga Kombet e Bashkuara
3 dhe personat që punonin aty, nga ky ishte një reagim shumë i
4 butë dhe pothuajse i heshtur nga qeveria e Thaçit. Kouchner 'i
5 kërkoi', Thaçit, 'që të reagonte', zyrtarët perëndimorë thanë
6 për këtë dhe ai e refuzoi të takohet me -- dhe refuzojnë të
7 takohen me z. Reqica [Fonetikisht] nga qeveria e tij për disa
8 ditë si përgjigje ndaj kësaj mungese reagimi.

9 "Ne nuk pranua thirrje telefonike, nuk pranua të
10 bëheshin mbledhje apo takime me ta për të shfaqur neverinë
11 tonë ndaj kësaj gjëje' thënë një zyrtari i Kombeve të
12 Bashkuara.

13 "Zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, megjithatë, kishin
14 frikë se ky artikull, me gjithë mohimet e demontimet e bëra
15 nga z. Thaçi, ishte i miratuar në nivel më të lartë të
16 qeverisë dhe tha për rrjedhojë e ndjenin që kjo përbënte një
17 shqetësim autoritar, për një tendencë autoritare në klasën
18 politike që dilte nga UÇK-ja, e cila kishte luftuar një luftë
19 16 mujore për pavarësi kundër ushtrisë jugosllave dhe policisë
20 jugosllave dhe forcave paramilitare."

21 Dhe pyetja ime pasi kemi lexuar këtë artikull të
22 *Washington Post* ishte: A e ka diskutuar z. Surroi këtë gjë apo
23 diçka prej kësaj në vitet në vijim kur kjo ka ndodhur apo më
24 vonë, më pas?

25 PË. Vetoni nuk ka diskutuar këtë përveç një përshkrimi të

1 përgjithshëm se kishte një marrëdhënie të tendosur. Nuk më
2 kujtohet të kem lexuar këtë në mënyrë të veçantë.

3 PY. Marrëdhënia e tendosur midis kujt?

4 PË. Midis Veton Surroit në atë kohë dhe Hashim Thaçit.

5 PY. A mund të jeni më konkret? Kur thoni "në atë kohë", për
6 cilën kohë e keni fjalën?

7 PË. Kjo është koha në fund të fushatës ajrore të NATO-s dhe
8 përpjekjeve të Kosovës dhe NATO-s dhe të Kombeve të Bashkuara
9 për të krijuar një Kosovë të qëndrueshme dhe paqësore. Siç e
10 përmenda më herët sot, situata politike në Kosovë ishte si
11 kaleidoskop, pra, me forma që e ndryshueshme në mënyrë të
12 vazhdueshme në çdo kohë.

13 PY. Faleminderit. Po pyesja thjesht për periudhën kohore dhe
14 mendoj që u përgjigjët.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument dhe të
16 shfaqim një dokument tjetër, DHT06689-DHT07080. Dhe mund të
17 kalojmë te faqja DHT06691. Lexojmë në faqen e tretë dhe mund
18 ta zmadhojmë.

19 PY. Këtu shohim "Lufta dhe hakmarrja e Kosovës, Tim Judah".

20 PË. Unë e njoh Tim Judah. Se për të cilën bëhet fjalë nuk më
21 kujtohet tani për tani.

22 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen DHT07725 dhe të
23 lexoj nga paragrafi i fundit në fund të faqes. Faleminderit.
24 Këtu. Do të lexoj tani.

25 PY. "Tani situata kishte përmbysur. Surroi po rihapte zyrën

1 në Prishtinë të Koha Ditore, e cila, gjatë bombardimeve dhe
2 falë parave të britanike, ishte publikuar në Tetovë në
3 Maqedoni. Ai vendosi të përdorte faqet e kësaj gazete për të
4 thënë, për të shprehur qëndrimet e tija haptas.

5 "Në muajin e kaluar një grua e vjetër ishte rrahur për
6 vdekje në banjën e saj, një fëmijë dy-vjeçar ishte plagosur
7 dhe nëna e saj qëlluar në kokë, dy të rinj ishin vrarë me
8 mortajë dhe një grua që guxoi të fliste, të përmendte emrin e
9 saj -- që nuk guxonte të thoshte emrin e saj në publik për
10 shkak të frikës se ata që ishin -- për shkak të atyre që ishin
11 përpjekur ta dhunonin do të ktheheshin.

12 "Artikulli vazhdon më tej duke theksuar se këto nuk ishin
13 'incidente të izoluara' dhe se serbët e frikësuar ishin
14 mbyllur në shtëpitë e tyre 'të terrorizuar nga atmosfera në të
15 cilën çdo zhurmë ju dukej atyre kërcënuese'. Shqiptarët ishin
16 paralajmëruar që të mos ushqenin serbët.

17 "E di që serbët që kishin mbetur në Kosovë dhe në fakt
18 roma, ndiheshin sepse unë bashkë me 2 milionë të tjerë
19 shqiptar kisha qenë në të njëjtën situatë vetëm dy muaj e
20 gjysëm më përpara. E kuptoj frikën e tyre ... Kjo është
21 arsyeja që nuk mund të fsheh turpin që kam ndjerë kur kam
22 zbuluar për herë të parë në histori, se ne shqiptarët e
23 Kosovës ishim edhe ne në gjendje të kryenim akte kaq
24 monstruoze. Dua ta them këtë hapur dhe ta bëj të qartë se kodi
25 ynë moral sipas së cilit gratë, fëmijët dhe të vjetrit, të

1 moshuarit nuk duhet të preken është shkelur.

2 "E di justifikimin e natyrshëm dhe të qartë, domethënë,
3 pra, me fjalë të tjera që ne i kemi përjetuar një luftë
4 barbare në të cilën serbët ishin përgjegjës për krimet më të
5 tmerrshme dhe më të urryeshme në të cilën intensiteti i dhunës
6 ka shkaktuar dëshirën për hakmarrje tek shqiptarët. Megjithatë
7 kjo nuk është justifikim.

8 "Ajo që ka ndodhur, tha Surroi, ishte 'frikësimi
9 sistematik dhe i organizuar i të gjithë serbëve thjesht sepse
10 ishin serbë dhe për rrjedhojë mbaheshin të përgjegjshëm
11 kolektivisht për atë që kishte ndodhur në Kosovë.'"

12 Z. PACE: [Përkthim] Tani po shkojmë tek një citim dhe do
13 ta ngadalësoj pak.

14 PY. "Këto sjellje janë fashiste. Për më tepër ishte pikërisht
15 kundër sjelljeve që populli i Kosovës u ngrit dhe luftoi, së
16 pari në mënyrë paqësore dhe pastaj me armë, gjatë 10 viteve të
17 fundit. Trajtimi i serbëve të Kosovës na mbulon me trup gjithë
18 shqiptarët e Kosovës... nga të qënurit viktimë të persekutimit
19 të fundit të shekullit më egër të Evropës, jemi bërë ne vetë
20 persekutorë dhe kemi lejuar spektrin e fashizmit që të
21 rishfaqet.

22 "Kushdo mendon që dhuna do të përfundojë në momentin që
23 serbi i fundit do të largohet nga këtu është iluzion. Dhuna
24 thjesht do të drejtohet kundër shqiptarëve të tjerë. A është
25 me të vërtetë kjo për të cilët luftuam?

1 "Surroi u mbështet fuqishëm nga jashtë. Por jo në Kosovë.
2 Gazeta e UÇK-së e sulmoi ashpër Surroin që nuk ishte i lidhur
3 me Thaçi dhe Qeverinë e tij të Përkohshme, sulmoi Surroin dhe
4 Baton Haxhiun të cilët ishin tani editorë të Koha Ditore
5 (Surroi ishte pronar). Dhe tha që 'kriminelë të tillë që kanë
6 skllavëruar mendjet nuk duhet të kenë vend në Kosovën e lirë
7 dhe i akuzuan ata që të ishin ..."

8 Dëshmitar, pra, në ndërveprimet, shkëmbimet që keni pasur
9 ju ndër vite nga viti 1999 me z. Surroi, a ka përmendur ai
10 ndonjëherë diçka si kjo që lexova, pra, pikëpamjet e tij që
11 është shprehur se ky libër dhe ky artikull përpara tij
12 deklaroi që ai ka shprehur në Kosovë, gjërat që ka shprehur në
13 Kosovë dhe për rrjedhojë dhe reagimin që ka provokuar kjo në
14 veçanti në artikullin në KosovaPress?

15 PË. Vetoni dhe unë kemi diskutuar shpesh në mënyrë të
16 shpeshtë pyetjet që janë të afërta, çështjet që janë të afërta
17 me këtë. Vetoni dhe unë kemi diskutuar rrugën e Kosovës drejt
18 pavarësisë, situatën, shkeljet që kishin ndodhur pas fushatës
19 ajrore të NATO-s dhe që kishin vënë në rrezik rrugëtimin
20 progresiv drejt pavarësisë. Pra, kjo hollësi, ky nivel
21 përqendrimi jo dhe detaje. Por dua të jem i qartë që duke u
22 nisur nga fundi i fushatës ajrore dhe shkeljeve të të drejtave
23 të njeriut që kanë ndodhur pas fushatës ajrore, unë kam qenë
24 në dijeni për këto, këto dua të përmend, nuk dua të krijoj
25 përshtypjen se nuk kam qenë asnjëherë në asnjë moment i

1 informuar apo në dijeni të shkeljeve të të drejtave të
2 njeriut.

3 Dhe kur Vetoni dhe unë kemi patur biseda ka qenë më shumë
4 ne të dy që po flisnim, nuk është që flisnim të dy, ai fliste
5 me mua si jurist duke më pyetur, për shembull, se çfarë
6 ndikimi do të ketë kjo në progresin ecurinë drejt
7 vetëvendosjes dhe pavarësisë dhe ishte natyrisht dhe në mënyrë
8 të duhur shumë i shqetësuar për këtë.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera për ju.

11 Të nderuar Gjykatës, sa i takon dëshmitarit të fundit,
12 nuk kam pyetje të tjera në këtë moment, duke patur parasysh se
13 ka shumë pyetje për dëshmitarët e Mbrojtjes të cilët nuk kemi
14 përmbledhje për ta dhe asnjë deklaratë që nuk është -- dëshmia
15 e të cilëve, deklaratat e të cilëve mund të prekë e mund të
16 ketë të bëjnë me çështje që lidhen me thelbin e dëshmisë së
17 këtij dëshmitari këtu, pra, nuk i kemi ato deklaratat. Ndërkohë
18 që bëjmë kërkesën për t'i rithirrur ata nuk e bëjmë kërkesën
19 tani në këtë fazë, ndonëse në këtë fazë nuk bëjmë kërkesën për
20 t'i rithirrur atë, e rezervojmë të drejtën për ta bërë një gjë
21 të tillë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 uleni.

24 Misetic.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të konsultohem me klientin

1 tim tani.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 [Mbrojtja këshillohet]

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kemi pyetje të
6 tjera për dëshmitarin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Megjenëse kanë
8 ngelur vetëm pak minuta, do përfundojmë këtu sot. Duhet të
9 vini nesër në orën 9.00. Kemi shpresë që të mbarojmë me pjesën
10 që ka ngelur të dëshmisë suaj nesër në mënyrë efikase.
11 Faleminderit që keni ardhur.

12 Ju kujtoj që nuk duhet të flisni me askënd për dëshminë
13 tuaj në Gjykatë. Sepse e di që është fusha juaj dhe është
14 zanati juaj, por megjithatë duhet ta bëj. Faleminderit për
15 praninë tuaj sot. shihemi nesër në mëngjes.

16 DËSHMITARI: Faleminderit.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 --- Seanca mbyllet në orën 16.22

20

21

22

23

24

25